

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EVROPIANE

Bruksel, 14.10.2009  
SEC (2009) 1337

DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT

**RAPORTI I PROGRESIT 2009 PËR SHQIPËRINË**

*që shoqëron*

**KOMUNIKATËN E KOMISIONIT  
PËR PARLAMENTIN EVROPIAN DHE KËSHILLIN**

**Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2009-2010**

COM (2009) 533

## PASQYRA E LËNDËS

|         |                                                                                        |    |
|---------|----------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1.      | Hyrje.....                                                                             | 4  |
| 1.1.    | Parathënie.....                                                                        | 4  |
| 1.2.    | Kontekst.....                                                                          | 4  |
| 1.3.    | Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë.....                                        | 5  |
| 2.      | Kriteri politik .....                                                                  | 6  |
| 2.1.    | Demokracia dhe shteti i së drejtës .....                                               | 6  |
| 2.2.    | Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve .....                                 | 12 |
| 2.3.    | Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare .....                                    | 18 |
| 3.      | Kriteri ekonomik .....                                                                 | 19 |
| 3.1.    | Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale.....                                       | 19 |
| 3.2.    | Aftësia për të përballuar trysinë e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së..... | 23 |
| 4.      | Standardet evropiane .....                                                             | 24 |
| 4.1.    | Tregu i brendshëm .....                                                                | 25 |
| 4.1.1.  | Lëvizja e lirë e mallrave.....                                                         | 25 |
| 4.1.2.  | Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e vendosjes .....                         | 26 |
| 4.1.3.  | Lëvizja e lirë e kapitalit.....                                                        | 28 |
| 4.1.4.  | Doganat dhe tatimet.....                                                               | 28 |
| 4.1.5.  | Konkurrenca.....                                                                       | 29 |
| 4.1.6.  | Prokurimi publik.....                                                                  | 30 |
| 4.1.7.  | Ligji i pronësisë intelektuale.....                                                    | 31 |
| 4.1.8.  | Politikat sociale, punësimi dhe shëndeti publik.....                                   | 32 |
| 4.1.9.  | Arsimi dhe kërkimi shkencor.....                                                       | 33 |
| 4.1.10. | Çështjet e OBT-së.....                                                                 | 34 |
| 4.2.    | Politikat sektoriale.....                                                              | 35 |
| 4.2.1.  | Industria dhe SME-të.....                                                              | 35 |
| 4.2.2.  | Bujqësia dhe peshkimi.....                                                             | 36 |
| 4.2.3.  | Mjedisi.....                                                                           | 37 |
| 4.2.4.  | Politikat e transportit.....                                                           | 38 |
| 4.2.5.  | Energjia .....                                                                         | 40 |
| 4.2.6.  | Shoqëria e informimit dhe media.....                                                   | 41 |
| 4.2.7.  | Kontrolli financiar.....                                                               | 41 |
| 4.2.8.  | Statistikat.....                                                                       | 42 |
| 4.3.    | Drejtesia, liria dhe siguria.....                                                      | 43 |

|        |                                                        |    |
|--------|--------------------------------------------------------|----|
| 4.3.1. | Vizat, menaxhimi i kufirit, azili dhe migrimi.....     | 43 |
| 4.3.2. | Pastrimi i parave .....                                | 46 |
| 4.3.3. | Drogat.....                                            | 47 |
| 4.3.4. | Policia.....                                           | 48 |
| 4.3.5. | Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit..... | 49 |
| 4.3.6. | Mbrojtja e të dhënave personale.....                   | 50 |

# DOKUMENTI I PUNËS I STAFIT TË KOMISIONIT

## RAPORTI I PROGRESIT 2009 PËR SHQIPËRINË

### 1. HYRJE

#### 1.1 Parathënie

Që në mars 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin e bërë nga vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor. Ky raport progresi ndjek thujtë të njëjtën strukturë si vitet e kaluara.

Raporti:

- përshkruan shkurt marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së;
- analizon gjendjen në Shqipëri për sa i përket kriterit politik për anëtarësim;
- analizon gjendjen në Shqipëri mbi bazën e kriterit ekonomik për anëtarësim;
- shqyrton kapacitetet e Shqipërisë për zbatimin e standardeve evropiane, domethënë, përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave të saj me ato të *acquis*, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe prioritetet e Partneritetit Evropian.

Ky raport mbulon periudhën nga fillimi i tetorit 2008 deri në mes të shtatorit 2009. Progresi matet mbi bazën e vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara. Si rregull, ligjet apo masat që janë në fazat e përgatitjes ose që presin miratimin e parlamentit, nuk merrren parasysh. Kjo përjasje garanton trajtim të barabartë në të gjitha raportet dhe mundëson vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informacionet e mbledhura dhe të analizuar nga Komisioni. Përveç këtyre, janë përdorur shumë burime, përfshi kontributet e qeverisë së Shqipërisë, të shteteve anëtare, raportet<sup>1</sup> e Parlamentit Evropian dhe informacionet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Bazuar në analizën teknike që përmban ky raport, Komisioni nxjerr përfundime të hollësishme për Shqipërinë në komunikatën e zgjerimit<sup>2</sup>.

#### 1.2 Konteksti

Shqipëria është kandidate potenciale për anëtarësim në BE. Shqipëria aplikoi për anëtarësim në BE në prill 2009. Komisioni është i gatshëm të përgatitë opinionin për këtë aplikim sapo t'i kërkohet nga Këshilli.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, hyri në fuqi në prill 2009. Marrëveshja e Përkohshme ka qenë në fuqi që në dhjetor 2006. Në prill 2009, Shqipëria aplikoi për anëtarësim në BE.

<sup>1</sup> Raportues për Shqipërinë deri në 2009 ishte z. Libor Rouček. Raportuesi i ri është z. Nikolaos Chountis.

<sup>2</sup> Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2009-2010. (COM (2009) 533, datë 14.10.2009)

### 1.3. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë

Shqipëria aktualisht merr pjesë në **Procesin e Stabilizim-Asociimit**.

MSA-ja shtron një kuadër angazhimesh të ndërsjella për një rang të gjerë çështjesh politike, tregtare dhe ekonomike. Para hyrjes në fuqi të MSA-së, dispozitat që lidhen me tregtinë janë vënë në zbatim nëpërmjet Marrëveshjes së Përkohshme që nga dhjetori i 2006-ës. Në prill 2009 hyri në fuqi një protokoll i MSA-së që merrte parasysh anëtarësimin në BE të Bullgarisë dhe Rumanisë.

Nëpërmjet **Partneritetit Evropian**<sup>3</sup>, BE-ja udhëzon autoritetet shqiptare mbi prioritetet e reformave. Progresi në këto reforma kryesore inkurajohet dhe monitorohet përmes **dialogut politik dhe ekonomik** me Shqipërinë. Ky dialog zhvillohet nëpërmjet strukturave të MSA-së. Mbledhja e parë e Këshillit të Stabilizim-Asociimit u zhvillua në maj 2009. Gjashtë takime grupe-pune sektoriale/nënkomitete janë organizuar që nga nëntori i 2008.

Para hyrjes në fuqi të MSA-së, takimi i trojkës ministrore me Shqipërinë në shkurt 2009 u fokusua në prioritetet kyçe politike, përfshi çështjet rajonale. Komiteti i përvitshëm i përbashkët u takua në dhjetor 2008 për të vëzhguar funksionimin e duhur të marrëveshjes së përkohshme. Takimi i Grupit të Përbashkët Konsultativ Shqipëri-BE (CTF) që u zhvillua në dhjetor 2008 u fokusua në kriteret politike të anëtarësimin dhe çështjet e shtetit të së drejtës. Takimet e grupeve të punës/nënkomiteteve u fokusuan në politikën ekonomike, sektoriale dhe të tregut të brendshëm.

Shqipëria kontribuoi me 12 ushtarë në Misionin BE-ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë dhe me 63 ushtarë në misionin paqeruajtës në Çad dhe në Afrikën Qendrore (EUFOR). Si vend kandidat potencial për anëtarësimin në BE, Shqipëria ka harmonizuar 116 deklaratat të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë nga 128 deklaratat të miratuara nga BE gjatë periudhës së raportimit.

Marrëveshjet për **lehtësimin e vizave** dhe ripranimin ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian vazhdojnë të zbatohen. Në kuadër të dialogut për liberalizimin e vizave, Shqipëria ka bërë progres të mirë në fushat e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, por nuk ka plotësuar ende të gjitha kushtet që përmban udhërrëfyesi. Kërkohen përpjekje të mëtejshme sidomos në fushën e personalizimit dhe shpërndarjes së pasaportave biometrike, menaxhimit të kufijve dhe migrimit, si dhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Që në vitin 2007, **asistenca financiare** e paraanëtarësimin për Shqipërinë jepet në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimin (IPA). Për vitin 2009, KE-ja akordoi një total prej 81.2 milion euro. Dokumenti i Planifikimit Tregues Shumëvjeçar (MIPD) 2009-2011 për Shqipërinë në kuadrin e IPA-s u miratua në korrik 2009. Fushat kryesore që mbulohen janë drejtësia dhe çështjet e brendshme, forcimi i kapaciteteve administrative, zhvillimi ekonomik e social dhe stabiliteti demokratik, si dhe përgatitja për menaxhimin e ardhshëm të Fondeve të KE-së. Asistenca e vazhdueshme nën CARDS dhe IPA zbatohet nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Tiranë. Menaxhimi i ndihmës me bazë të decentralizuar është një objektivi afatmesëm për Shqipërinë. Marrëveshja Financiare për Programin Kombëtar për vitin 2008 u nënshkrua në mars 2009 dhe ka filluar zbatimin e programit. Marrëveshjet financiare për programet e bashkëpunimit ndër-kufitar u nënshkruan në qershor 2009.

<sup>3</sup> Vendim i Këshillit 2008/ 210/ KE

Në përgjigje të krizës ekonomike, në kuadër të IPA-s është krijuar një **paketë krize** që përmban 200 milion euro për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, të cilat pritet të tërheqin investime prej 1 miliard euro të bashkëfinancuara nga institucionet financiare partnere. Vendi do të përfitojë nga ndarja e fondeve me shumë përfitues për konkurrueshmërinë, SME-të, efikasitetin e energjisë dhe rregullimin e sektorit bankar. Përveç kësaj, fondet kombëtare IPA u programuan të rrisin investimet në infrastrukturë. Ato ofrojnë 14.5 milion euro nëpërmjet Instrumentit Mbështetës për Infrastrukturën (IPF) për realizimin e projekteve të rrugëve rurale dhe ujit. Gjithashtu, nga Programi CARDS 2006 janë riakorduar 7 milion euro për të njëjtin qëllim.

Për sa i takon dialogut të **shoqërisë civile**, 2.7 milion euro janë akorduar në kuadër të Instrumentit të Shoqërisë Civile për projekte që forcojnë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile gjatë periudhës 2009-2011. Më konkretisht, 1.5 milion euro të asistencës IPA janë akorduar për organizatat e shoqërisë civile që merren me luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore, mbrojtjen e mjedisit dhe arsimin si dhe zbutjen e varfërisë. 1.2 milion euro të tjera në kuadër të Iniciativës Evropiane për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) mbështesin aksione që synojnë të drejtat e fëmijëve, grave dhe minoriteteve, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe sëmundje mendore si dhe aksesin në drejtësi.

Për sa i përket **programeve Komunitare**, Shqipëria merr pjesë në Programin Kuadër Kërkimor të Shtatë sipas memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar në dhjetor 2007. Shqipëria merr pjesë gjithashtu në Programin Kuadër për Sipërmarrjen dhe Novacionin si dhe në Programin Evropa për Qytetarët sipas memorandumeve të mirëkuptimit të nënshkruara respektivisht në qershor 2008 dhe shkurt 2009.

## 2. KRITERI POLITIK

Ky seksion ekzaminon progresin e Shqipërisë në përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagenit, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu, monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet aspiruese dhe shtetet anëtare, si dhe respektimin e detyrimeve ndërkombëtare.

### 2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës

#### *Parlamenti*

Më 29 janar, parlamenti miratoi njëzëri një rezolutë ku i kërkohej qeverisë të aplikonte për anëtarësim në BE. Në rezolutë, Shqipëria angazhohej për organizimin e zgjedhjeve parlamentare të lira dhe të ndershme dhe përafrimin e legjislacionit me BE-në.

Zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit, sipas vlerësimit të zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), përmbushën shumicën e angazhimeve të OSBE-së, por nuk realizuan plotësisht potencialin e Shqipërisë për arritjen e standardeve më të larta në zgjedhje demokratike. U arrit progres i prekshëm në identifikimin e zgjedhësve, kuadrin ligjor dhe procesin e votimit, por politizimi i proceseve teknike si numërimi i votave, mbetet për t'u korrigjuar në zgjedhjet e ardhshme.

Reforma zgjedhore u plotësua me miratimin e Kodit Zgjedhor në dhjetor 2008. U përmbushën rekomandimet kryesore të OSBE/ODIHR nga zgjedhjet e mëparshme, si pjesë e reformës së përgjithshme zgjedhore. Megjithatë, kultura e dialogut ndërmjet partive politike u përkeqësua para zgjedhjeve. Kjo pengoi progresin e reformave në fusha kyçe, siç është gjyqësori. Sesioni i fundit parlamentar nuk arriti të miratonte ligje kyçe për shkak të bojkotit të disa partive politike. Debatet u përqendruan fillimisht në miratimin e Kodit Zgjedhor, pastaj në mënyrat e lëshimit të kartave të identitetit. Si protestë ndaj projekt Kodit Zgjedhor, disa parti ndërmorën greva urie. Në përgjithësi, dialogu politik, si një prioritet kyç i Partneritetit Evropian, duhet të vihet sërish në binarë.

Në lidhje me përgatitjet për zgjedhjet, progres vihet re në plotësimin e infrastrukturës zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR. U hartuan lista të përmirësuara zgjedhësish bazuar në regjistrin e ri civil, duke përmbushur kështu në një masë mjaft të madhe këtë prioritet kyç të Partneritetit Evropian.

Sipas Kodit të ri Zgjedhor, vetëm kartat e identitetit dhe pasaportat mund të përdoren si mjet identifikimi për qëllime votimi. Për t'iu dhënë mundësi qytetarëve të votonin, shpërndarja e kartave të identitetit filloi në janar 2009 dhe u përfundua në masën më të madhe. Kostoja e kartës së identitetit dhe përqindja e shpërndarjes u kthye në një nga çështjet më të debatuarat të procesit zgjedhor. Në ditën e zgjedhjeve, nuk pati kontestime të mëdha për kartat e identitetit. Megjithatë, disa parti pretenduan se listat e zgjedhësve kishin ende pasaktësi.

Zgjedhësit shqiptarë votuan për 140 deputetë të parlamentit nga 12 qarqe, sipas sistemit të ri rajonal-proporcional. Parlamenti i ri u mblodh në 7 shtator dhe qeveria e re e bëri betimin më 16 shtator.

Parlamenti miratoi një sërë ligjesh për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, por miratimi i disa ligjeve kyçe u vonua për shkak të fushatës zgjedhore. Agjenda e parlamentit u dominua nga zgjedhjet; kjo bëri që të kishte progres të pakët të reformave në fusha kyçe, siç është gjyqësori.

Kapacitetet drejtuese të parlamentit janë përmirësuar përgjithësisht. Është ulur ndjeshëm numri i komisioneve hetuese parlamentare *ad hoc*. Administrata parlamentare filloi të transkriptojë dhe të publikojë punimet e seancave të komisioneve. Megjithatë, zbatimi i buxhetit të parlamentit dhe i rregullave të brendshme financiare të tij, vazhdoi të vuajë nga mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies. Në disa raste nuk janë respektuar procedurat për rekrutimin. Kjo ka sjellë ndikim negativ në cilësinë e stafit teknik.

Parlamenti ushtroi vetëm pjesërisht rolin mbikëqyrës të ekzekutivit. Për të arritur progres në përafrimin e legjislacionit, parlamenti duhet të forcojë kapacitetet administrative që të përmbushë funksionet kontrolluese mbi procesin legjislativ.

Parlamenti nuk ka adresuar ende çështjen e përcaktimit të rregullave për kufizimin e imunitetit të anëtarëve të tij.

Komisioni Parlamentar për Integrimin Evropian vazhdoi të rrisë ndërgjegjësimin për çështje të BE-së. Ky komision verifikon nëse projektligjet përmbajnë tabela konkordance për përafrimin ligjor, siç kërkohet nga një vendim i ri i Këshillit të Ministrave. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme që të forcohet roli i parlamentit në monitorimin dhe zbatimin e detyrimeve të MSA-së.

*Në përgjithësi*, vihet re progres në mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të cilat u vlerësuan se kishin përmbushur shumicën e standardeve ndërkombëtare. Miratimi në kohë i Kodit Zgjedhor dhe përgatitja e listave të zgjedhësve të përmirësuara, përmbushin në masën më të madhe këtë prioritet kyç të Partneritetit Evropian. Megjithatë, për shkak të zgjedhjeve, dialogu politik ndërmjet partive politike u përkeqësua dhe vonoi progresin e reformave në fusha kyçe.

### *Qeveria*

Pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit, presidenti Topi i kërkoi koalicionit të ri parlamentar të kryesuar nga kryeministri Berisha i Partisë Demokratike që të formonte qeverinë e re. Përveç Partisë Demokratike (PD), në koalicion bën pjesë edhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), Partia Republikane (PR) dhe Partia për Drejtësi dhe Integrim (PDI). Kabineti i ri përbëhet nga 14 ministra. LSI, si aleati kryesor i koalicionit, siguroi postin e zv/kryeministrit dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, si dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Partia Republikane siguroi postin e Ministrit të Mjedisit dhe Administrimit të Ujërave për kryetarin e vet, Fatmir Mediu. Z. Mediu ishte Ministër i Mbrojtjes në qeverinë e mëparshme dhe dha dorëheqjen pas shpërthimit të një impianti të çmontimit të municioneve në Gërdec, në mars 2008. Gjykata e Lartë rrëzoi akuzat kundër tij në shtator pas rizgjedhjes si deputet.

Duke konsoliduar programin e punës të vitit 2009 të qeverisë së mëparshme, programi i qeverisë së re i jep prioritet integritit evropian, rritjes së standardit të jetesës dhe politikave sociale. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, paralel me reformën në gjyqësor, vazhdojnë të jenë prioritetet e qeverisë.

Marrëdhëniet ndërmjet institucioneve shtetërore vazhduan të jenë herë-herë të vështira. Prirja e ekzekutivit për të ushtruar kontroll mbi institucionet e pavarura, veçanërisht mbi gjyqësorin, ka ngjallur shqetësime.

Në dhjetor 2008, parlamenti miratoi Ligjin për Pastërtinë e Figurave. Duhet të kishte pasur konsultime më të gjera dhe konsensus para miratimit të ligjit. Gjykata Kushtetuese pezulloi zbatimin e këtij ligji që aktualisht është në proces rishikimi.

Koordinimi horizontal i çështjeve të integritit evropian është përmirësuar nëpërmjet forcimit të njësisve të integritit evropian në të gjitha ministrinë e linjës, dhe ngritjes së grupeve ndërministrorë të punës për hartimin e strategjive sektoriale.

Janë marrë disa masa për të përmirësuar monitorimin dhe koordinimin mes agjencive në lidhje me angazhimet e MSA-së. Në prill u ngrit Komiteti Koordinues Ndërministror për Integritimin Evropian për të forcuar rolin koordinues të Ministrisë së Integritit. Në Ministrinë e Integritit, është arritur progres i pjesshëm në forcimin e kapaciteteve administrative dhe plotësimin e vendeve vakante. Drejtoria e sapoformuar e Përkthimit të *acquis* rekrutoi 8 punonjës.

Progres i pjesshëm është arritur në përkthimin e *acquis*, me krijimin e një baze të dhënash me aktet e përkthyer të *acquis*. Në janar u miratua një vendim për "përafrimin ligjor" sipas të cilit projektligjet duhet të shoqërohen me tabela konkordance. Gjithashtu, janë realizuar vlerësime të mangësive legjislative për kriteret politike dhe për disa sektorë. Përpjekjet trajnuese vazhduan. Përafrimi i legjislacionit me *acquis* mbetet një sfidë madhore.

Progres i pakët është arritur në zbatimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, dhe mungon një bazë e kolauduar të dhënash për përafrimin e legjislacionit. Hyrja në fuqi e MSA-së



në prill, nuk u shoqërua me forcimin e kapaciteteve administrative që merren me monitorimin e angazhimeve të MSA-së. Kapacitetet e koordinimit ndërinstitucional mbeten të dobëta. Kapacitetet administrative për zbatimin e angazhimeve të MSA-së, si një prioritet kyç i Partneritetit Evropian, duhet të forcohen më tej.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) vazhdon të përbëjë kuadrin strategjik të qeverisë dhe mbulon 36 strategji sektoriale, nga të cilat 24 janë miratuar deri tani. Në SKZHI, zbatimi i MSA-së përcaktohet si prioritet kryesor në kuadrin e integritit evropian. Megjithatë, përcaktimi i kostove dhe indikatorët e performancës sipas sektorëve, mbeten jo të njëtrajtshëm.

Planifikimi i qeverisë është përmirësuar. Sistemi i Planifikimit të Integruar vendosi lidhjet midis sektorëve kyç të integritit evropian. Megjithatë, kapacitetet qendrore koordinuese mbeten të kufizuara për sa i përket zbatimit.

*Në përgjithësi*, Shqipëria ka vazhduar të bëjë progres të pjesshëm në forcimin e strukturave qeveritare me qëllim përmbushjen e angazhimeve të MSA-së, një prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Megjithatë, nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve, koordinimit dhe planifikimit strategjik për integrimin evropian.

#### *Administrata publike*

Në këtë fushë është arritur progres i pakët. Kuadri ligjor është përgjithësisht i plotësuar nga Ligji për Shërbimin Civil, por zbatimi mbetet problematik. U miratua Strategjia për Reformën në Administratën Publike, por zbatimi nuk ka filluar. Janë marrë disa masa për të përmirësuar menaxhimin e burimeve njerëzore, por zbatimi i sistemit të ri të shpërblimit për nëpunësit civilë, ka qenë jo i njëtrajtshëm. Për sa i përket financimit të administratës publike, është arritur progres i pjesshëm me miratimin e Ligjit organik për Buxhetin. Megjithatë, kapacitetet administrative të Departamentit të Administratës Publike (DAP) mbeten të dobëta. Ndërgjegjësimi për çështjet e mashtrimit në radhët e nëpunësve civilë, përfshi mashtrimin me fonde të BE-së, është i pamjaftueshëm. Nevojitet një sistem adekuat i menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike.

Kanë vazhduar lëvizjet me motivim politik të nëpunësve publikë edhe pse në masë më të ulët. Numri i vendeve vakante që zihen nga nëpunës me kontratë mbetet i lartë, rreth 20% i të gjitha vendeve vakante. Kjo praktikë minon zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil dhe krijon hapësirë për politizimin e administratës. Rekrutimi në shërbimin civil vazhdon të bëhet me procedura jotransparente.

Kapacitetet e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) janë përmirësuar nëpërmjet rekrutimit dhe trajnimit të stafit drejtues dhe drejtuesve të qendrave trajnuese. Megjithatë, roli i DAP-it si garantues i zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil, veçanërisht për sa i takon emërimeve politike, duhet të forcohet më tej, ashtu si edhe kapacitetet e ITAP-it.

*Në përgjithësi*, kuadri ligjor për reformën në administratë publike është i plotësuar, por mungesa e transparencës dhe llogaridhënies në emërime, si prioritet kyç i Partneritetit Evropian, mbetet për t'u arritur. Nevojitet progres i mëtejshëm për ngritjen e një shërbimi civil të pavarur, profesional dhe të bazuar në meritë, të çliruar nga ndërhyrjet politike. Zbatimi i plotë i Ligjit për Shërbimin Civil dhe zbatimi i Strategjisë për Reformën në Administratën Publike, janë vendimtare për të arritur progres në këtë drejtim.

## *Sistemi gjyqësor*

Progres i pakët është arritur në plotësimin e kuadrit ligjor për reformën në gjyqësor. U miratuan ndryshime në Ligjin për Prokuroritë e Përgjithshme. Këto ndryshime qartësojnë strukturën e karrierës së prokurorive të përgjithshme dhe vendosin kritere të përmirësuara për rekrutimin dhe ngritjen në detyrë. Megjithatë, pritet një strategji afatgjatë gjithëpërfshirëse për reformën në gjyqësor. Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit për Pushtetin Gjyqësor ka proceduar ngadalë. Ligji për Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD) dhe Ligji për Gjykatat Administrative, pritet të miratohen. Kapacitetet administrative të KLD-së mbeten të dobëta. Përpijekjet e qeverisë për të zvogëluar pavarësinë e gjyqësorit, politizuan debatën për reformën në gjyqësor dhe penguan progresin.

Prokuroria e Përgjithshme përfundoi hetimin për shpërthimin e depove të armëve në Gërdec në vitin 2008. Në Gjykatën e Lartë u ngritën akuza ndaj 29 personave, përfshi edhe Ministrin e Mbrojtjes. Gjyqi u shty disa herë për arsye procedurale dhe Gjykata e Lartë vendosi në shtator pushimin e çështjes kundër ish-ministrit të Mbrojtjes, Mediu, bazuar në imunitetin si deputet i parlamentit. Për të siguruar reputacion në luftën kundër korrupsionit, nevojitet proces i drejtë dhe transparent për dënimin e të gjithë personave përgjegjës, pavarësisht postit. Progres i pakët është bërë në korrigjimin e mangësive në standardet e shëndetësisë dhe sigurisë, të cilat ishin pjesë e hetimit për Gërdecin (*Shiko edhe seksionin 4.1.8*)

Në nëntor 2008, u miratua Ligji për Shërbimin Përmbartimor Privat, që mundëson realizimin e detyrave përmbartuese nëpërmjet përmbartuesve privatë. Ngritja e sistemit përmbartimor dybinarësh (privat dhe publik) do të ndihmojë në ekzekutimin e vendimeve të gjykatave. Megjithatë, pritet miratimi i akteve nënligjore që ky shërbim të fillojë punën.

Ligji për Avokaturën e Shtetit u miratua në nëntor 2008. Avokatura e Shtetit po ngrihet dhe rekrutimi ka filluar. Ky organ do të mbrojë dhe përfaqësojë shtetin në gjykatat shqiptare dhe ndërkombëtare, përfshi Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Strasburg. Në dhjetor 2008, u miratuan ndryshimet në Kodin Penal në lidhje me krimin kibernetik, duke përmbushur kështu detyrimet që rrjedhin nga ratifikimi i Konventës kundër Krimit Kibernetik.

Gjykata Kushtetuese ka dhënë vendime për çështje të administratës publike dhe për Ligjin për Organizimin e Gjyqësorit. Vendimet e tjera përfshijnë ankime nga operatorë ekonomikë si kufizimet në importin e naftës, apo aksesin në treg të operatorëve celularë.

Inspektimet gjyqësore vazhdojnë të jenë kompetencë e dyzuar ndërmjet KLD-së dhe Ministrisë së Drejtësisë. Kompetencat e inspektorateve të KLD-së dhe ato të Ministrisë së Drejtësisë, mbeten për t'u qartësuar. Inspektimet nga të dy inspektoratet dhe procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve shpesh nuk përmbushin standardet evropiane dhe dobësojnë pavarësinë e gjyqësorit. Miratimi i Ligjit për KLD-në do të jetë vendimtar në këtë drejtim.

Shkolla e Magjistraturës e shtoi numrin e programeve arsimore/trajnuese pa shkëputje nga puna të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, duhen burime financiare të mjaftueshme për të zgjeruar fushën e trajnimeve të specializuara dhe për të garantuar qëndrueshmërinë.

Në lidhje me infrastrukturën gjyqësore, godina e Gjykatës së Krimeve të Rënda në Tiranë ka përfunduar, dhe seksioni penal i Gjykatës së rrethit Tiranë është zhvendosur; kjo ka lehtësuar problemin e mbipopullimit. Megjithatë, infrastruktura e gjykatave mbetet e dobët. Seancat

gjyqësore në zyrat e gjyqtarëve vazhdojnë të jenë të shpeshta dhe aksesit publik në seancat e shqyrtimit të çështjeve mbetet shqetësues.

Caktimi me short elektronik i çështjeve gjyqësore për gjyqtarët, po funksionon mirë. Gjyqtarët që u prekën nga suprimimi i 8 gjykatave të vogla të rretheve gjyqësore në vitin 2007, janë transferuar në gjykata të tjera. Në të gjitha gjykatat është instaluar sistemi kompjuterik për administrimin e çështjeve civile dhe penale. Ministria e Drejtësisë filloi të publikonte në faqen e vet statistika për administrimin e çështjeve. Megjithatë, procedurat e gjykatave mbeten problematike për sa i takon efikasitetin dhe transparencën.

Buxheti për gjyqësorin u rrit për vitin 2009. Administrimi i zyrës së buxhetit gjyqësor është përmirësuar. Megjithatë, financimi i gjyqësorit mbetet i pamjaftueshëm për të garantuar funksionimin e duhur të administratës së gjykatave.

Numri i rasteve të vrasjeve për gjakmarrje-hasmëri po ulët për shkak të përmirësimit të ndjekjes penale të autorëve dhe përpjekjeve pajtuese të shoqërisë civile. Mbi 1000 familje u privuan nga e drejta e votës në zgjedhje, sepse nuk mund të dilnin nga shtëpitë për të aplikuar për karta identiteti dhe/ose për të votuar. Duhet të miratohet një strategji e koordinuar që mbulon gjakmarrjen, përfshi krimet që hyjnë në të drejtën zakonore.

*Në përgjithësi*, reforma në gjyqësor mbetet në një fazë fillestare. Nuk janë miratuar akte ligjore që janë kyçe për plotësimin e kuadrit ligjor. Sistemi i drejtësisë vazhdon të funksionojë dobët për shkak të mangësive në pavarësi, transparencë dhe efikasitet, që janë prioritete kyçe të Partneritetit Evropian që duhen përmirësuar. Një strategji gjithëpërfshirëse për përmirësimin e sistemit gjyqësor do të jetë vendimtare për progresin në këtë fushë.

### *Politika antikorupsion*

Qeveria ka koordinuar më mirë përpjekjet në luftën kundër korrupsionit në disa fusha. Në rastet kur korrupsioni vjen si pasojë e kontaktit direkt mes sektorit privat dhe administratës, janë marrë masa që synojnë reduktimin e kontaktit personal me zyrtarët. Masat përfshijnë reduktimin e burokracisë dhe reformën e procedurave (prokurimi *online*, pagimi i taksave dhe tatimeve *online*, *one-stop-shop* për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve dhe qeverisja elektronike). Progres raportohet në sektorin e arsimit, si për shembull në provimet e pranimit në universitet ku përdoret sistem anonim për të kufizuar fushën e veprimit të korrupsionit.

Strategjia ndërsektoriale për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit 2008-2013 u miratua në tetor 2008, e ndjekur nga miratimi i planit të veprimit në janar 2009. Zbatimi i tyre ka filluar. Megjithatë, mungojnë mekanizma dhe afate zbatimi realiste, si edhe indikatorë të kontrollueshëm dhe burimet adekuate.

Progres vihet re në përmirësimin e legjislacionit në përputhje me Konventën Civile të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit. Në mjaft fusha të tjera, përpjekjet e qeverisë kundër korrupsionit po ngelin në fazën e strategjisë ose zbatohen në mënyrë përzgjedhëse. Nga 13 rekomandime të raportit të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës (GRECO) për Shqipërinë, mbeten për t'u plotësuar vetëm 2 rekomandime në lidhje me rregullat e financimit të partive politike.

Vendosmëria dhe transparenca e trajtimit të rasteve të korrupsionit, pavarësisht nga posti i personave të përfshirë, do të jenë indikatorë të rëndësishëm për pavarësinë e institucioneve të

drejtësisë. Duhet vullnet politik më i fortë për të çrrënjësuar kulturën e mosndëshkimit, e cila vazhdon të mbizotërojë.

Mungesa e progresit të qenësishëm në reformën e shëndetësisë ka bërë që të ruhet praktika e sigurimit të kujdesit shëndetësor me anë të ryshfetit. Korrupsioni mbetet i lartë pothuajse në të gjithë nivelet e sektorit shëndetësor. Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për reformimin e sistemit të shëndetësisë është masë kyçe në këtë drejtim.

Mungesa e transparencës dhe baza e paqartë ligjore në fushën e të drejtës së pronës ka favorizuar praktikën korruptive në këtë sektor.

Transparenca e financimit të partive politike mbetet një çështje shqetësuese që duhet trajtuar. Kodi Zgjedhor kërkon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të mbledhë deklaratat financiare të partive politike; por këtij institucioni i mungojnë mekanizmat e duhur për të hetuar këto deklarata dhe nuk ka dispozitë që bën të detyrueshëm deklarimin e dhuratave nga sektori privat.

Progres është bërë nisur nga rezultatet e arritura nga Njësia e Përbashkët Hetimore për Krimin Financiar dhe Korrupsionin. (*Shiko po ashtu edhe pjesën 4.3*). Megjithatë, kapacitetet hetimore të organeve të sundimit të ligjit dhe të prokurorisë mbeten të dobëta për shkak të mangësive në ekspertizë, koordinimit të dobët ndërmjet agjencive dhe metodave të hetimit. Përqindja e dënimeve për çështje korrupsioni mbetet e ulët.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) ka vazhduar që të botojë raportin vjetor që përmban deklaratat e të ardhurave të funksionarëve publikë; kjo praktikë synon të luftojë konfliktin e interesit. Në mars u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi mes ILDKP dhe Drejtorisë së Investigimit të Tatim-Taksave. Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit (DKBAAK) vazhdoi që të kryejë kontrole të punës në administratën publike. Megjithatë, kërkohet forcim i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të institucioneve mbikëqyrëse dhe audituese, veçanërisht në fushat e konfliktit të interesave dhe financimit të partive politike.

*Në përgjithësi*, Shqipëria ka vazhduar të luftojë korrupsionin, si një prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Kuadri ligjor dhe strukturat ndërinstitucionale janë krijuar, por zbatimi mbetet jo i njëtrajtshëm. Angazhimi i autoriteteve për të luftuar korrupsionin nuk është mbështetur me zbatim të qëndrueshëm të legjislacionit. Nevojitet një qasje më sistematike dhe strategjike në luftën kundër korrupsionit, duke krijuar sistemet e llogaridhënies në administratën publike dhe organet gjyqësore, dhe duke rritur transparencën. Duhet të krijohet një vazhdimësi bindëse e dënimeve dhe ndëshkimeve të dhëna për çështje të korrupsionit, veçanërisht për korrupsionin e nivelit të lartë. Korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem veçanërisht serioz.

## 2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

*Respektimi i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*

Shqipëria ka ratifikuar shumicën e **instrumenteve evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut**. Në dhjetor 2008, Shqipëria ratifikoi Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura. Gjithashtu, në prill 2009 u ratifikua Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve Kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual. Megjithatë, Shqipëria ende nuk ka

nënshkruar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, apo Kartën Evropiane për Gjuhët Minoritare ose Rajonale.

**Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut** dha pesë vendime, sipas të cilave Shqipëria kishte shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet përkatëse, për rastet në lidhje me aksesin në gjykatë dhe të drejtat e pronësisë, si dhe ndalimin e trajtimit degradues dhe paraburgimit të paligjshëm. Numri total i ankimimeve që presin vendim në këtë Gjykatë lidhur me Shqipërinë, është 219. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Shqipëria ka kuadër ligjor adekuat që garanton **promovimin dhe forcimin e të drejtave të njeriut**. Megjithatë, legjislacioni ekzistues shpesh nuk zbatohet në praktikë, sidomos në fushën e parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit, barazisë gjinore, mbrojtjes së fëmijëve dhe diskriminimit.

#### *Të drejtat civile dhe politike*

Në lidhje me **parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit dhe luftës kundër mosndëshkimit**, Shqipëria ka bërë progres të pjesshëm në luftimin e abuzimit fizik të të burgosurve. Agjencitë e sundimit të ligjit kanë përndjekur çështje të keqtrajtimit dhe u shkarkuan oficerë policie. Janë përmirësuar mekanizmat që monitorojnë kushtet në burgje, për shkak të vizitave të shpeshta të Avokatit të Popullit që vepron si Mekanizëm Kombëtar i Parandalimit të Torturës. Megjithatë, akuzat për ushtrim të tepruar dhune gjatë ndalimit nga policia, mbeten çështje shqetësuese. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për trajnimin e oficerëve të zbatimit të ligjit dhe reduktimin e ndërrimeve të shpeshta të personelit të trajnuar të burgjeve.

Progres i pjesshëm është arritur në parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit. Avokati i Popullit vazhdoi të luajë rol aktiv në hetimin e pretendimeve për dhunim të të drejtave themelore dhe në dhënien e rekomandimeve. Ky institucion mori 2,862 ankesa gjatë vitit 2008. Shumica e ankesave kishin të bënin me burgjet, policinë dhe të drejtat e pronësisë. Avokati i Popullit ka shprehur shqetësim të veçantë për kushtet në qendrat e paraburgimit dhe burgje. Kërkohet angazhim i mëtejshëm për të zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të Komitetit Evropian për parandalimin e torturës.

Në lidhje me **aksesin në drejtësi**, në prill 2009 hyri në fuqi Ligji për Ndihmën Ligjore. Ky ligj u siguron shërbime ligjore falas të miturve, dëshmitarëve ose personave në nevojë. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Ligjore është caktuar, por nuk ka filluar nga puna. Megjithatë, emërimi i Komisionit të Ndihmës Ligjore pritet të kryhet dhe zbatimi nuk ka filluar. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar aksesin në ndihmën ligjore për grupet në nevojë, siç janë viktimat e dhunës në familje dhe disa minoritete, në veçanti romët.

Për sa i takon **sistemit të burgjeve**, parlamenti miratoi në dhjetor 2008 Ligjin për Policinë e Burgjeve. Në mars 2009, qeveria miratoi Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve që përmban dispozita për të drejtat e punësimit dhe të arsimimit të të burgosurve. Ngritja e seksioneve për të miturit në disa prokurori inkurajoi përdorimin e dënimeve alternative të të miturve dhe lehtësuan ngarkesën e qendrave të paraburgimit dhe burgjeve.

Mjaft burgje janë rehabilituar për të përmirësuar kushtet e jetesës. Ndërtimi i një institucioni rehabilitimi të të miturve në Kavajë dhe i një qendre të re paraburgimi në Durrës përfundoi në qershor 2009. Këto dy qendra ndihmojnë në lehtësimin e mbipopullimit. Numri total i të

paraburgosurve është ulur. Megjithatë, mbetet shumë lart, mbi kapacitetet. Kushtet e përgjithshme në burgje mbeten nën standarde. Rastet e rryshfetit dhe dhunës së tepruar në burgjet shqiptare mbeten për t'u parandaluar. Progresi në zhvillimin e skemave rehabilituese për të burgosurit, si programet e arsimimit, punësimit dhe ato sociale do të jenë vendimtare për progresin në këtë fushë.

Në dhjetor 2008, parlamenti miratoi ndryshimet në Kodin Penal në lidhje me dënimin alternativ. Në zbatim të këtij ligji u miratua në mars 2009 Rregullorja për Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës po fillon të funksionojë, por gjyqësori po i aplikon me ngadalësi dënimet alternative.

Në përgjithësi, progres është arritur në ngritjen e shërbimit të provës dhe në përmirësimin e sistemit të burgjeve dhe të paraburgimit, por mbipopullimi vazhdon dhe standardet e burgjeve të vjetra mbeten të ulëta.

Në lidhje me **lirinë e shprehjes**, gazetaria hetuese kontribuoi në demaskimin e disa praktikave korruptive. Megjithatë, ekzekutivi ka ushtruar njëfarë presioni, kryesisht financiar, por edhe nëpërmjet aksioneve përzgjedhëse ndaj operatorëve mediatikë. Disa operatorëve mediatikë u përzonë nga ambientet në pronësi të shtetit. Interesat e biznesit dhe ato politike vazhdojnë të ndikojnë në pavarësinë e medias për sa i përket pavarësisë editoriale dhe kapaciteteve profesionale.

Mbulimi mediatik i fushatës zgjedhore ishte shpesh i njëanshëm. Në lidhje me mbulimin e mediave, raporti i monitorimit të OSBE/ODIHR konstatoi se gjatë fushatës zyrtare zgjedhore, mbulimi për partitë kryesore ka qenë i balancuar. Por raporti vëren se të gjithë transmetuesit shfaqën njëanshmëri në favor të PD-së ose PS-së. Televizioni publik shqiptar nuk garantoj plotësisht kohë transmetimi të barabartë për të gjithë partitë politike. Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit (KKRT) ka avancuar përgatitjet për Strategjinë Kombëtare për Digjitalizimin e Televizioneve. Megjithatë, ende nuk është miratuar Ligji për Transmetimet Numerike. Ligji për radiot dhe televizionet publike dhe private ende nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pritet miratimi i ndryshimeve në Kodin Penal dhe Civil për dekriminalizimin e shpifjes dhe ofendimit, si dhe zbatimi i ligjit për aksesin në informacion.

Në lidhje me kapacitetet administrative, nuk raportohet progres për kapacitetet monitoruese të KKRT-së. KKRT-ja ka favorizuar mediat në favor të qeverisë. Gjyba e vënë nga KKRT-ja ndaj një transmetuesi televiziv privat nxiti reagimin e Avokatit të Popullit. Kjo gjë ngre pyetje për pavarësinë e KKRT-së.

Reforma e transmetuesit publik ka ndaluar. Influenca e vazhdueshme e qeverisë pati ndikim negativ në pavarësinë e institucionit. Përqindja e ulët e arkëtimit të tarifës së licencimit mbetet çështje shqetësuese.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres në plotësimin e kuadrit ligjor për mediat. Nevojiten më tepër përpjekje për të përmirësuar klimën e përgjithshme të medias, për të finalizuar strategjinë e digjitalizimit dhe për të miratuar legjislacionin kyç për transmetimet, për dekriminalizimin e shpifjes, për informimin publik dhe për transparencën e pronësisë së mediave.

Nuk ka pasur kufizime në **lirinë e tubimit dhe organizimit**.

Progres vihet re për sa i takon **organizatave të shoqërisë civile**. Marrëdhëniet midis shoqërisë civile dhe qeverisë janë përmirësuar. Ligji për krijimin e Fondacionit të Shoqërisë Civile hyri në fuqi. Megjithatë, nevojiten përpjekje më të mëdha për të ndihmuar sektorin jofitimprurës dhe për

t'u konsultuar me organizatat e shoqërisë civile në lidhje me reformën ligjore dhe administrative. Regjimi fiskal që rregullon organizatat jofitimprurëse mbetet i paqartë dhe duhet të sqarohet.

Shoqëria civile përfaqësohet me shumë OJF të vogla, të cilat mbeten tejet të fragmentuara. Qeveria ka filluar të konsultohet me organizatat e shoqërisë civile për projektligjet, dhe të angazhohet me një rang të gjerë grupesh interesi. Megjithatë, nuk ka mekanizma formalë të miratuar për të tilla konsultime. Mekanizmat koordinuese që nxisin pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave mbetet i dobët.

Në lidhje me **lirinë e besimit**, qeveria nënshkroi një marrëveshje me tre komunitetet kryesore fetare për rregullimin e marrëdhënieve të tyre me shtetin. Në shkurt, u miratua Strategjia Kombëtare për Aleancën e Qytetërimeve në mbështetje të dialogut ndërkulturor dhe ndërfaqësor. Marrëdhëniet ndërfaqësore vazhdojnë të jenë të mira. Megjithatë, nuk ka pasur progres në zgjidhjen e çështjes së rikthimit të pronave komuniteteve fetare.

### *Të drejtat ekonomike dhe sociale*

Progres i pjesshëm është arritur me **të drejtat e grave**. Kodi Zgjedhor përcaktoi kuotën gjinore 30%. Partitë politike përgjithësisht e respektuan këtë kuotë në listën e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare. Përfaqësimi i grave në parlament u dyfishua krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, duke e çuar në 23 numrin e deputeteve. Megjithatë, disa lista nuk e respektuan këtë kuotë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk dha ndëshkimet e parashikuara në Kodin Zgjedhor për këtë çështje.

Në janar 2009, u krijua Këshilli Kombëtar për Barazi Gjinore. Megjithatë, vazhdon të ketë përfaqësim të ulët të femrave në nivelet e larta të zgjedhura/të emëruara të organeve si vendore edhe qendrore.

Barazia gjinore garantohet me ligj, por zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe i politikave, është i pamjaftueshëm. Shumica e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit për Dhunën në Familje janë miratuar. Po ngrihet një strehë publike për viktimat e dhunës në familje. Megjithatë, dhuna në familje vazhdon të jetë e përhapur. Shumë incidente nuk denoncohen. Mungojnë të dhëna të besueshme. Kërkohen masa të mëtejshme për forcimin e nivelit të mbrojtjes për femrat viktime të dhunës në familje, përfshi fushata ndërgjegjësimi dhe trajnim të specializuar për gjyqtarët.

Në përgjithësi, është arritur progres i pjesshëm në mbrojtjen e të drejtave të femrave. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të promovuar me efikasitet barazinë gjinore. Dhuna në familje mbetet një shqetësim serioz. Mbrojtja e grave kundër të gjitha formave të dhunës, duhet të forcohet ndjeshëm.

Progres i pjesshëm është arritur për **të drejtat e fëmijëve**. Në nëntor 2008, parlamenti miratoi ndryshimet në Kodin Penal që tashmë e cilëson veprën penale përdorimin e fëmijëve për materiale pornografike. Janë përgatitur masat zbatuese të Strategjisë për Kujdesin në Familje, por mungojnë standardet e zbatimit dhe burimet e duhura. Për drejtësinë ndaj të miturve, ka vazhduar progresi në zbatimin e masave alternative ndaj burgimit të të miturve. Plot 42% e të gjitha dënimeve jepen në formë shërbimi për komunitetin. Sistemi për mbrojtjen e fëmijëve nga 14-18 vjeç është përmirësuar për sa i takon dispozitave ligjore, njohurive profesionale dhe përdorimit të dënimeve alternative. Megjithatë, sistemit të drejtësisë për të miturit i mungojnë mekanizmat e reagimit dhe referimit për fëmijët nën 14 vjeç që kryejnë krime.

Shqipëria mbetet një vend origjine i trafikimit të fëmijëve për shfrytëzim seksual dhe punë të detyruar. Në nivel vendor janë ngritur njësi të mbrojtjes së fëmijëve si pjesë e një sistemi referimi për fëmijët në rrezik. Megjithatë, regjistrimi i fëmijëve nuk është realizuar plotësisht, sidomos në zonat e varfra dhe në komunitetin rom. Braktisja e shkollës, fëmijët e rrugës dhe puna e fëmijëve vazhdojnë të jenë shqetësime serioze. Ngritja e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve, përfshi mekanizmat efikase ri-integruese për fëmijët viktime të shfrytëzimit dhe fëmijët pa përkrahje, do të jenë vendimtare për progresin në këtë fushë.

Në përgjithësi, vazhdon të ketë progres të pjesshëm në fushën e të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin e plotë të legjislacionit dhe politikave ekzistuese për të garantuar mbrojtje efikase të fëmijëve.

Në lidhje me **shtresat pa përkrahje dhe individët me aftësi të kufizuara**, pas fushatave protestuese të OJF-ve, qeveria përmirësoi disa nga paketat e asistencës për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, legjislacioni ekzistues dhe masat administrative nuk janë zbatuar plotësisht. Mungojnë statistikat për njerëzit me aftësi të kufizuara. Aksesit në punësim vazhdon të jetë problematik.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara mbetet për t'u plotësuar. Shqipëria nuk ka nënshkruar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe protokollin e saj. Ligji për Personat me Aftësi të Kufizuara mbetet për t'u miratuar. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara vazhdon të jetë i ngadalhtë. U miratuan masa të reja në planifikimin urban për të lehtësuar lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, por zbatimi nuk ka filluar.

Nuk ka ndryshime të qenësishme në fushën e **të drejtave të punës dhe sindikatave**. Ligji lejon krijimin e sindikatave dhe shoqatave të punëtorëve. Megjithatë, këto organizata vazhdojnë të jenë të dobëta dhe të fragmentuara për shkak të mbizotërimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ekonomisë së madhe informale. Vazhdojnë të ekzistojnë dispozita ligjore që iu mohojnë punëtorëve shtetërorë të drejtën e grevës, çka nuk është në linjë me Kartën Evropiane Sociale. Pozitat e sindikatave dhe organizatave të punëtorëve mbeten të dobëta. Përgatitjet për dialog social mbeten në fazë fillestare.

Në lidhje me politikat e **antidiskriminimit**, diskriminimi mbi bazë gjinie, race, gjuhe apo besimi ndalohet me ligj. Megjithatë, Ligji kundër Diskriminimit i përgatitur në konsultim me shoqërinë civile ende nuk është miratuar. Praktikant diskriminuese kundër grave dhe disa grupeve minoritare, siç janë romët, janë të përhapura. Në Shqipëri nuk ekzistojnë më organizata aktive operuese të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve apo transseksualëve. Këta persona janë objekt diskriminimi. Qeveria nuk ka marrë ndonjë masë për zhvillimin e një programi masash kundër diskriminimit, përfshi atij mbi baza orientimi seksual dhe identiteti gjinor.

Progresi i pakët është arritur në konsolidimin e të **drejtave të pronësisë**. Hartat e vlerësimit të tokës, si bazë thelbësore për kompensim, u finalizuan në të gjithë vendin. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka vazhduar regjistrimin fillestar të pronave në pjesë të ndryshme të vendit, por procesi është i papërfunduar. Ende nuk është realizuar inventari i plotë i tokave shtetërore të planifikuara për kompensim. Çështjet e pazgjidhura ligjore në lidhje me kompensimin e ish-pronarëve vazhdojnë të pengojnë progresin. Numri i padive në gjykatë për konflikte pronësie ka vazhduar të rritet.

Agjencia për Legalizimin e Zonave Informate (ALUIZNI) e shtoi stafin nga 350 në 900 punonjës, me qëllim që të përshpejtonte procesin e legalizimit. Megjithatë, procesi mbetet



jotransparent dhe pak kërkesa legalizimi janë shqyrtuar. Nga fundi i vitit 2008, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) u pagoi disa ish-pronarëve 4 milion euro kompensim. Ndryshime të tjera ligjore u miratuan pjesë-pjesë dhe në mënyrë të pakoordinuar. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për regjistrimin fillestar të pronave, rikthimin e pronave, dhe kompensimin dhe legalizimin e ndërtimeve informale. Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse e shoqëruar me një plan veprimi është vendimtar për këtë fushë.

*Në përgjithësi*, ka pasur progres të pakët në konsolidimin e të drejtave të pronësisë, si një prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Problemet që lidhen me reformën e pronësisë kërkojnë përqasje të gjerë dhe krijimin e një kuadri të plotë ligjor dhe institucional. Pasiguritë në të drejtat e pronësisë vazhdojnë të pengojnë zhvillimin e tregut funksional të tokës dhe mbajnë investimet e huaja nën potencialin real.

#### *Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve*

Kushtetuta garanton mbrojtjen e civilëve, të drejtat ekonomike, sociale dhe politike të pakicave dhe ligji ndalon trajtimin diskriminues. Ka tre pakica të njohura kombëtare (greke, maqedonase dhe serbo-malazeze) dhe dy pakica etno-gjuhësore (arumune dhe rome) në Shqipëri. Komuniteti egjiptian po kërkon statusin e një pakice etno-kulturore. Në lidhje me **të drejtat kulturore**, Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare mbetet për t'u miratuar.

Shqipëria ka vazhduar të zhvillojë kuadrin ligjor me synimin për të përmirësuar zbatimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve. Janë nënshkruar marrëveshje mes autoriteteve qendrore dhe vendore lidhur me vendosjen e emrave tradicionalë vendorë në gjuhët e pakicave. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të ulur tensionet ndëretnike. Kuadri ligjor për mbrojtjen e pakicave, duke përfshirë kufizimet territoriale, politikën e arsimit dhe dallimin në mes kategorive, duhet të sqarohet bazuar në të dhënat statistikore të përditësuara. Vazhdon të mos ketë të dhëna të sakta mbi pakicat. Regjistrimi i ardhshëm i popullsisë, duke respektuar standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave, do të jetë vendimtar për të adresuar këtë çështje.

Ligji i Shërbimit Civil parashikon pjesëmarrjen e pakicave në administratën publike, forcat e armatosura dhe polici. Janë bërë përpjekje për të rekrutuar persona që u përkasin minoriteteve veçanërisht romëve, në polici. Megjithatë përfaqësimi i minoriteteve mbetet i kufizuar.

Kapaciteti institucional i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve mbetet i dobët. Roli i tij si ndërmjetës midis qeverisë dhe përfaqësuesve të minoriteteve, duhet të forcohet më tej në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrje efektive e pakicave në proceset e vendimmarrjes.

*Në përgjithësi*, ka vazhduar progresi në mbrojtjen e të drejtave të pakicave, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar që anëtarët e të gjitha pakicave mund të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre kulturore. Mbledhja e të dhënave të përditësuara mbi numrin e pjesëtarëve të pakicave, është vendimtare për hartimin e një politike kombëtare për minoritetet. Kuadri ligjor për mbrojtjen e minoriteteve duhet të qartësohet dhe zhvillohet më tej.

Lidhur me pakicën **rome** është arritur progres i pjesshëm. Në mars u ngrit një grup ndërministror pune për zbatimin e strategjisë kombëtare. Megjithatë, zbatimi i strategjisë kombëtare po ecën ngadalë. Koordinimi efektiv i autoriteteve qendrore dhe vendore së bashku me bashkëpunimin e përmirësuar të palëve të interesuara, është i dobët.

Nuk ka asnjë informacion për buxhetin e akorduar për zbatimin e strategjisë. Shqipëria nuk ka miratuar ende Planin e Veprimit për Dekadën e Përfshirjes Rome.

Ministria e Brendshme filloi në dhjetor të vitit 2008 një projekt për të regjistruar romët, nga të cilët rreth 50% nuk kanë kartat e identitetit. Në kuadrin e zgjedhjeve të përgjithshme, qeveria lëshoi falas kartat e identitetit për romët dhe shpërndarja u bë me njësi lëvizëse. Megjithatë, regjistrimi nuk është i përfunduar dhe kërkon më tepër vëmendje. Fëmijët romë janë veçanërisht të pambrojtur ndaj trafikimit për shkak të mosregjistrimit të lindjeve dhe norma e ulët e regjistrimit në shkollë.

*Në përgjithësi*, minoritetit rom vazhdon të përballlet me kushte shumë të vështira të jetesës, me varfëri dhe diskriminim, veçanërisht në lidhje me aksesin në arsim, mbrojtjen sociale, kujdesin shëndetësor, punësimin dhe strehimin e përshtatshëm.

### 2.3. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Shqipëria vazhdon të ketë marrëveshjen dypalëshe të imunitetit me SHBA-në, të nënshkruar në vitin 2003, që i jep përjashtim nga juridiksioni i **Gjykatës Ndërkombëtare Penale**. Kjo nuk është në përputhje me qëndrimet e përbashkëta të BE-së për integritetin e Statutit të Romës apo me parimet orientuese për marrëveshjet dypalëshe të imunitetit. Shqipëria e ka të nevojshme të vihet në linjë me qëndrimin e BE-së.

Shqipëria vazhdon të monitorohet nga Asambleja Parlamentare e **Këshillit të Evropës**, për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve në lidhje me anëtarësimin e saj në Këshillin e Evropës.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë përbëjnë një pjesë thelbësore të rrugës drejt Bashkimit Evropian. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë aktive në nismat rajonale, përfshi Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe Marrëveshjen e Zonës së Përbashkët Ajrore Evropiane (ECAA)

**Marrëdhëniet dypalëshe me vendet e tjera aspirante dhe shtetet anëtare fqinje**, vazhduan të jenë pozitive. Është rritur numri i aktiviteteve dypalëshe dhe i vizitave me vendet e rajonit.

Shqipëria ka ruajtur marrëdhëniet e mira me *ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë* dhe bashkëpunimi ka vazhduar të rritet. Zbatimi i marrëveshjes dypalëshe për heqjen e vizave ka filluar dhe marrëveshja për patrullimin e përbashkët të kufijve ka hyrë në fuqi.

Marrëdhëniet me *Malin e Zi* u intensifikuan dhe shkëmbimet u rritën, përfshi nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në shkencë, teknologji dhe kulturë, dhe miratimin e masave në luftën kundër krimit të organizuar. Ndërtimi i pikës së përbashkët kufitare në Muriqan-Sukobine ka përfunduar. Shqipëria zhvilloi më tej marrëdhëniet e mira me *Kroacinë*. Marrëdhëniet e saj me *Bosnjë-Hercegovinën* u intensifikuan dhe u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, emigracionit të paligjshëm dhe kontrabandës së drogës, dhe në bashkëpunimin doganor. U nënshkrua edhe një marrëveshje dypalëshe për heqjen e vizave dhe një marrëveshje ripranimi.

Marrëdhëniet me *Serbinë* kanë qëndruar normale, megjithëse u ndikuan nga njohja që Shqipëria i bëri pavarësisë së Kosovës<sup>4</sup>. Nuk ka pasur vizita politike dypalëshe, por pati takime të nivelit të

---

<sup>4</sup> sipas Rezolutës 1244/1999 të KS të OKB

lartë në suazën e aktiviteteve rajonale dhe ndërkombëtare. Kontaktet kanë qenë të vazhdueshme në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor. Bashkëpunimi ekonomik ka avancuar dhe në mars 2009 u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Dhomave të Tregtisë të Serbisë dhe Shqipërisë.

Shqipëria ka vazhduar të zhvillojë marrëdhëniet me *Kosovën*. Janë intensifikuar kontaktet e nivelit të lartë dhe janë nënshkruar marrëveshje të reja, si ato për lëvizjen e lirë të njerëzve, dhe hapjen e pikave të përbashkëta kufitare dhe doganore. Punimet për aksin Durrës-Kukës, që do ta lidhë Shqipërinë me Kosovën, kanë avancuar mjaft mirë.

Marrëdhëniet politike, ekonomike dhe kulturore me *Turqinë* kanë vazhduar të intensifikohen. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në luftën kundër pastrimit të parave. Marrëveshjet janë nënshkruar me qëllimin që të hiqet regjimi reciprok i vizave.

Marrëdhëniet me *Italinë* vazhduan të jenë shumë të mira dhe u konkretizuan me një numër projektesh të përbashkëta në sektorë kyçë, si energjia dhe bujqësia. Italia vazhdon të jetë partneri kryesor në shkëmbimet tregtare. Marrëdhëniet me *Greqinë* vazhduan të jenë shumë të mira. Greqia vazhdon të jetë partneri i dytë tregtar i Shqipërisë. Në vitin 2009, të dy vendet nënshkruan marrëveshje dypalëshe të rëndësishme në fusha si energjia, punësimi sezonal dhe drejtësia dhe çështjet e brendshme.

Shqipëria u bë anëtare e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në prill 2009.

*Në përgjithësi*, Shqipëria ka vazhduar të kujdeset për marrëdhënie pozitive me partnerët e saj rajonalë, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal.

### **3. KRITERI EKONOMIK**

Në ekzaminimin e zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, komisioni bazohet në përfundimet e Këshillit Evropian në Kopenhagen në qershor 1993, ku shprehej se anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale dhe kapacitetet për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

#### **3.1. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale**

##### *Politika ekonomike*

Në shkurt, Shqipëria dorëzoi Programin e tretë Ekonomik dhe Fiskal për vitet 2008-2011. Programi paraqet një paketë koherence politikash ekonomike dhe synon konsolidimin e financave publike. Kuadri afatmesëm makroekonomik dhe fiskal u rishikua në maj, me qëllim që të reflektoheshin ndikimet e jashtme dhe ndikimi i krizës ekonomike globale. Rritja ekonomike e vitit 2009 u vlerësua me ulje. Programi pasqyron përmirësime në buxhet dhe në kapacitetet për planifikim projektesh, si edhe statistika më të mira. Ky dokument është i integruar mjaft mirë me instrumentet e tjerë të planifikimit afatmesëm, siç janë PBA 2009-2011 dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Në korrik 2009, qeveria miratoi PBA 2010-2012. Përdorimi rregullisht i këtyre instrumenteve të planifikimit afatmesëm tregon se janë përmirësuar kapacitetet administrative të planifikimit dhe zbatimit. Shqipëria përfundoi programin 3-vjeçar 2006-2009 PRGF/EFF<sup>5</sup> me FMN në janar 2009 dhe deri tani nuk ka kërkuar program tjetër. *Në përgjithësi*, janë ruajtur mirë bazat e një ekonomie orientuar drejt tregut.

<sup>5</sup> Poverty Reduction and Growth Facility and Extended Fund Facility.

### *Stabiliteti makroekonomik*

Ekonomia shqiptare regjistroi rritje të fuqishme dhe të qëndrueshme prej 8% në vitin 2008, dhe sipas të dhënave zyrtare, prej 6% në tremujorin e parë të vitit 2009, e nxitur kryesisht nga investimet e mëdha publike në rrjetin rrugor. Sektori privat përfitoi në mënyrë aktive nga rritja e fuqishme, edhe pse në ngadalësim, e kreditimit dhe nga stabiliteti i përmirësuar i furnizimit me energji elektrike. Deri tani, kriza financiare dhe ekonomike ndërkombëtare ka rezultuar në uljen e kërkesës për eksportet shqiptare, rënie të flukseve neto të transfertave monetare në formën e remitançave dhe ngadalësim të ndjeshëm të rritjes së kreditimit. PBB për frymë si fuqi blerëse ishte 25% e mesatares që EU-27 kishte në vitin 2008, ose 24% më shumë se në vitin 2007. *Në përgjithësi*, ekonomia shqiptare vazhdoi të rritet, megjithëse me ritëm më të ngadaltë.

Deficiti i llogarive korrente u thellua në vitin 2008 me 14.5% të PBB, nga 10,5% i PBB që ishte në vitin 2007, çka reflekton përkeqësimin e deficitit tregtar dhe rënien e remitançave. Deficiti tregtar në vitin 2008 arriti 27.2% i PBB, nga 26.5% i PBB në vitin 2007. Importi i mallrave kapitale u rrit me 29% krahasuar me vitin 2007, pjesërisht për shkak të punimeve masive në rrugë publike. Importi i mallrave të konsumit ra me 6% në vitin 2008. Eksportet shqiptare vazhduan të tregojnë varësi të madhe nga industria e fasonëve, e cila përbën 43% të eksportit total. Eksporti i produkteve minerale u rrit ndjeshëm në vitin 2008, por pësoi një tronditje të fortë në vitin 2009, pjesërisht për shkak të rënies së kërkesës ndërkombëtare për krom dhe nikel. Në gjysmën e parë të vitit 2009, eksportet ranë me 21% në bazë vjetore, dhe raporti eksport/import ra në 25.5%, nga 30.8% që ishte në gjysmën e parë të vitit 2008. Remitançat u pakësuan me rreth 16% në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007, që përbën 9.2% të PBB; kjo si pasojë e ndikimit të krizës financiare globale, por edhe e trendit në rënie që vihet re vitet e fundit. Të dhënat për tremujorin e dytë të vitit 2009 tregojnë për rënie të mëtejshme të remitançave me 4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008.

Imbalancat e jashtme mbetën të larta dhe vazhduan të thellohen. Në vitin 2008, fluksi neto i kapitalit mbulonte deficitin e llogarive rrjedhëse dhe kontribuonte në rritjen e rezervave të huaja. IHD (FDI) u rritën me rreth 42% duke kapur nivelin 7% të PBB nga 5.9% në vitin 2007, me një rritje të investimeve *greenfield*. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2009, një tender për një hua prej 250 milion euro iu dha një konsorciumi bankash të huaja. Nëse tërhiqet plotësisht, huaja do të financojë rreth 30% të të gjitha investimeve publike në vitin 2009. Raporti i borxhit të jashtëm u rrit në 18.4% të PBB kundrejt 15.4% në vitin 2007. Financimet e huaja korporative mbetën të papërfillshme. Shqipëria ruajti një nivel të mjaftueshëm rezervash ndërkombëtare me rreth 4.2 muaj importe. *Në përgjithësi*, fluksi i fuqishëm i kapitalit financoi ndjeshëm deficitin e lartë të llogarive korrente në vitin 2008, dhe kjo vazhdoi edhe në gjysmën e parë të vitit 2009, pjesërisht e stimuluar nga procesi i privatizimit.

Shkalla e papunësisë ra lehtësisht në 12.7% në fund të vitit 2008, nga 13.2% në fund të vitit 2007. Rrogat publike u rritën me 8.8% në vitin 2008, ndërsa rroga mesatare në sektorin privat u rrit me 15.1%. në maj të 2009, u bë edhe një rritje tjetër e rrogave të sektorit publik dhe pensioneve. *Në përgjithësi*, pati disa përmirësime në rezultatet e tregut të punës. Megjithatë, papunësia vazhdon të jetë e lartë dhe të dhënat për tregun e punës vazhdojnë të jenë të dobëta.

Është ruajtur stabiliteti i çmimeve. Norma vjetore e inflacionit u rrit në 3.4% gjatë vitit 2008, nga 2.9% që ishte në vitin 2007, por nuk kaloi kufijtë e objektivit prej 2-4% të Bankës së Shqipërisë. Kontribuuesit kryesorë të inflacionit ishin çmimet ndërkombëtare të ushqimeve dhe naftës, si edhe çmimet e brendshme të energjisë. Presioni i inflacionit filloi të zbehet në tremujorin e tretë të vitit 2008, paralelisht me ngadalësimin e rritjes së ofertës në para. Norma e inflacionit vazhdoi

trendin në rënie gjatë tremujorit të parë të 2009, duke zbritur në 1.6% në mars, pastaj u rrit lehtësisht dhe u stabilizua në 2.2% në korrik dhe gusht. Për të zbutur presionet e inflacionit dhe si reagim ndaj krizës financiare ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë e uli normën bazë në janar nga 6.25% në 5.75% dhe filloi t'u jepte likuiditet pa limit bankave me normën aktuale. Tërheqja e depozitave e reduktoi stokun e depozitave me 8.2% në periudhën shtator 2008 deri prill 2009. pastaj, depozitat filluan të rriten prapë që nga maji 2009. Rritja e sigurimit shtetëror të depozitës me 100% për depozitat deri në 25 milion ALL, ishte një element stabilizues. Shqipëria vazhdon të ndjekë një regjim të lirë të luhatjes së kursit të këmbimit. Në vitin 2008, leku u vlerësua me 0.7% dhe 7.2% respektivisht ndaj euros dhe dollarit, ndërkohë që u zhvlerësua në gjysmën e parë të vitit 2009 me 6.5% kundrejt euros dhe 4.5% ndaj USD. *Në përgjithësi*, politika monetare qëndroi e shëndetshme, është ruajtur stabiliteti i çmimeve dhe është siguruar likuiditeti i sektorit bankar pas shpërthimit të krizës. Inflacioni qëndroi brenda kufijve të objektivit.

Gjatë vitit 2008, administrata tatimore bëri progres të mëtejshëm si në mbledhjen e të ardhurave, ashtu edhe në reformat administrative. Të ardhurat tatimore u rritën në 24.3% të PBB krahasuar me 23.2% të PBB në vitin 2007. Aplikimi i normës 10% të taksës së sheshtë për të ardhurat personale vazhdoi të prodhojë efekte në vitin 2008 dhe çoi në rritje të fortë të të ardhurave tatimore. Megjithatë, mbledhja e taksave në nivel vendor mbetet e ulët. Shpenzimet publike në vitin 2008 u rritën me 32.3% të PBB për shkak të rritjes së shpejtë të ritmit të shpenzimeve kapitale, duke kapur vlerën 8.6% të PBB në vitin 2008 krahasuar me 5.8% të PBB në vitin 2007, duke reflektuar projektet e investimeve publike si rruga Durrës-Kukës. 98% e shpenzimeve kapitale të planifikuara u shpenzuan, çka tregon përmirësim të kapaciteteve planifikuese dhe zbatuese të projekteve. Megjithatë, pati tejkalime kostosh si rasti i rrugës Durrës-Kukës. Borxhi i brendshëm publik qëndroi në 36.7% të PBB, ndërsa borxhi i jashtëm publik u rrit në 18.4% të PBB krahasuar me 15.4% të vitit 2007. Pagimi i interesave më të larta reflekton pjesërisht strategjinë për të zgatur maturimin e borxhit publik të Shqipërisë.

Politika fiskale vazhdoi të jetë ekspansioniste në vitin 2008, ashtu si vitin paraardhës. Imbalancat fiskale u përkeqësuan; deficitit buxhetor arriti 5.5% të PBB në vitin 2008. Buxheti i vitit 2009 fillimisht projektoi një deficit prej 4.2% të PBB, bazuar në normën 4.8% të rritjes së PBB. Buxheti përmban një zë kontingjence prej afërsisht 2% të PBB, që përdoret për të adresuar rëniet fiskale. Sidoqoftë, një pjesë e tij është përdorur për të financuar rritjen e pagave të sektorit publik që nga maji 2009. Të ardhurat fiskale treguan performancë të mirë gjatë 5 muajve të parë të vitit 2009, duke shënuar rritje 8.1% në bazë vjetore. Sidoqoftë, meqë buxheti i vitit 2009 ishte bazuar në një kuadër makrofinanciar më të favorshëm, të ardhurat ishin 6% më pak se objektivi. Si rezultat, në verë u përgatit një buxhet i rishikuar që u miratua nga parlamenti në shtator, me rritje të deficitit me 6.4% të PBB në vitin 2009. Financimi i deficiteve fiskale vazhdoi të vendosë një dysheme nën nivelin e normave të interesit të huave për bizneset dhe konsumatorë dhe të devijonte kursimet drejt qeverisë, duke penguar kështu rritjen. Në vitin 2009, për të financuar deficitin, qeveria mbështetet te të ardhurat nga privatizimi dhe huamarrja, në një shkallë që nuk duket e qëndrueshme në planin afatmesëm.

*Në përgjithësi*, politikat fiskale vazhduan të mbështesin rritjen, por duhet të rivlerësohen për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë të financave publike.

*Në përgjithësi*, është ruajtur stabiliteti makroekonomik, pasi kriza ka ushtruar ndikim të kufizuar. Politika monetare reagoi ndaj ndryshimeve në mjedisin ekonomik dhe i siguroi likuiditete sistemit bankar, duke kontribuar në uljen e inflacionit dhe stabilitetin e kursit të këmbimit. Por nga aspekti fiskal, edhe pse planifikimi buxhetor u përmirësua, imbalancat e theksuara buxhetore mbetën element dobësie.

### *Ndërveprimi i forcave të tregut*

Sektori privat angazhoi rreth 83% të krahut të punës në vitin 2008, duke shënuar rritje të lehtë kundrejt vitit 2007. Pjesëmarrja e shtetit në ekonomi u zvogëlua më tej, pasi Shqipëria bëri progres të mirë me zbatimin e agjendës së privatizimit. Në dhjetor 2008, shoqëria e rafinimit të naftës ARMO u shit për 128 milion euro. Aksionet e mbetura në pronësi të shtetit në operatorin celular AMC u shitën për 40 milion euro në shkurt 2009. 76% e kuotave të divizionit të shpërndarjes të KESH-it u shitën për 102 milion euro në prill, duke zbatuar kështu pjesërisht një prioritet kyç të Partneritetit Evropian. Kompania e katërt celulare u licencua në prill 2009 për 7.2 milion euro. Në maj 2009, Banka Botërore miratoi një Garanci të Pjesëshme Risku prej 60 milion euro për privatizimin e divizionit të shpërndarjes të KESH-it. *Në përgjithësi*, qeveria ka bërë progres të mirë në zvogëlimin e zotërimit të shtetit në ekonomi.

### *Hyrja dhe dalja nga tregu*

Qendra Kombëtare e Regjistrimit u bë funksionale dhe regjistroi rreth 18 000 biznese të reja në vitin 2008, ose 29% më shumë se në vitin 2007. Qendra Kombëtare e Licencimit me parimin *one-stop-shop* filloi punë në qershor 2009 dhe u arrit progres substancial në reformimin dhe thjeshtimin e licencimit. Në shkurt 2009, ndryshimet në Ligjin për Planifikimin Urban reduktuan kohën e lëshimit të lejeve të ndërtimit nga 60 në 45 ditë. U përgatit dokumentacioni për dhënien e titujve të pronësisë për mijëra aplikantë, por çështjet e pazgjidhura ligjore në lidhje me kompensimin e ish-pronarëve, vazhduan të pengojnë këtë proces. Nuk janë raportuar raste të zbatimit të Ligjit për Falimentimin. *Në përgjithësi*, progres i mirë është arritur në lehtësimin e mëtejshëm të hyrjes në treg. Megjithatë, procedurat e falimentimit ende nuk përdoren, çka pengon efikasitetin e mekanizmave të tregut.

### *Sistemi ligjor*

Roli i gjykatave në ekzekutimin e kontratave mbetet i kufizuar dhe sistemi ligjor i mungon në masë të madhe autoriteti dhe pranimi publik, pjesërisht për shkak të shkallës së perceptimit të korrupsionit dhe kapaciteteve administrative të dobëta. Metodot informale të ekzekutimit të kontratave që anashkalojnë sistemin ligjor, vazhdojnë të jenë të përhapura. Në janar 2009, qeveria e bëri të detyrueshëm përdorimin *online* të procedurave të prokurimit publik, por Ligji për Gjykatat Administrative nuk është miratuar ende nga parlamenti. Procedurat administrative kanë cenuar zbatimin e Ligjit për Amnistinë Fiskale. Nga fundi i vitit 2008, u ngrit një komision shtetëror për të verifikuar të gjitha titujt e pronësisë të shpërndara në bazë të Ligjit për Tokën, dhe u krijuan komisione rajonale në prefektura për verifikimin e rasteve, çka ngadalësoi më tej transaksionet e pronësisë së tokës. *Në përgjithësi*, sistemi ligjor nuk kontribuoi si duhet në ekzekutimin e kontratave dhe në forcimin e shtetit të së drejtës. Progres i kufizuar është arritur në vendosjen e të drejtave të qartë dhe të mirëpërcaktuara të pronësisë mbi tokën.

### *Zhvillimi i sektorit financiar*

Pas privatizimit të 40% të aksioneve shtetërore të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, sektori bankar u bë plotësisht privat. Huamarrja e jashtme nga ana e sektorit bankar ishte 8,6% në fund të vitit 2008 dhe u rrit më tej në gjysmën e parë të vitit 2009. Kreditimi i bankave për sektorin privat u rrit në vitin 2008 me 34,4% të PBB. Kjo e lë ndërmjetësimin financiar në nivele të ulëta. Normat e interesit të bankave tregtare për hua biznesi dhe konsumatore vazhduan të nxiten nga interesat e paguara për letrat me vlerë të shtetit. Nxjerrja e bonove të thesarit 12-mujore ishte 8,8% në fund të vitit 2008, duke shënuar rritje krahasuar me 8,4% të vitit më parë, dhe u rrit në

9,24% në fund të qershorit 2009. Për pasojë, nevojat për financime publike vazhduan të spostojnë investimet private. Në përgjithësi, bankat vazhduan të ofrojnë një rang të gjerë huash biznesi. Megjithatë, përqindja e ndërmjetësuesve financiarë mbetet e ulët.

Banka e Shqipërisë e forcoi mbikëqyrjen e sektorit privat në fushat si, menaxhimi i riskut të kreditimit, mjaftueshmëria e kapitalit, menaxhimi i riskut nga filiale të bankave të huaja dhe menaxhimi i riskut në kontekst të ekspozimit të gjerë. Për të mbështetur likuiditetin në sistemin bankar, BSH kufizoi shumat që depozitojnë degët e bankave të huaja në institucionet e tyre mëmë. Me shfaqjen e efekteve të krizës ekonomike ndërkombëtare në sektorin e eksportit, përqindja e huave të këqija u rrit nga 4% në mars 2008 në 7.5% në tremujorin e parë të vitit 2009. Huat për biznesin ishin përgjithësisht më problematike sesa huat konsumatorë, me përqindje huash të këqija 7.6% në vitin 2008 kundrejt 3.6% në vitin 2007. Gjithashtu, indikatorët e përfitueshmërisë që qëndruan solidë gjatë vitit 2008, u ulën ndjeshëm në tremujorin e parë të vitit 2009. Përfundimisht, në prill, sektori bankar si i tërë, pas shumë vitesh pësoi të parën humbje financiare neto. Në përgjithësi, sektori bankar vazhdon të jetë i mirë-kapitalizuar dhe likuid. Megjithatë, në gjysmën e parë të vitit 2009, kur u shfaqen efektet e krizës globale, përfitueshmëria ra për shkak të rritjes së huave të këqija dhe bankat filluan të shtrëngojnë kriteret e huadhënies, duke ngadalësuar kështu rritjen e kreditimit.

### **3.2. Aftësia për të përballuar trysninë e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së**

#### *Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale*

Stabiliteti makroekonomik u ruajt në një mjedis ekonomik shumë sfidues. Ka përmirësime në organizimin dhe aksesueshmërinë e regjistrimit kombëtar të tokës, i cili përfshin regjistrimin e pronës; regjistri i kredive u përmirësua më tej. Nuk janë vënë re ndërprerje të gjata të energjisë elektrike gjatë vitit të kaluar. Në përgjithësi, është bërë progres i mirë drejt ngritjes së një ekonomie tregu funksionale. Megjithatë, pengesë kryesore mbeten paqartësitë në lidhje me të drejtat e pronësisë, ekzekutimi i dobët i kontratave dhe mangësitë e akumuluar në shtetin e së drejtës.

#### *Kapital njerëzor dhe fizik*

Qeveria vazhdoi strategjinë për të përmirësuar cilësinë e kapitalit njerëzor, të ashtuquajturën nismë *brain gain*. Në sektorin publik, personave që zotërojnë diploma master apo doktoraturë, iu ofrua një shumë parash shtesë mbi rrogë; ata me diploma të përfutuara jashtë shtetit përfitonin shumë më të lartë. 8 000 të rinj u trajnuan në shkollat e formimit profesional dhe u hapën vende të reja trajnimi profesional gjatë vitit 2008. Megjithatë, vlerësimi i ndikimit të masave që u morën për funksionimin e tregut të punës, cenohen nga mungesa e statistikave solide të punës.

Investimet kapitale fikse bruto ishin 39.1% të PBB; investimet e sektorit privat zënë një përqindje pak më të ulët, me 29.8% të PBB, në rënie krahasuar me 30.5% në vitin 2007. IHD neto u rritën me rreth 42%, duke kapur nivelin 7% të PBB kundrejt 5.9% që ishte në vitin 2009, me rritje të investimeve *greenfield*. Investimet publike u fokusuan në infrastrukturën rrugore. Termocentrali i Vlorës ende nuk është vënë në punë, ndërkohë që u miratuan një sërë marrëveshjes koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve. Në përgjithësi, ka pasur investime substanciale në infrastrukturë, sidomos në sektorin e transportit, megjithëse vazhdon të ketë mangësi.

### *Struktura e ndërmarrjeve dhe sektoriale*

Ndryshimet e përqindjeve që bujqësia, industria dhe shërbimet zënë në ekonomi, ishin të ngjashme me vitet e kaluara. Pothuaj gjysma e PBB-së së Shqipërisë gjenerohet nga sektori i shërbimeve. Bujqësia vazhdoi të ketë ulje si përqindje, por ende përbën 16.3% të PBB dhe mbeti punëdhënësi më i madh me 58% të popullsisë të aftë për punë. Sektori dytësor u fuqizua në kurriz të veprave të mëdha infrastrukturore. Sektori i gjerë informal stimulohet nga dobësia që shfaqin politikat për tatimet dhe shpenzimet, si dhe sundimi i ligjit, përfshi luftën kundër korrupsionit dhe krimin e organizuar. Reduktimi i përmasave të ekonomisë informale mbeti një sfidë e rëndësishme, dhe përpjekjet e qeverisë për të ulur nivelet e larta të informalitetit vazhduan me reduktimin e taksave për bizneset dhe kontributet shoqërore të punëdhënësve. Gjatë periudhës raportuese, furnizimi me energji ishte më i qëndrueshëm.

Megjithatë, Shqipëria vazhdon të jetë e varur kryesisht nga hidrocentralet dhe furnizimi me energji vazhdon të jetë i pasigurt. Sektori i energjisë vazhdoi të shfaqë nivele të larta humbesh joteknike dhe teknike. Tregu i energjisë u bë edhe më konkurrues pas privatizimit të ARMO-s. Janë dhënë mjaft koncesione për hidrocentrale të reja dhe për ndërtimin e fermave të erës. *Në përgjithësi*, ristrukturimi i sektorit të energjisë ka bërë progres. Megjithatë, furnizimi me energji mbetet i pasigurt.

### *Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri*

Subvencionet e drejtpërdrejta në formën e transfertave nga buxheti vazhduan të jenë të papërfillshme (0.2% e PBB në vitin 2008 dhe në vitin 2009). Në lidhje me subvencionet jo të drejtpërdrejta, tarifatat e energjisë ende nuk kanë kapur nivelin e rikuperimit të kostos dhe borxhi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të privatizuar, iu transferua korporatës shtetërore KESH. *Në përgjithësi*, ndërhyrjet e shtetit qëndruan brenda kufijve.

### *Integrimi evropian me BE-në*

Hapja e ekonomisë shqiptare vazhdoi të rritet. Shuma e importeve dhe eksporteve (që përkufizon hapjen) ishte mbi 82% e PBB në vitin 2008. Tregtia me jashtë u rrit me 16% krahasuar me vitin 2007. Si importet (+15.3%) ashtu edhe eksportet (+16.5%) e mallrave dhe të shërbimeve u rritën gjatë vitit 2008, pavarësisht se më pak se në vitin 2007. Italia dhe Greqia vazhdojnë të jenë partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë. *Në përgjithësi*, BE-ja vazhdoi të jetë partneri kryesor tregtar i Shqipërisë në vitin 2008 dhe tregtia me vendet CEFTA u rrit. Megjithatë, diversifikimi i dobët sektorial i tregtisë, e lë ekonominë të dobët ndaj tronditjeve në sektorë specifikë.

## **4. EUROPEAN STANDARDS**

Ky seksion analizon kapacitetet e Shqipërisë për të përafruar gradualisht legjislacionin dhe politikat e saj me *acquis* për sa i takon tregut të brendshëm, politikave sektoriale dhe drejtësi, lirisë dhe sigurisë, në linjë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe prioritetet e Partneritetit Evropian. Gjithashtu, këtu analizohen kapacitetet administrative të Shqipërisë. Në çdo sektor, vlerësimi i komisionit jep progresin e arritur gjatë periudhës raportuese dhe përmbledh nivelin e përgjithshëm të përgatitjeve të Shqipërisë.



## 4.1. Tregu i brendshëm

### 4.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Progresi ka vazhduar në fushën e **standardizimit**. Deri në fund të gushtit 2009, Shqipëria kishte miratuar 15,029 Standarde Evropiane (EN), që përfaqësojnë 88% të të gjitha EN të miratuara nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN) dhe Komiteti Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC). Kjo përmbush objektivin prej 90% të vendosur për vitin 2009. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) i siguroi informacione komunitetit të biznesit për Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Ligjin për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe Vlerësimin e Konformitetit dhe ka vazhduar të rrisë ndërgjegjësimin për përfitimet e standardizimit. Shitja e standardeve u rrit në vitin 2008 dhe vazhdoi të rritet edhe në gjysmën e parë të vitit 2009. DPS-ja vazhdoi të marrë pjesë në aktivitetet e CEN-it dhe CENELEC-it si anëtarë shok. Përgatitjet për përmbushjen e kushteve për anëtarësim të plotë në CEN dhe CENELEC po avancojnë. Megjithatë, ende nuk është krijuar bordi mbikëqyrës i parashikuar nga Ligji për Standardizimin (shkurt 2008) për monitorimin e punës së DPS-së.

Progres i pjesshëm është arritur në **vlerësimin e konformitetit**. Gjashtë trupa të reja vlerësimi konformiteti u akredituan deri në qershor 2009, duke e çuar në 16 numrin e trupave të akredituar. Megjithatë, ndryshimet e hartuara për përafrimin e mëtejshëm të Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe Vlerësimin e Konformitetit me *acquis* horizontale të re e korrikut 2008, ende nuk janë miratuar.

Progres i mirë është arritur në fushën e **akreditimit**. Vendimi për funksionimin e brendshëm të Drejtësisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) i miratuar në tetor 2008, krijon kushtet për përafrim të mëtejshëm të standardeve evropiane dhe vendos bazën ligjore për Bordin e Akreditimit. Megjithatë, Bordi ende nuk është krijuar. Në gusht 2009 u miratua aplikimi i DPA-së për një marrëveshje dypalëshe me Bashkëpunimin Evropian për Akreditim (EA) në fushën e laboratorëve të testimit, sipas kushteve të zbatueshme për nënshkruesit e marrëveshjeve shumëpalëshe EA.

Progres i mirë është arritur në fushën e **metrologjisë**. U miratuan rregullore të reja teknike në lidhje me kërkesat e instrumenteve matëse. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) hartoi një program për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe vazhdoi trajnimin e stafit. Në nëntor 2008, DGP-ja u bë anëtare e grupit të fokusit të Shoqatës Evropiane të Instituteve Kombëtare të Metrologjisë (EUROAMET) që merret me zhvillimin e infrastrukturave kombëtare. Në maj 2009, Shqipëria u bë anëtare shok e WELMEC, Organizatës për Bashkëpunim Evropian në Metrologjinë Ligjore. Dy laboratorë kalibrimi u akredituan sipas EN ISO/IEC 17025 nga trupa akredituese shqiptare. DPM-ja po punon me zbatimin e planit të investimeve për fushat e reja të matjeve, përfshi godinat dhe pajisjet, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Metrologjinë 2008-2012

Progres i pjesshëm është arritur në **mbikëqyrjen e tregut**. Qeveria mori disa masa për zbatimin e strategjisë për mbikëqyrjen e tregut për produktet industriale. Megjithatë, kërkohej përpjekje të mëtejshme për nxitjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes së tregut të Inspektoratit Qendror Teknik dhe për të zgjeruar fushën e funksioneve të tij. Kapacitetet administrative aktuale, ekzekutimi aktual i rregulloreve teknike dhe bashkëpunimi ndërmjet organeve të mbikëqyrjes së tregut, mbetet i dobët. Kërkohej përpjekje të mëtejshme për të rritur burimet njerëzore të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Progres i pjesshëm është arritur në harmonizimin e standardeve evropiane. Qeveria miratoi vendime për përafrimin ligjor të rregulloreve teknike që lidhen me makineritë, ashensorët, pajisjet dhe sistemet mbrojtëse në atmosfera potencialisht shpërthyesë. Progres i pjesshëm është arritur edhe në harmonizimin ligjor në sektorin farmaceutik.

Progres i mirë është bërë në **mbrojtjen e konsumatorit**. U miratuan akte zbatuese për shitjen në distancë, kontratat e negociuara larg ambienteve të biznesit dhe paketat e udhëtimeve. Kuadri rregullator u përmirësua dhe në prill 2009 u ngrit Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK), një organ vendimmarrës dhe ka filluar të trajtojë mosmarrëveshjet e para ndërmjet konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve. Pesë përfaqësuesit e KMK-së janë përfaqësues të qeverisë dhe të shoqërisë civile. Në korrik 2009 u trajnuan për çështje të praktikave të padrejta tregtare. Gjithashtu, u krijua Këshilli Bashkëndues për Mbrojtjen e Konsumatorit si organ këshillimor. Megjithatë, sektori i mbrojtjes së konsumatorit në METE ka mungesë stafi, me vetëm dy nëpunës civilë dhe kapacitetet e tij mbeten të dobëta.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave janë në rrugën e duhur. Shqipëria ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit me standardet evropiane. Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme nevojiten për harmonizimin e mëtejshëm të trupës së legjislacionit me standardet evropiane, si dhe për forcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin dhe sundimin e ligjit.

#### 4.1.2. *Lëvizja e personave, shërbimet dhe drejta e vendosjes*

Progres i pakët është bërë në **lëvizjen e personave**. Ligji për të Huajt hyri në fuqi në dhjetor 2008, por aktet nënligjore për zbatimin e tij ende nuk kanë dalë. Nuk është raportuar progres në *koordinimin e sigurisë shoqërore* dhe në përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe me shtetet anëtare të BE-së.

Progres i pakët është arritur në **ofrimin e shërbimeve**. Nuk kanë filluar përgatitjet për dallimin ndërmjet regjimeve të zbatueshme për ofrimin ndërkufitar të shërbimeve nga operatorët e BE-së në Shqipëri dhe për regjimin e zbatueshëm për ofruesit e shërbimeve me seli në Shqipëri. Nuk është raportuar progres në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale dhe për dallimin nga njohja e kualifikimeve akademike. Ligji për Komunikimet Elektronike dhe Shërbimet Postare u ndryshua në maj 2009 për të ndarë funksionet rregullatore nga ato politikëbërëse dhe nga aktivitetet që lidhen me ushtrimin e zotërimit në sektorin postar. Kompetencat rregullatore i ka Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Megjithatë, ende nuk është arritur liberalizimi i plotë i treguar postar.

Progres i pjesshëm është arritur në shërbimet financiare. Në shkurt dhe mars 2009, Banka e Shqipërisë (BSH) miratoi rregullore për licencimin dhe aktivitetet e institucioneve financiare jobankare, bankat e huaja dhe degët e bankave të huaja. BSH-ja rriti rolin mbikëqyrës me miratimin e rregulloreve për menaxhimin e riskut të kreditit, mjaftueshmërinë e kapitelit dhe rregullat ndaj ekspozimit të madh. Mbulimi i depozitave bankare nga fondi i garancisë së depozitave, u rrit si kundërpërgjigje ndaj krizës financiare. BSH-ja rriti rolin mbikëqyrës me miratimin e rregulloreve për menaxhimin e riskut të kreditit, mjaftueshmërinë e kapitelit dhe rregullat ndaj ekspozimit të madh. Mbulimi i depozitave bankare nga fondi i garancisë së depozitave, u rrit si kundërpërgjigje ndaj krizës financiare. BSH-ja rriti bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse të bankave të huaja që kanë degë apo filiale në Shqipëri. Megjithatë kërkohen përpjekje të mëtejshme për formalizimin e bashkëpunimit me autoritetet e huaja dhe për të vazhduar forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të BSH-së. Kërkohet ende përafrim i

mëtejshëm i legjislacionit bankar me standardet e BE-së, sidomos e Direktivës për Kërkesat e Kapitalit dhe me kuadrin e Bazel II.

Progres i pakët është arritur në shërbimet e sigurimit dhe fondet e pensioneve të punës. Skemat e sigurimit të detyrueshëm vazhdojnë të mbizotërojnë në treg. Në Shqipëri operojnë dy fonde pensionesh private.

Në janar 2009, qeveria miratoi akte nënligjore për aspektet teknike dhe matematikore të sipërmarrjeve të sigurimeve. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) miratoi, mes të tjerave, rregullore për regjistrimin e transaksioneve, për licencimin dhe mbikëqyrjen e shkëmbimeve të letra me vlerë dhe për licencimin e shoqërive ndërmjetësve dhe këshilltarët e investimeve. Ligji për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta u miratua në shkurt 2009. Megjithatë, dispozitat e tij për miratimin e tarifave nga AMF-ja nuk janë në linjë me standardet e BE-së. Kërkohen përpjekje të mëtejshme në përafrimin e legjislacionit.

AMF-ja u bë anëtare me të drejta të plota e Organizatës Ndërkombëtare të Komisionit të Letrave me Vlerë (IOSCO). Gjithashtu, me Autoritetin Austriak të Tregut Financiar u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për Mbikëqyrjen e Letrave me Vlerë. Kapacitetet mbikëqyrëse të AMF-së po forcohen me anë të ngritjes së platformës së raportimit elektronik për tregun e sigurimeve dhe të pensioneve. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme që AMF-ja të ketë kapacitetet e duhura për të përballuar rritjen e tregut. Sipas organigramës së miratuar, AMF-ja ka nevojë për staf shtesë. Ende nuk i janë vënë në dispozicion AMF-së mjediset me zyra të reja.

Progres i mirë është arritur në **të drejtën e vendosjes**. Reforma e regjistrimit dhe licencimit të shoqërive tregtare ka vazhduar. Legjislacioni i ri i miratuar në shkurt dhe maj 2009 dhe ngritja e Qendrës Kombëtare të Licencimit në qershor, reduktuan barrierat administrative dhe e bënë krijimin e shoqërive më të shpejtë, më të thjeshtë dhe më të lirë (*Shiko seksionin 4.2.1 për detaje*). Është mundur regjistrimi *online* i shoqërive, megjithëse vazhdon të ketë vështirësi teknike për sa i përket nënshkrimit elektronik. Pasiguritë në lidhje me të drejtat e pronës vazhdojnë të dekurajojnë vendosjen e bizneseve.

Progres është arritur në **të drejtën e shoqërive tregtare**. Janë përgatitur statute tip për shoqëritë tregtare dhe një manual me qëllim që të lehtësohet zbatimi i Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare (prill 2008). Në bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe industrisë, janë organizuar trajnime për gjyqtarët dhe komunitetin e biznesit në lidhje me zbatimin e këtij ligji. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme drejt përafrimit ligjor në lidhje me bashkimet e ndërmarrjeve ndërkufitare dhe ofertat publike për blerje të shoqërive tregtare.

Progres është arritur në kontabilitet dhe auditim. Ligji i ri për Ekspertët Kontabël dhe Audituesit u miratua në mars 2009. Ky ligj përcakton shoqëritë që duhet të auditojnë pasqyrat e tyre vjetore dhe kërkon që profesioni i ekspertit kontabël të jetë subjekt i një sistemi mbikëqyrës publik. Ligji përmban dispozita për certifikimin/miratimin e ekspertëve kontabël dhe regjistrimin e tyre dhe të kontabilistëve. Megjithatë, nuk janë miratuar akoma aktet zbatuese. Organi mbikëqyrës publik për profesionin e ekspertit kontabël ende nuk është ngritur. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përafëruar legjislacionin shqiptar me standardet e BE-së, veçanërisht për sa i përket dispozitave të Direktivave 4 dhe 7 për shoqëritë tregtare.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, po avancojnë ngadalë.

#### 4.1.3. *Lëvizja e lirë e kapitalit*

Progres i pjesshëm është arritur në **lëvizjen e lirë të kapitalit**. Rishikimi i Rregullores për Aktivitetin e Shkëmbimit Valutor miratuar nga Banka e Shqipërisë në shtator 2009, thjeshton procedurat e lëvizjes së kapitalit. Rregullorja e rishikuar rregullon liberalizimin e kredive dhe huave që personat fizikë dhe juridikë rezidentë u japin atyre jorezidentë. Megjithatë, ekzistojnë akoma disa kufizime në liberalizimin e kapitalit që kërkohet nga MSA-ja, veçanërisht për sa i takon blerjes së pasurive të paluajtshme nga të huajt.

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **sistemit të pagesave**. Numri i kartave kredit dhe debit në qarkullim vazhdoi të rritet gjatë vitit 2008. Përdorimi i kartave elektronike u rrit dhe janë bërë përpjekje për të lehtësuar përdorimin e kartave kredit dhe debit dhe pagesat elektronike. Megjithatë, rreth 96% e transaksioneve bankare me karta elektronike, janë tërheqje parash. Shqipëria mbetet një ekonomi ku mbizotëron *cash*.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit po avancojnë ngadalë.

#### 4.1.4. *Doganat dhe tatimet*

Është arritur progres i pjesshëm në fushën e **doganave**. Shqipëria vazhdoi masat për zbatimin në kohë të reduktimeve tarifore në kuadër të MSA-së. Nomenklatura e Kombinuar e vitit 2009 për klasifikimin e mallrave në tregtinë me BE-në, u aplikua që në janar 2009. Kompjuterizimi vazhdoi të avancojë. Kalimi në ASYCUDA World përfundoi në qershor 2009. Kriteret e vlerësimit të riskut dhe profilet po rishikohen vazhdimisht dhe janë përgatitur profile të reja, veçanërisht për skanerët. Përqindja e inspektimeve fizike u reduktua me rreth 20%, por është ende e lartë krahasuar me standardet e BE-së. Megjithatë, kërkohen zhvillime të mëtejshme për ta bërë sistemin e analizës së riskut më efikas dhe më të administrueshëm, si dhe për të rritur përdorimin e vlerës së transaksionit. Përdorimi i çmimeve të referencës nuk është në linjë me standardet e BE-së. Hartimi i Strategjisë për Biznesin dhe IT nuk është finalizuar.

Në gusht 2009 Shqipëria u bë anëtare e Konventës së Stambollit për Pranimin e Përkohshëm. Megjithatë, nuk është nënshkruar marrëveshja përkatëse me një Shoqatë Kombëtare Garante nuk janë zbatuar Procedurat ATA Carnet nuk është bërë. Numri i magazinave doganore të autorizuara shkoi në 40 në fund të gushtit 2009. Qeveria nxori vendimin për krijimin e një zone të lirë ekonomike në Vlorë. Tashmë po funksionojnë drejtoria antitrafik dhe një sektor për mbrojtjen e patentave dhe markave, nën Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD). Një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet DPD-së dhe Drejtorisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave, hyri në fuqi në korrik 2009. Megjithatë, mungesa e udhëzimeve dhe kontrolli i dobët i performancës, pengojnë zbatimin e duhur të legjislacionit doganor. Mungojnë kontrollet efikase për të drejtat e pronësisë intelektuale dhe përdorimi i mallrave me përdorim të dyfishtë në dogana mbetet i dobët.

Në lidhje me infrastrukturën, një pikë e përbashkët kalimi kufitar me Malin e Zi funksionon që në qershor 2009. Në janar 2009 ka filluar puna për rehabilitimin e infrastrukturës në 10 pika kalimi kufitar. Po përdoren skanerë të rinj për materiale radioaktive. Megjithatë, nuk raportohen zhvillime në lidhje përmirësimin e Doganës së Tiranës.

Stafi i administratës doganore përfitoi trajnim për rregullat e origjinës dhe përdorimin e skanerëve. Megjithatë, nuk ekziston një strategji trajnimi gjithëpërfshirëse. DPD-ja operon mbi

bazën e planit të trajnimit të vitit 2009. Kërkohen përpjekje për të rritur transparencën për punën dhe procedurat e personelit. Nëpunësit doganorë ende nuk gëzojnë status nëpunësi civil.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e doganave po avancojnë, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për përafrimin me praktikat dhe standardet e BE-së dhe për forcimin e kapaciteteve operationale dhe administrative, përfshi auditimin e brendshëm.

Progres i pjesshëm është arritur në tatime. Mbledhja e taksave u rrit në vitin 2008 dhe ky trend vazhdoi edhe në gjysmën e parë të vitit 2009. Megjithatë, përqindja e mbledhjes është ende e ulët, veçanërisht në nivelin e pushtetit vendor.

Reforma në **administratën tatimore** e përmirësoi performancën, veçanërisht në nivel qendror. Struktura e re e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) bazohet në funksione administruese, në vend që të bazohej posaçërisht në mbledhjen dhe kontrollin e taksave. Stafi i DPT-së përfitoi trajnime mbi legjislacionin tatimor dhe procedurat, përfshi edhe trajnim të trajnerëve në lidhje me shërbimet për tatimpaguesit. U finalizua një manual për auditimin e brendshëm, si dhe u përfundua një udhëzues për tatimpaguesit, Karta e Tatimpaguesit. DPT-ja miratoi plane strategjike për inspektimin dhe mbledhjen e taksave, me synimin që të rrisë luftën kundër evazionit tatimor dhe mashtrimit. Megjithatë, kërkohen përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor dhe forcim të kapaciteteve operationale, me qëllim që të zvogëlohen përmasat e mëdha të ekonomisë informale.

Legjislacioni për akcizat dhe TVSH-në u ndryshua, dhe rimbursimi i TVSH-së është përshpejtuar, kryesisht për kompanitë e orientuara nga eksporti. Megjithatë, tatimi në import i makinave të përdorura dhe regjimi TVSH që aplikohet në import për materialet e shtypura, nuk janë në linjë me MSA-në. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për ta sjellë sistemin e taksave dhe akcizës më afër standardeve të BE-së, dhe për të arritur përmirësime në rimbursimin e TVSH-së. Nuk raportohen zhvillime në vlerësimin e përputhshmërisë së legjislacionit tatimor shqiptar me Kodin e Sjelljes në Tatimin e Biznesit. Është e rëndësishme të shtohen konsultimet me komunitetin e biznesit dhe me organizatat e shoqërisë civile, për të shmangur paqartësitë që rrjedhin nga ndryshimet e shpejta të kuadrit legjislativ.

Kompjuterizimi i degëve tatimore vazhdoi të avancojë dhe mbeten vetëm 4 zyra që të përfshihen në sistemin e integruar. Është hartuar një strategji për biznesin dhe IT, sektori IT është ristrukturuar dhe është zhvilluar një modul i analizës së riskut. Zbatimi i procedurave tatimore elektronike u shtri më tej dhe numri i tatimpaguesve që paguajnë taksat *online* është rritur. Megjithatë, kapacitetet e kufizuara teknike të bankave tregtare bëjnë që të pengohet zhvillimi i pagimit elektronik të taksave.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e tatimeve po avancojnë. Performanca e administratës tatimore po përmirësohet. Megjithatë, kërkohen përpjekje për të rritur zbatimin e ligjit, për të përmirësuar mbledhjen e taksave dhe për ta sjellë tatimin në import të makinave të përdorura dhe të materialeve të shtypura në linjë me MSA-në.

#### 4.1.5 Konkurrenca

Progres i mirë është arritur në fushën e **antitrusteve**. Sistemi i dëgjësive publike në procedimet antitrust është përmirësuar, dhe është krijuar një njësi për gjobat. Hetime dhe dëgjesa publike janë mbajtur për marrëveshjet që cenojnë konkurrencën në fushën e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, si edhe në tregjet e karburanteve dhe sigurimeve. Autoriteti i Konkurrencës (AK) vazhdoi analizimin e rasteve të bashkimeve dhe blerjeve të ndërmarrjeve. Autoriteti realizoi

një hetim në sektorin energjetik dhe atë bankar dhe në nëntor 2008 nxori rekomandimet për tregun energjetik. AK-ja paraqiti një apelim në Gjykatën e Lartë për shkak të përplasjes mes vendimeve të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë në lidhje me gjobat ndaj dy shoqërive celulare për abuzim me pozitat dominuese.

Stafi i Autoritetit të Konkurrencës është trajnuar rreth tregjeve ekonomike, sektorit energjetik, kufizimet vertikale dhe legjislacionin për shoqëritë tregtare. AK-ja është treguar aktive në mbrojtjen e konkurrencës, në bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe industrisë. Shtatë ankime janë regjistruar në 4 muajt e parë të 2009 në fushën e telekomunikacioneve, farmaceutike dhe të prokurimit.

Ligji për Konkurrencën po rishikohet për ta përafuar më shumë me standardet e BE-së. AK-ja po harton kuadrin rregullator për çështjet që lidhen me gjobat dhe lehtësimin prej tyre, marrëveshje *de minimis*, marrëveshje horizontale dhe vertikale dhe bashkimet, si edhe për procedurat e brendshme të hetimit. Megjithatë, nuk është miratuar legjislacioni i ri.

Progres të mëtjshëm ka pasur në përmbushjen e detyrimeve të MSA-së për **ndihmën shtetërore**. Legjislacioni për ndihmën shtetërore u ndryshua në qershor 2009, duke futur rregulla të reja për kapitalin e riskut dhe mbrojtjen e mjedisit. Departamenti i Ndhmës Shtetërore dhe Komisioni i Ndhmës Shtetërore vazhduan rishikimin dhe vlerësimin e skemave të reja dhe ekzistuese. Kjo rezultoi në harmonizimin e legjislacionit në lidhje me koncesionet turistike, zonat e lira dhe ndihmën për punësim. Procesi i rishikimit të skemave ekzistuese të ndihmës dhe përputhshmërinë e tyre me legjislacionin për ndihmën shtetërore, po i afrohet përfundimit. Në qershor 2009, qeveria miratoi raportin e ndihmës shtetërore për vitin 2008. Është përgatitur një hartë rajonale e ndihmës shtetërore. Shqipëria konfirmoi angazhimin që nuk do të japë ndihmë shtetërore për ristrukturimin e industrisë së hekurit dhe çelikut. Departamenti i Ndhmës Shtetërore është trajnuar për çështje të ndihmës shtetërore.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e konkurrencës kanë përparuar. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtjshme që të forcohen kapacitetet institucionale për zbatimin në praktikë të rregullave të konkurrencës.

#### 4.1.6. *Prokurimi publik*

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e prokurimit publik. Legjislacioni i miratuar në janar detyron autoritetet kontraktuese që të përdorin prokurim elektronik. Gjithashtu, autoritetet kontraktuese duhet të publikojnë të gjitha njoftimet e prokurimeve dhe dosjet e tenderëve në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Kjo ka përmirësuar aksesin në informacion dhe ka reduktuar problemet e hasura. Megjithatë, ka ende disa përjashtime në përdorimin e procedurave elektronike. Duhet të vazhdohen përpjekjet për t'i shtrirë në të gjitha llojet e prokurimeve publike. Procedurat elektronike synojnë të reduktojnë hapësirat për korrupsion, megjithatë përpjekje të mëtjshme nevojiten në të gjitha fazat e procesit të prokurimit.

Kuadri ligjor nuk ka ndryshuar shumë. Kërkohet përafrim i mëtjshëm me *acquis*, në lidhje me shërbimet utilitare dhe koncesionet. Procedurat për trajtimin e ankesave nuk plotësojnë standardet e njohura ndërkombëtare. Një organ i pavarur për ankesave nuk është krijuar akoma. Vendimet për ankesat vazhdojnë të jepen nga APP-ja, e cila është përgjegjëse për interpretim të ligjit dhe dhënie këshillash për autoritetet kontraktuese.

Kapacitetet e APP-së u forcuan nëpërmjet trajnimeve, përfshi pjesëmarrjen në seminare të organizuara nga organizata ndërkombëtare. Megjithatë, duhet të forcohet roli i APP-së si organ qendror koordinues dhe këshillues. APP-ja organizoi aktivitete trajnimi dhe informimi për autoritetet kontraktuese dhe komunitetin e biznesit, në lidhje me legjislacionin dhe procedurat e prokurimit publik. Megjithatë, duhet t'u jepet më tepër orientim autoriteteve kontraktuese dhe ofruese. Duhet përpjekje për të përmirësuar njohuritë e gjyqtarëve për legjislacionin e prokurimit publik dhe zbatimin e tij.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e prokurimit publik janë duke përparuar me ritëm mesatar. Kërkohej përafrim i mëtejshëm legjislativ dhe është e nevojshme që zbatimi i ligjit të përforcohet.

#### 4.1.7. *E drejta e pronësisë intelektuale*

Ka pasur progres të pjesshëm në **të drejtat e pronës intelektuale**. Parlamenti miratoi në dhjetor 2008 Ligjin për Aderimin në Konventën Evropiane të Bashkëprodhimeve Kinematografike. Megjithatë, Ligji mbi të Drejtën e Autorit i vitit 2005, nuk është akoma në përputhje me standardet evropiane dhe projekt-strategjia kombëtare për pronën intelektuale dhe industriale ende nuk është miratuar.

Numri i inspektorëve të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZDA) u rrit nga 1 në 3. Është duke u përgatitur hapja e dy zyrave të para rajonale për të drejtën e autorit. Trajnimi i personelit të ZDA-së u organizua në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Pronës Intelektuale (WIPO). Megjithatë, kapacitetet e ZDA-së mbeten të dobëta. Rrjeti i planifikuar i 11 zyrave rajonale të pronës intelektuale nuk është krijuar.

Zyra e së Drejtës së Autorit vazhdoi të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe nënshkruan memorandum të ri bashkëpunimi në prill 2009. Megjithatë, respektimi i memorandumeve të bashkëpunimit mes ZDA-së dhe institucioneve të tjera, është në përgjithësi i dobët dhe pengon zbatimin praktik të të drejtave të pronës intelektuale. Numri i ankesave të regjistruara për shkelje të së drejtës së autorit u rrit nga 45 gjatë vitit 2008 në 100 gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, por pak çështje përfundojnë në gjykatë dhe niveli i gjobave mbetet i ulët. Numri i shoqërive të administrimit kolektiv u rrit nga 2 në 4 sepse filluan aktivitetin AKDIE, e cila mbron të drejtat e artistëve dhe interpretuesve dhe AMI, e cila mbron të drejtat e prodhuesve të fonogrameve dhe videove. Megjithatë, kapaciteti i përgjithshëm administrativ dhe operues i këtyre shoqërive mbetet i dobët. Gjyqtarët u trajnuan mbi të drejtat e pronës intelektuale, por kërkohej akoma përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar kualifikimet dhe përvojën e gjykatave në këtë fushë. Ndërgjegjësimi i përgjithshëm mbi mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale dhe dobinë e tyre mbetet i ulët.

Ka pasur përparim në fushën e **të drejtave të pronës industriale**. Në dhjetor 2008, qeveria miratoi akte nënligjore për regjistrimin e markave tregtare, regjistrimin e patentave për shpikjet dhe modelet utilitare dhe regjistrimin e treguesve gjeografikë. Procedurat e regjistrimit elektronik kanë filluar të funksionojnë. Puna për ratifikimin e Konventës Evropiane mbi Patentat dhe Traktatit të së Drejtës së Patentave (PLT-WIPO) ka përparuar shumë. Megjithatë, parlamenti ende nuk ka miratuar vendimet e ratifikimit.

Drejtorja e Patentave dhe Markave Tregtare (DPMT) organizoi trajnime të personelit të saj në bashkëpunim me WIPO dhe Zyrën Evropiane të Patentave. DPMT-ja organizoi aktivitete ndërgjegjësimi në bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe forcoi bashkëpunimin me Drejtorinë e

Përgjithshme të Doganave. Megjithatë, personeli i saj nuk është rritur. Shtrëngimi i të drejtave të pronës industriale mbetet i dobët. Numri i çështjeve që kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave të pronës industriale që dërgohen në gjykatë u rrit lehtë, por mbetet akoma i ulët.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e të drejtës së pronës industriale kanë pasur përparim mesatar, si në lidhje me legjislacionin ashtu edhe zbatimin e tij. Kapacitetet e ZMA-së dhe të DPMT-së mbeten të dobëta. Zbatimi vazhdon të pengohet nga kapaciteti i pamjaftueshëm i inspektimit, niveli i ulët i gjobave dhe mungesa e përvojës dhe kualifikimeve të përshtatshme në sistemin gjyqësor. Kërkohen përpjekje të mëtejshme të konsiderueshme për të përmbushur detyrimet e MSA-së për të drejtat e pronës intelektuale dhe industriale. Rëndësi vendimtare në këtë drejtim do të ketë bashkëpunimi ndërinstitucional.

#### 4.1.8 *Politikat sociale, politika e punësimit dhe shëndetit publik*

Progres i pakët është arritur në fushën e **politikave sociale**. Në shkurt 2009, u krijua një grup pune për rishikimin e *legjislacionit të punës* në fuqi, i përbërë nga përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile, përfshi sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve. Megjithatë, hartimi i projektligjit nuk ka përfunduar akoma.

Progres është shënuar në fushën e *shëndetit dhe sigurisë në punë*. Në maj 2009, qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Shëndetin dhe Sigurinë Profesionale 2009-2013 dhe planin e tij të veprimit. Njësia e Shëndetit dhe Sigurisë Profesionale e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB) u përmirësua dhe iu besua zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit. Drejtoria e auditimit të brendshëm u krijua brenda Inspektoratit Shtetëror të Punës (ISHP) në prill 2009. Megjithatë, projektligji për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë nuk është miratuar akoma. Respektimi i masave për shëndetin dhe sigurinë në punë mbetet i dobët dhe numri i aksidenteve në punë është i lartë, veçanërisht në sektorët e ndërtimit, minierave dhe përpunimi i mineraleve. Sektori bujqësor nuk mbulohet nga sistemi i inspektimit të punës. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të rritur kapacitetet njerëzore, fizike dhe financiare të ISHP-së dhe për të përmirësuar transparencën e punës së personelit. Për më tepër, shumë pak progres mund të raportohet në adresimin e mangësive që ekzistojnë me standardet e shëndetit dhe sigurisë, të cilat u shfaqën pas shpërthimit në depot e municioneve të Gërdecit në vitin 2008. (*Shiko edhe seksionin 2.1*).

*Dialogu social* është akoma në fazë zhvillimi. Marrëveshje kolektive pune u nënshkruan në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. Megjithatë, negociimi kolektiv efektiv mbetet i vështirë dhe kontratat individuale mbizotërojnë ndaj marrëveshjeve kolektive. Mungesa e shoqatave të punëdhënësve e kufizon negociimin kolektiv në nivel ndërmarrjesh në sektorin privat. Përfshirja e sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve në procesin e vendimmarrjes mbetet e dobët. (*Shiko edhe seksionin 2.2*).

Zbatimi i mbrojtjes sociale dhe strategjisë së *përfshirjes sociale* për periudhën 2008-2013 është duke vazhduar dhe po përgatitet plani i monitorimit të strategjisë. Studimi i fundit për standardet e jetesës tregoi se popullata nën nivelin absolut të varfërisë u ul nga 18.5% në 2005 në 12.4% në vitin 2008. Qeveria ka zhvilluar mekanizma për të monitoruar varfërinë dhe përfshirjen sociale në nivel kombëtar, por ende nuk është përgatitur raporti i parë vjetor 2008-2009 (*Për anti-diskriminimin shiko seksionin 2.2*).

Progres të pjesshëm ka pasur në fushën e *mbrojtjes sociale*. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është duke modernizuar arkivin dhe ka filluar të kryejë regjistrimin elektronik të të dhënave. Është duke vazhduar puna për krijimin e një baze kombëtare të dhënash elektronike të sigurimeve



shoqërore, e cila do të përmbajë llogari individuale të kontributeve, përlllogaritjen e përfitimeve dhe administrimin e pagesave. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka ngritur edhe një bazë të dhënash për të vetëpunësuarit në sektorin bujqësor. Buxheti i akorduar për mbrojtjen sociale në vitin 2009 u rrit dhe arriti në 7.7% të PBB. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të siguruar qëndrueshmërinë e politikave të mbrojtjes sociale, duke përfshirë reformën e pensioneve, e cila është duke u hartuar tani.

Progres të pjesshëm ka pasur në **politikën e punësimit**. Papunësia u ul, megjithëse papunësia prej 12.7% në tremujorin e parë të vitit 2009 mbetet akoma e lartë. Sistemi i ri i kompjuterizuar i informacionit filloi të përdoret në zyrën qendrore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në dy zyra rajonale. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme që ky sistem të shtrihet në të gjithë territorin dhe të forcohen në tërësi kapacitetet e shërbimit të punësimit. Mungon ende monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të skemave ekzistuese të nxitjes së punësimit. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar të dhënat mbi tregun e punës (*Shiko seksionet 3.1, 3.2, dhe 4.1.9 për detaje të mëtejshme mbi programet e arsimit dhe formimit profesional*).

Progres i pjesshëm është arritur në **politikën e shëndetit publik**. Parlamenti miratoi Ligjin mbi Kujdesin Shëndetësor Publik në maj 2009. Megjithatë, aktet zbatuese përkatëse ende nuk janë miratuar dhe Strategjia Kombëtare e Sektorit Shëndetësor nuk është miratuar. Është miratuar legjislacioni i ri që përafron standardet në fushën e transfuzionit të gjakut me standardet e BE-së. Shqipëria ratifikoi Kuadrin e OBSH-së për Kontrollin e Duhanit. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të zhvilluar legjislacionin për produktet e duhanit dhe reklamimin e tyre, dhe për të garantuar ndalimin e duhanpirjes në vende publike. Në fushën e sëmundjeve ngjitëse, qeveria mori masat për të përballuar pandeminë A(H1N1). Qendra e parë e rehabilitimit nga alkooli u hap në QSUT.

Progres i kufizuar është arritur në fushën e shëndetit mendor, por kërkohet shumë më tepër. Qendra të reja për të sëmurat mendorë u hapën në Elbasan dhe Shkodër dhe një spital i ri i psikiatrisë ligjore u përfundua në Durrës. Megjithatë, kërkohen akoma mjedise psikiatrike të përshtatshme për të sëmurët mendorë. Zbatimi i legjislacionit dhe politikave ekzistuese mbi shëndetin mendor është i dobët. Buxheti për shëndetin mendor mbetet i ulët dhe burimet në dispozicion të spitaleve të shëndetit mendor janë përgjithësisht të varfra. Statusi ligjor dhe ri-integrimi i pacientëve psikiatrikë kërkon vëmendje. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të zhvilluar shërbime bazuar në komunitet si një alternativë ndaj kujdesit në institucione dhe për t'iu përgjigjur nevojave të veçanta të fëmijëve dhe adoleshentëve me probleme të shëndetit mendor.

Kapacitetet administrative në fushën e shëndetit mendor mbetet i dobët. Kërkohen përpjekje të qenësishme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe për të garantuar në përgjithësi aksesin në kujdes shëndetësor. Grumbullimi i të dhënave dhe mekanizmat që monitorojnë performancën, duhet të forcohen. Shërbimet me bazë komunitetin duhet të zhvillohen më tej.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e politikave sociale, punësimit dhe politikës së shëndetit publik janë duke përparuar me ritëm mesatar. Kërkohen përpjekje për të nxitur kohezionin social.

#### 4.1.9 *Arsimi dhe kërkimi shkencor*

Progres është arritur në fushën e **arsimit**. Buxheti i arsimit për vitin 2009 u rrit, megjithëse ai mbeti në nivelin e vitit 2008 si përqindje e PBB. Mësuesit ishin grupi që përfitoi më shumë nga rritja mesatare me 14% e pagave të sektorit publik që nga në maji 2009. Kompetencat e organeve vendore në planifikimin e arsimit dhe akordimin e fondeve janë rritur. Infrastruktura shkollore u përmirësua, sepse janë rinovuar disa shkolla dhe laboratorë mësimorë. Kanë filluar përgatitjet për

ndërtimin e katër qendrave të reja AFP dhe po rehabilitohen katër qendrave të tjera AFP. Kompjuterizimi i shkollave po avancon, por duhet të përcaktohet financimi afatgjatë për lidhjen me internet.

Zgjatja e arsimit të detyruar në nëntë vjet filloi të zbatohet në vitin akademik 2008-2009. Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Shkollimin Para-universitar 2009-2013. Gjithashtu, miratoi legjislacionin për zbatimin e reformës në lidhje me provimin përfundimtar të maturës (Matura shtetërore) dhe provimin e pranimit në universitete, si dhe njohjen e diplomave të shkollës së mesme. Zbatimi i Ligjit për Arsimin e Lartë ka përparuar dhe organet drejtuese të universiteteve janë zgjedhur në përputhje me dispozitat e tij. Agjencia e Arsimit të Lartë (AAL) kreu vlerësimin e performancës së universiteteve për shpërndarjen e buxhetit shtetëror. Shqipëria ka bërë progres në reformimin e sistemit të arsimit të lartë në përputhje me linjat e Bolonjës, sidomos përsa i përket sistemit të niveleve dhe pjesëmarrjes së studentëve në sigurinë e cilësisë. Universiteteve iu dha më shumë fleksibilitet në administrimin e buxhetit të tyre. Megjithatë, kërkohet zhvillimi i mëtejshëm i kualifikimeve dhe aftësive profesionale të mësuesve. Kërkohen përpjekje të mëtejshme në autonominë institucionale dhe mirëqeverisjen e institucioneve të arsimit të lartë, pjesëmarrjen ndërkombëtare në sigurinë e cilësisë dhe njohjen e arsimit të mëparshëm.

Është përgatitur programi i ri mësimor i AFP-së për specialitetet e shërbimeve sociale dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Në vitin akademik 2009-2010 pritet të fillojë struktura e re e arsimit dhe formimit profesional e lidhur drejtpërdrejt me Projekt-kuadrin Shqiptar të Kualifikimeve (KSHK). Megjithatë, Ligji për KSHK-në nuk është miratuar akoma. Sinkronizimi mes AFP-së dhe tregut të punës mbetet e dobët. Duhet të forcohet vlerësimi dhe monitorimi i ndikimit të programeve të formimit profesional.

Zyra Kombëtare Tempus (ZKT) organizoi aktivitete informuese dhe ndihmoi në përmirësimin e cilësisë së projekteve të paraqitura nga universitetet shqiptare për pjesëmarrje në programet Tempus. Ajo shqyrtoi dhe monitoroi 7 projekte.

Memorandumi i Mirëkuptimit për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programin Evropa për Qytetarët hyri në fuqi në prill 2009.

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e kërkimit shkencor. U miratua Strategjia Kombëtare për Shkencën dhe Novacionin 2009-2015 dhe u krijua Agjencia për Kërkime Shkencore, Teknologji dhe Novacion. Buxheti i dhënë për kërkime shkencore u rrit, por pjesa e tij në buxhetin e përgjithshëm (0.22%) mbetet akoma shumë e vogël. Ka pasur përmirësime në treguesit dhe kriteret e financimit të programeve kombëtare të kërkimit shkencor dhe po ashtu, në lëvizshmërinë e kërkuesve shkencorë. Qeveria akordoi një fond ekselence në vitin 2008 për të stimuluar studimet kërkimore të studentëve kandidatë për gradën doktorë shkencash. Në mars 2009, 61 shqiptarë që studionin dhe/ose punonin jashtë Shqipërisë u punësuan në universitete në kuadrin e Programit *Brain Gain*. Si një vend i asociuar në Programin Kuadër të Kërkimeve Shkencore të 7-të të Komisionit Evropian, Shqipëria e rriti pjesëmarrjen e saj dhe ishte e suksesshme, mes të tjerash, në projektet kërkimore me partnerët evropianë në fushat e transportit, infrastrukturës, shëndetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Megjithatë, kapacitetet administrative dhe kërkimore mbeten të dobëta. Përcaktimi i paqartë i përgjegjësive dhe i akordimit të fondeve pengon zbatimin e Ligjit për Kërkimin Shkencor, i cili e bashkoi shumicën e institucioneve shkencore me universitetet.

#### 4.1.6. Çështjet e OBT

Shqipëria vazhdoi zbatimimin e detyrimeve të saj si pjesë e OBT-së. Shqipëria përfundoi vlerësimin e nevojave si pjesë e negociatave të lehtësimit të tregtisë së OBT-së dhe bashkëpunon ngushtë me Komunitetin Evropian në lidhje me këtë, duke përfshirë edhe sponsorizimin e përbashkët të propozimeve të Komisionit Evropian. Sekretariati për çështjet e OBT-së vazhdoi aktivitetet e tij për të përforcuar bashkëpunimin ndërministror në politikëbërje.

## 4.2. Politikat sektoriale

### 4.2.1. Industria dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

Progres i mirë është arritur **në fushën e industrisë dhe SME-ve**. Shqipëria ka përmirësuar zbatimimin e përgjithshëm të Kartës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla, sidomos në lidhje me regjistrimin e shoqërive tregtare, reformën rregullatore, aksesin në financa dhe nxitjen e eksporteve. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për zhvillimin e kapitalit njerëzor, konkurrueshmërinë dhe kapacitetet teknologjike të SME-ve.

Qendra Kombëtare për Regjistrimin e Bizneseve (QKR) i forcoi kapacitetet e saj dhe e zgjeroi shtrirjen e rrejtit të sporteleve. Deri në fund të muajit gusht 2009, në të gjithë Shqipërinë kishte 31 sportele regjistrimi të biznesit. Personeli i këtyre sporteleve të shërbimit u trajnuar në procedurat e regjistrimit dhe mbi çështjet e administratës publike. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në QKR në vitin 2008 arriti në 17 773 ose 29% më shumë se në vitin 2007.

Qeveria vazhdoi thjeshtimin e procedurave të licencimit. U zgjerua zbatimi i vetëdeklarimit dhe i parimit "heshtja nënkupton pranim". Ligji për Licencat, Autorizimet dhe Lejet u miratua në shkurt 2009. Ai parashikon ndarjen e re të licencave në 12 fusha të gjera dhe 49 kategori. Qendra Kombëtare e Licencimit, e ngritur si *one-stop-shop*, filloi punën në qershor 2009. Janë shfuqizuar 104 nga 170 licencat e mëparshme. Reforma tatimore vazhdoi t'iu japë incentiva sipërmarrësve. Ligji për Sigurimet Shoqërore i ndryshuar, i cili hyri në fuqi në maj 2009 e uli kontributin e sigurimeve shoqërore të punëdhënësit nga 20% në 15%. Megjithatë, skema e rrogave referencë dhe numri referencë i punonjësve për çdo kategori biznesi vazhdoi të përdoret për qëllime taksimi për shkak të përmasave të mëdha të ekonomisë informale.

Ligji për SME-të u ndryshua në dhjetor 2008, duke e sjellë përkufizimin e SME-ve më afër me standardet evropiane. Përdorimi i procedurave elektronike për tatimet dhe prokurimin publik, vazhdoi të ketë përparim. Ligji për Tregtinë Elektronike hyri në fuqi në qershor 2009. Megjithatë, nuk ka pasur përparim në zbatimimin e Ligjit për Falimentin, dhe procedurat administrative kanë penguar zbatimimin e Ligjit për Amnistinë Tatimore të miratuar në shtator 2008. Projektligjet për gjykatat administrative dhe ofertat publike për blerjen e shoqërive tregtare presin akoma të miratohen. Kërkohen përpjekje për të përfshirë më tej komunitetin e biznesit në proceset legislative dhe politikëbërëse.

Një garanci kreditimi prej 30 milion euro u vu në dispozicion në janar 2009 për të lehtësuar aksesin e SME-ve në kreditimin bankar. Nga fundi i vitit 2008, qeveria miratoi

krijimin e 7 parqeve industriale, por janë nënshkruar kontrata koncesionare vetëm për 3 parqe.

Përgatitjet në fushën e industrisë dhe SME-ve janë duke përparuar. Shqipëria ka vazhduar të përmirësojë kuadrin rregullator për biznesin. Megjithatë, kapacitetet teknologjike dhe novacioni mbeten të dobëta.

#### 4.2.2. *Bujqësia dhe peshkimi*

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **bujqësisë dhe zhvillimit rural**. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural u krijua si agjenci pagesash që të administrojë mbështetjen e drejtpërdrejtë për zonat rurale. Agjencia ka 86 punonjës dhe funksionon në të 12 qarqet e vendit. Kjo është pikënisje e mirë drejt ngritjes së Agjencisë IPARD. Përgatitjet për IPARD-in avancuan me krijimin e Autoritetit Administrues në qershor 2009. Megjithatë, Strategjia e Zhvillimit Rural kërkon përmirësime substanciale që të shërbejë si bazë për programin IPARD.

Buxheti i vitit 2009 për skemat e mbështetjes së drejtpërdrejtë qëndron i palëvizur në 7 milion euro. Mbështetja e drejtpërdrejtë për fermerët rezultoi në shtimin e plantacioneve apo kulturave të përhershme si frutat, ullinjtë, agrumet dhe vreshtat. Mbështetja e drejtpërdrejtë mbuloi mes të tjerave edhe ujitjen me pika, biocertifikimin, kulturën e kërpudhave dhe rritjen e kërmijve. Janë bërë përpjekje për të përmirësuar cilësinë dhe marketingun. Industria e baxhove po modernizohet dhe po konsolidohet, përfshi disa nisma për të përmirësuar kapacitetet përpunuese. Qendrat e informacionit bujqësor përfituan bazë materiale shtesë dhe organizuan aktivitete promovuese.

Megjithatë, fragmentimi i tokës vazhdon të pengojë bujqësinë efiçente dhe rezulton në nivele të ulëta prodhimi dhe të ardhurash. Pasiguria e të drejtave të pronësisë pengon zhvillimin e një tregu toke funksional. Dobësitë strukturore si infrastruktura e dobët dhe marketingu i dobët, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet prodhuesve dhe biznesit, njohuritë e pamjaftueshme për cilësinë e ushqimit dhe standardet e sigurisë, pengojnë zhvillimin e sektorit bujqësor. Buxheti total që i akordohet bujqësisë, vazhdon të jetë i ulët. Deficiti tregtar i produkteve bujqësore vazhdoi të rritet.

Në përgjithësi, sektori bujqësor mbetet i dobët. I mungon konkurrueshmëria dhe ka vështirësi në përballimin e konkurrencës nga mallrat e importuara.

Progres i kufizuar është arritur në fushën e **sigurisë ushqimore dhe politikën veterinare dhe fitosanitare**. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është krijuar, por ende nuk ka filluar punë për shkak të problemeve të plotësimit me personel. Në sektorin e ushqimeve, janë miratuar akte nënligjore kryesisht në lidhje me kërkesat në importim të produkteve shtazore (certifikatat), aromatizuesit dhe ushqimi për përdorime të veçanta ushqyese. Progres i pjesshëm raportohet në kapacitetet laboratorike, sidomos për hestaminën dhe mbetjet. Megjithatë, kufijtë ligjorë për ngarkesën mikrobiologjike të qumështit të papërpunuar, janë ende shumë më pak shtrënguese se në BE.

Shumë pak legjislacion është miratuar në sektorin veterinar. Identifikimi i gjedhit nuk është përfunduar dhe mangësitë në regjistrimin e lëvizjeve të tyre, vënë në rrezik përdorimin e bazës aktuale të të dhënave. Regjistrimi aktual i bagëtive të imëta nuk përdoret për qëllime epidemiologjike. Nuk është raportuar progres në sektorin e shëndetit të kafshëve. Kuadri ligjor mbeti përgjithësisht i pandryshuar në sektorin fitosanitar. Vetëm disa akte ligjore u miratuan, kryesisht në fushën e produkteve të mbrojtjes bimore. Në përgjithësi, është arritur progres i

pakët në fushën e sigurisë ushqimore dhe politikën veterinarë dhe fitosanitare. Kuadri ligjor është përmirësuar, por përpunthja me standardet e BE-së mbetet e pakët.

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **peshkimit**. Qeveria miratoi akte nënligjore për mjetet e peshkimit dhe për përcaktimin e syzave të rrjetave. Bashkëpunimi ndërinstitucional u përmirësua me nënshkrimin në nëntor 2008 të marrëveshjes ndërmjet Drejtorisë së Politikave të Peshkimit dhe Komandës së Rojës Bregdetare. Kapacitetet e Inspektoratit të Peshkimit u rritën me rekrutimin e dy inspektorëve dhe me sigurimin e pajisjeve që masin syzat e rrjetave. Stafi i Inspektoratit mori trajnim të mëtejshëm. Masa mbrojtëse u morën në liqenet e Ohrit dhe Shkodrës gjatë periudhës së riprodhimit të specieve të troftës së Ohrit.

Shqipëria vazhdoi të marrë pjesë në Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) dhe në Komisionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Tonit (ICCAT). Shqipëria i dorëzoi Sekretariatit GFMC listën e anijeve të autorizuara që mund të operojnë në zonën GFMC. Qeveria miratoi legjislacion për regjistrat dhe me to u pajisën anijen mbi 10 metër gjatësi. Dy anije peshkimi të tonit u pajisën me sistem monitorimi VMS. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për krijimin e një sistemi që mbledh dhe përpunon të dhënat për kuotat e kapjes dhe të zbarkimit, si dhe për shtrirjen më të gjerë të sistemit VMS

*Në përgjithësi*, është arritur progres në fushën e peshkimit për sa i përket inspektimit, kontrollit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Përgatitjet po avancojnë me ritëm mesatar.

#### 4.2.3. *Mjedisi*

Progres i kufizuar është arritur në fushën e **legjislacionit horizontal**. Në janar 2009, Shqipëria miratoi legjislacion për ratifikimin e Protokollit për Kontrollin e Shkarkimeve të Oksideve të Azotit apo Fluksëve të tyre Tejkufitare e Konventës së Gjenezës për Ndotjen Tejkufitare të Ajrit 1979. Dy dëgjesa publike u mbajtën për projektin e ndërtimit të termocentralit në Durrës. Njoftimi për dëgjësata publike u publikua në faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në faqen zyrtare të Qendrës Aarhus dhe në gazetata vendore. Megjithatë, Ligji i ri për Mbrojtjen e Mjedisit i cili përfshin një sërë direktivash të rëndësishme si IPPC, LCP, Seveso II, pjesëmarrjen e publikut dhe Direktivën Kuadër për Ujin, ende nuk është miratuar. Projektligji i ri për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, pritet të miratohet.

Nuk është raportuar progres në **cilësinë e ajrit**. Monitorimi i cilësisë së ajrit vazhdoi në qytetet kryesore, por pengohet nga aparatet monitoruese dhe metodologjia që janë të dobëta. Qeveria ka marrë masa për uljen e sasisë së naftës me përbërje të lartë squfuri. Megjithatë, nivelet e ndotjes së ajrit mbeten të lartë, sidomos të grimcës PM10 dhe nuk ka ndonjë politikë specifike afatgjatë për uljen e ndotjes së ajrit dhe reduktimin e shkarkimeve të automjeteve dhe industrisë.

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **menaxhimit të mbetjeve**. Rehabilitimi i vatrave të nxehta toksike ka avancuar dhe u identifikuan 35 vatra të nxehta të patrajtuara. Ndërtimi i vendgrumbullimeve të reja po vazhdon. Megjithatë, zhvillimi legjislativ po ngelet pas. Ende nuk është hartuar një strategji për menaxhimin e mbetjeve. Ende vazhdon derdhja e pakontrolluar dhe djegia e plehrave, sidomos akute është gjendja në zonat rurale. Përpjekje të qenësishme kërkohen për të reduktuar prodhimin e mbetjeve dhe për të promovuar riciklimin.

Progres i pjesshëm është arritur në **cilësinë e ujit**. Janë vënë në punë dy impiante trajtimi të ujërave të ndotura, punimet për një tjetër u përfunduan dhe 3 impiante të tjerë po ndërtohen. Megjithatë, ujërat sipërfaqësore vazhdojnë të kontaminohen nga shkarkimet e pakontrolluara të inerteve. Strategjia Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet, ende nuk është miratuar.

Aktet zbatuese dhe planet e veprimit për përafrimin ligjor me Direktivën Kuadër të Ujit dhe Direktivat e Nitratit dhe Mbetjeve urbane, janë në proces miratimi.

Progres i pjesshëm është arritur në **mbrojtjen e natyrës**. Sipërfaqja e mbrojtur u rrit me 12.58% të territorit pas shpalljes së ekosistemit të “Bredhi Hotovës-Dangelli” si park kombëtar. Në janar 2009, qeveria miratoi një vendim për kriteret e realizimit të inventarit të biodiversitetit dhe të rrjetit monitorues. Ligji për Mbrojtjen e Faunës së Egër i miratuar në tetor 2008, përmirësoi përafrimin e kuadrit ligjor me Direktivën e Shpendëve të Egër. Një Ligj i ri për Gjuetinë u miratua në maj 2009. Megjithatë, kërkohen ende përpjekje për të përmbushur angazhimet mjedisore në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Përgatitjet në këtë fushë po avancojnë me ritëm mesatar.

Nuk ka progres në lidhje me **kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut**

Nuk janë raportuar zhvillime në fushën e **kimikateve** dhe të organizmave të modifikuar gjenetikisht. Duhet të rritet koordinimi ndërministror për monitorimin e përdorimit të kimikateve që janë të pranishme në treg. Nuk ka një regjistër qendror për kimikatet dhe OMGJ-të.

Nuk është raportuar progres në fushën e **politikave të zhurmave**.

Kërkohen përpjekje për forcimin e kapaciteteve administrative të të gjitha institucioneve të përfshira në hartimin e politikave mjedisore dhe për zbatimin e Strategjisë ndërsektoriale për Mjedisin (2008). Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitutional mbetet i dobët. Kërkohen më shumë kapacitete monitorimi dhe inspektimi në nivel rajonal.

*Në përgjithësi*, ka pasur zhvillime ligjore pozitive, por zbatimi dhe sundimi i ligjit mbeten të dobëta. Përgatitjet në fushën e mjedisit po avancojnë ngadalë, por në mjaft sektorë nuk shkojnë më tej se faza fillestare.

#### 4.2.4 *Politika e transporteve*

Progres mund të raportohet në fushën e **rrjeteve transevropiane të transporteve**. Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë aktivisht në zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar në vitin 2004 për Zhvillimin e Rrjetit Qendror Rajonal të Transporteve, si edhe në Observatorin e Transporteve të Evropës Jug-lindore (SEETO), në veçanti duke përditësuar dhe zbatuar planin shumëvjeçar 2009-2013. Ka avancuar mirë puna për autostradën Durrës-Kukës, e cila do të lidhë Kosovën me Detin Adriatik. Ka vazhduar puna në lidhje me projektet e Korridorit të VIII-të si edhe në rrugët e aksit veri-jug. Megjithatë, nuk ka pasur progres lidhur me infrastrukturën hekurudhore.

Plani i Veprimit i rishikuar për Zbatimin e Strategjisë të Sektorit të Transporteve u miratua në mars 2009. Instituti për Transportet u rikonstruktua për të mundësuar centralizimin e të dhënave të transporteve dhe përditësimin e Planit Kombëtar të Transporteve, përfshi programet dhe politikat e transporteve. Ka filluar ngritja dhe mirëmbajtja e një baze qendrore të dhënash për transportet. Megjithatë, kërkohet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të përgjithshme institucionale.

Shqipëria po garanton akses të pakufizuar përmes territorit të saj për në trafikun e transitit të komunitetit në përputhje me MSA-në.

Është arritur progres i pjesshëm në drejtim të **transportit rrugor**. Në tetor 2008 qeveria miratoi një vendim për Kodin Rrugor duke futur auditin e sistemit të sigurisë për rrugët. Në qershor 2009, qeveria miratoi akte nënligjore duke i afruar ato për dhënien e lejeve të drejtimit më afër me standardet e BE-së. Testimi elektronik për lëshimin e lejeve të drejtimit të automjetit vlerësohet në një qendër pilot dhe është kthyer në normë. Ka pasur më pak aksidente në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007, numri i aksidenteve që kanë rezultuar në vdekje fatale është pakësuar. Këto prire vazhduan në pjesën e parë të vitit 2009. Qeveria miratoi legjislacionin në maj 2009 për krijimin e Autoritetit Shqiptar për Rrugët, i cili është përgjegjës për zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor shtetëror. Sistemi i Administrimit të pasurive Rrugore (RAMS) është duke u krijuar, përfshi studimet e sigurisë në rang vendi dhe inspektimet rutinë të mirëmbajtjes. Kanë dalë udhëzues të rinj për mirëmbajtjen. Megjithatë, janë hedhur në harta vetëm 40% e aseteve rrugore. Janë shtuar kontratat bazuar në performancën për mirëmbajtjen e rrugëve dhe buxheti i mirëmbajtjes akorduar këtyre kontratave është rritur në vitin 2009. Megjithatë, duhen përpjekje të qëndrueshme për të përmirësuar mirëmbajtjen e rrugëve. Sinjalistika rrugore kërkon përmirësim të mëtejshëm. Ndërtimet pa leje buzë rrugës dhe disiplina e mangët e shoferëve, vazhdojnë të jenë problematike për sigurinë rrugore. Përgatitjet në fushën e transportit rrugor po avancojnë me ritëm mesatar.

Progres i pakët është bërë në **transportin hekurudhor**. Rregullorja e re për Autoritetin Hekurudhor Shqiptar e miratuar në janar 2009, përcakton njësi biznesi për udhëtarët, mallrat, administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës. Njësi shërbimi u ngritën për stokun hekurudhor, administrimin dhe mbështetjen e brendshme. Megjithatë, plani i veprimit për hekurudhat që kërkohet nga Shtesa 2007 e Memorandumit të Mirëkuptimit për Rrjetit Kryesor të Transportit Rajonal, ende nuk është miratuar. Fondet e akorduara për shpenzimet kapitale, vazhduan të pësojnë rënie. Përgatitjet në fushën e transportit hekurudhor po mbeten pas.

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **transportit detar**. Në prill 2009, parlamenti miratoi Ligjin për Administratën Detare. Megjithatë, ende nuk janë miratuar aktet zbatuese për kontrollin shtetëror të flamujve dhe porteve, regjistrimin e ngarkesës dhe regjistrimin e lundëtarëve.

Ka përparuar rehabilitimi i portit të Durrësit, por përgatitjet për rehabilitimin e portit të Vlorës po ngelen pas. Qeveria ka marrë disa masa për të përmirësuar gjendjen teknike të flotës detare. Anijet mbi 15 dhe 30 vjeçare nuk do të certifikohen respektivisht të udhëtarëve dhe mallrave. Janë përmirësuar procedurat e kontrollit të paracertifikimit dhe janë futur incentiva tatimore për të inkurajuar rigjallërimin e flotës. Stafit i administratës detare përfitoi trajnime për kontrollin shtetëror të flamurit dhe portit dhe për sigurinë portuale. Megjithatë, përpjekje të qenësishme kërkohen për të përmirësuar sigurinë dhe mbrojtjen detare. Normat e ndalimit të anijeve sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit janë përmirësuar lehtë, por ende mbeten të larta krahasuar me standardet e BE-së dhe flamuri shqiptar ende renditet si i rrezikshmërisë së lartë. Përgatitjet në transportin detare nuk kanë përparuar shumë.

Nuk ka pasur progres në **transportin e kombinuar**.

Progres është arritur në **transportin ajror**, përfshi administrimin e trafikut ajror. Parlamenti miratoi Kodin e ri Ajror në dhjetor 2008 dhe ka vazhduar zbatimin e fazës 1 tranzitore të Marrëveshjes për Zonën e Përbashkët Evropiane për Aviacionin (ECAA). Një marrëveshje pune u nënshkrua me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit në korrik 2009. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme, përfshi miratimin dispozitiv të *acquis* në lidhje e detyrimet në kuadrin e ECAA-s dhe ndryshimin e Kodit të ri Ajror. Pjesëmarrja e Shqipërisë në Komitetin e Qiellit Unik Evropian dhe në zbatimin e programit të Qiellit Unik Evropian në Evropën Juglindore, do të jetë me përfitime në këtë drejtim. Ka pasur vonesa në zbatimin e planit të

veprimet të gushtit 2007 që synonte përmirësimin e mbikëqyrjes që Autoriteti i Aviacionit Civil ushtron te kompanitë ajrore në lidhje me sigurinë. Ende nuk është miratuar legjislacioni i hartuar që përcakton statusin, strukturën dhe organizimin e Autoritetit të Aviacionit Civil. Përgatitjet në fushën e transportit ajror po avancojnë me ritëm mesatar.

#### 4.2.5 Energjia

Qeveria ka vazhduar përpjekjet për përmirësimin e **sigurimit të furnizimit me energji**. Ndërtimi i termocentralit të Vlorës është gati në përfundim. Parlamenti ratifikoi një marrëveshje koncesionare për ndërtimin e tre hidrocentraleve në lumin e Devollit me një kapacitet instalues total prej 320 MW. Po vazhdon procesi i miratimit për 27 marrëveshje koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla me kapacitet instalues total rreth 290 MW, si dhe katër marrëveshje koncesionare tashmë të miratuara. Puna vazhdon në linjën e interkonjeksionit 400 KV Elbasan-Podgoricë. Megjithatë, nuk mund të raportohet progres lidhur me rehabilitimin e termocentralit në Fier. Ngritja e një Qendre Kombëtare Dispeçer është në një fazë fillestare. Shqipëria vazhdon të jetë një importuese e rritur të përgjithshëm të energjisë elektrike dhe varet tepër nga prodhimi i hidrocentraleve. Kapaciteti i interkonjeksionit të saj mbetet i kufizuar. Nuk mund të raportohen zhvillime në drejtim të **rezervave të naftës**. Ato vazhdojnë të bazohen në konsumin mesatar të 60 ditëve.

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **tregut të brendshëm të energjisë**. Qeveria privatizoi degën e shpërndarjes (OSSH) të kompanisë elektrike të KESH-it, duke zbatuar pjesërisht një nga prioritetet kyç të Partneritetit Evropian. U miratua legjislacioni i ri për të mbështetur luftën kundër lidhjeve të paligjshme. Megjithatë, humbjet e përgjithshme teknike dhe joteknike u rritën. Niveli i shlyerjes së faturave u rrit, por kërkohen përpjekje të mëtejshme në këtë drejtim, përfshi pajisjen e të gjithë konsumatorëve me matës elektrikë. Çmimi i energjisë elektrike nuk është ende në nivelet e rikuperimit të kostos.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) vazhdoi ta monitorojë tregun dhe legjislacionin i ri u miratua duke e shtrirë autoritetin rregullator të ERE-s në sektorin e gazit. Megjithatë, kapacitetet e tij vendimmarrëse si dhe pavarësia kërkojnë forcim të mëtejshëm.

Është në përgatitje e sipër hartimi i një projekt-plani për zhvillimin e sektorit të gazit dhe tregut të gazit në Shqipëri. Megjithatë, nuk mund të raportohet progres për rishikimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë.

Progres i pjesshëm mund të raportohet në fushën e **efiçencës energjetike dhe energjisë së rinovueshme**. Qeveria mori masa në drejtim të zhvillimit të këtij sektorit duke lëshuar licenca për ndërtimin e shtatë zonave me turbina me erë me kapacitet të instaluar total rreth 1360 MW dhe një termocentrali me lëndë bio 140 MW. Parlamenti miratoi në prill 2009 një ligj të ri për informacionin e etiketimit dhe prodhimit për konsumimin e energjisë nga pajisjet shtëpiake. Megjithatë, nuk mund të raportohet progres i mëtejshëm për zbatimin e Ligjit të Efiçencës Energjetike të vitit 2005.

Progres i pakët është arritur në fushën e **sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi**. Pas bërjes së amendamenteve legjislative, Agjencia Kombëtare për Burimet Natyrore është caktuar përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për energjinë bërthamore në konsultim me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike. Megjithatë, Shqipëria nuk ka nënshkruar ende Konventën për Sigurinë Bërthamore si dhe Konventën e Përbashkët për Sigurinë e Administrimit të Lëndëve Djegëse të Shuara dhe atë për Sigurinë e Administrimit të Mbetjeve Radioaktive. Kërkohen ende përpjekje për sa i përket përputhshmërisë me *acquis* në fushën e



mbrojtjes nga rrezatimi. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të trafikimit të paligjshëm të substancave bërthamore dhe materialeve të tjera radioaktive. Autoriteti rregullator bërthamor mbetet i dobët në lidhje me kapacitetet teknike dhe stafin. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të garantuar pavarësinë e tij.

*Në përgjithësi*, është arritur progres në fushën e energjisë. Megjithatë, sektori mbetet i dobët dhe sigurimi i furnizimit me energji është ende i pasigurt. Përgatitjet në fushën e energjisë kanë pasur një progres mesatar.

#### 4.2.6. *Shoqëria e informacionit dhe media*

Është bërë progres i pakët në fushën e **komunikimeve elektronike dhe teknologjive të informacionit**. Autoriteti Rregullator për Komunikimet Elektronike dhe Postare (AKEP) harmonizoi në dhjetor 2008 të gjitha licencat ekzistuese me skemën e autorizimit të Ligjit për Komunikimet Elektronike të qershorit 2008. Në shkurt 2009 u miratuan dhe publikuan ofertat e referencës së interkonjeksionit dhe në prill 2009 u licencua operatori i katërt i telefonisë celulare nëpërmjet një procedure vendimi të veçantë. Megjithatë, ende nuk është miratuar një strategji për komunikimet elektronike apo dokumentet e politikave përkatëse dhe aktet nënligjore për zbatimin e ligjit të ri janë ende në pritje për miratim. Liberalizimi i tregut është ende në një fazë fillestare dhe frenohet në përgjithësi, meqenëse mungojnë instrumentet e mbrojtjes së konkurrencës të tilla si përzgjedhja dhe parapërzgjedhja e transportuesve, mbartja e numrave dhe shpërbërja e rrjeteve lokale. Ribalancimi i tarifave nuk është përfunduar. Akti nënligjor për tarifën e shitjes me pakicë të operatorit celular është ende në vend.

Kapacitetet administrative të AKEP-së janë rritur me staf shtesë dhe trajnim të specializuar. Megjithatë, konfliktet e brendshme në këshillin e saj drejtues kanë penguar procesin e vendimmarrjes duke e çuar zhvillimin rregullator në një gjendje mosveprimi. Ende ka kapacitete të pamjaftueshme në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

*Në përgjithësi*, përgatitjet në fushën e komunikimit elektronik kanë pasur një progres mesatar.

Progres është arritur në drejtim të **shërbimeve të shoqërisë së informacionit**. Në janar 2009, qeveria miratoi strategjinë ndërsektoriale për shoqërinë e informacionit. Amendamentet e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale u miratuan në nëntor dhe dhjetor 2008 pas kërkesave të Konventës për Krimin Kibernetik. Ligji për Tregtinë Elektronike u miratua në maj 2009. U miratuan gjithashtu aktet nënligjore të Ligjit për Nënshkrimin Elektronik. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) ka filluar ngritjen e një rrjeti të vetëm elektronik qeveritar që mbulon 65 institucione. AKSHI ka promovuar aktivisht ndërgjegjësimin publik për shoqërinë e informacionit dhe ka siguruar trajnime për stafin IT të administratës publike. Megjithatë, nuk është shënuar progres lidhur me legjislacionin për aksesin e kushtëzuar. Përgatitjet në fushën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit janë duke avancuar (*shiko seksionin 4.3.6 për hollësitat shtesë për mbrojtjen e të dhënave*).

Progres shumë i kufizuar është arritur në drejtim të **politikës audio-vizuale**. Në nëntor 2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) përfundoi draft strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetim digjital, si dhe filloi një proces konsultimi me institucionet shtetërore dhe operatorët transmetues. Projekt-ligji për Transmetimet u përfundua në prill 2009, por zbatimi i Planit të Veprimit lidhur me reformën në media, siç është rënë dakord me Komisionin Evropian dhe Këshillin e Evropës, duhet të përshpejtohet. Duhet marrë masa për të siguruar financim të qëndrueshëm për transmetimet e shërbimit publik. Mbledhja e tarifave të licencimit mbetet e ulët (*shiko gjithashtu seksionin 2.2*).

#### 4.2.7 *Kontrolli financiar*

Është bërë progres i pjesshëm në fushën e **kontrollit të brendshëm publik financiar**. Dokumenti i ri për politikat e kontrollit të brendshëm publik dhe financiar u miratua në qershor të vitit 2009. Megjithatë, kuadri ligjor mbetet i paplotë, meqenëse Ligji për Administrimin dhe Kontrollin Financiar (AKF) si dhe Ligji për Inspektimin nuk janë miratuar ende nga parlamenti. Ndryshimi i Ligjit për Auditin e Brendshëm miratuar në vitin 2007 me qëllim që ai të jetë në pajtim me të gjithë kuadrin ligjor për Kontrollin e Brendshëm Publik Financiar është ende i vonuar.

Për sa i përket kuadrit institucional, Njësia e Harmonizimit Qendror për AKF-në është operative që nga nëntori i vitit 2008. Njësia e Harmonizimit Qendror për Auditin e Brendshëm është gjithashtu plotësisht operative, por struktura e saj e brendshme duhet të rishikohet. Përgjegjshmëria administrative dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve të Administrimit dhe Kontrollit Financiar janë ende në një fazë fillestare. Duhet të vazhdojnë përpjekjet për të rritur njohuritë e administratorëve të Kontrollit të Brendshëm Publik Financiar. Janë ngritur dhe plotësuar me staf njësitë e decentralizuara të auditit të brendshëm në të gjitha ministrinë si dhe në disa agjenci qeveritare. Megjithatë, shumë prej tyre vazhdojnë të kryejnë kryesisht më shumë detyra inspektimi dhe kontrolli se sa audit të brendshëm në linjë me standardet ndërkombëtare.

Progres i pjesshëm është arritur në **auditin e jashtëm**. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) miratoi Planin Strategjik të Zhvillimit 2009-2013 në fillim të vitit 2009. Megjithatë, Ligji për KLSH-në ende nuk është në pajtim me standardet e INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditit) dhe ka nevojë për ndryshime, veçanërisht për sa i përket kritereve për shkarkimin e kryetarit dhe fushën e zbatimit të auditit. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për ta çuar vëmendjen e KLSH-së në drejtim të auditeve financiare dhe atyre të mbështetura tek sistemet.

*Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e kontrollit financiar po avancojnë me ritëm mesatar.*

#### 4.2.8 *Statistikat*

Është vënë re progres në zhvillimin e **infrastrukturës së statistikave**. Buxheti për Institutin Shqiptar të Statistikave (INSTAT) për vitin 2009 është rritur rreth 21% krahasuar me vitin 2008 dhe janë punësuar staf shtesë 16 veta në vitin 2009. Një strukturë e re organizative dhe më efiçente e INSTAT-it është vënë në zbatim. Marrëveshje të reja bashkëpunimi për shkëmbimin e të dhënave statistikore janë nënshkruar ndërmjet INSTAT-it, Ministrisë së Bujqësisë dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Është bërë progres në krijimin e një sistemi *Metadata*. Sidoqoftë, infrastruktura IT e nevojshme për lidhjen ndërmjet zyrave qendrore të INSTAT-it dhe zyrave rajonale të tij ende nuk është ngritur.

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **klasifikimeve dhe regjistrat**. Ka filluar puna përgatitore për futjen e NACE Rev. 2 (Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian). Megjithatë, nuk është bërë ende klasifikimi i rajoneve statistikore i krahasueshëm me klasifikimin e nivelit NUTS. Regjistri i biznesit kërkon përditësim të rregullt të mëtejshëm lidhur me përmbajtjen dhe mbulimin e statistikave.

Progres është shënuar në përgatitjen e bazës për regjistrimet. Puna paraprake për regjistrimet bujqësore dhe ato të biznesit është kryer. Përgatitjet për regjistrin e popullsisë po vazhdojnë në

mënyrë të kënaqshme. Është ngritur njësi e regjistrimit në INSTAT dhe është organizuar takimi i bashkëpunimit të donatorëve. Qeveria ka ngritur komisionin kombëtar të regjistrimit. Megjithatë, Ligji i vitit 2001 për Regjistrimin e Përgjithshëm të Popullsisë ende nuk është rishikuar dhe koordinatori i regjistrimit ende nuk është caktuar. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për të lehtësuar shkëmbimin e informacioneve ndërmjet INSTAT-it dhe Zyrave të Gjendjes Civile për një regjistrim të përgjithshëm eficient.

Progres i pjesshëm është arritur për sa i përket **statistikave sektoriale**. Studime të rëndësishme janë kryer në linjë me programin statistikor shumëvjeçar. INSTAT-i ka kryer studimin e matjes së standardeve të jetesës, studimin për krahun e ri të punës, studimin për statistikat demografike dhe të shëndetit, studimin strukturor të biznesit dhe studimin e buxhetit familjar. Është përmirësuar shkëmbimi i informacioneve ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Bujqësisë, por duhet bërë ende përpjekje për të siguruar që statistikat e bujqësisë të përmbushin standardet e BE-së. Të dhënat për PBB përpilohen nga një departament që është ngritur së fundi për llogaritë kombëtare. GDP tremenstrale u publikua për herë të parë në dhjetor 2008. Megjithatë, kërkohen përmirësime të mëtejshme të të dhënave për t'i bërë llogaritë kombëtare të pajtueshme me ato të ESA 95.

*Në përgjithësi*, është vënë re progres në fushën e statistikave në përmbushjen e prioriteteve afatshkurtër të Partneritetit Evropian. Përgatitjet po avancojnë, por ende janë të nevojshme përmirësimet e mëtejshme në fushat kryesore, të tilla si statistikat makroekonomike dhe të biznesit.

### **4.3 Drejtësia, liria dhe siguria**

#### **4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni**

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **politikës së vizave** dhe në kuadrin më të gjerë të dialogut për liberalizimin e vizave.

Progres është shënuar për sa i përket sigurisë së dokumentit. Procesi i shpërndarjes së kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike është duke vazhduar mirë. Elementet e sigurisë të këtyre dokumenteve janë në linjë me standardet përkatëse të ICAO-s dhe BE-së. Në janar të vitit 2009 filloi shpërndarja e kartave të identitetit bazuar në bazën e të dhënave elektronike të regjistrimit të gjendjes civile. Megjithatë, nevojitet kontrolli i duhur për t'u siguruar që nuk përdoren më të dhëna nga burime të tjera dhe se burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare janë akorduar për sigurinë dhe funksionimin. Që nga 26 qershori, janë shpërndarë mbi 1 milion karta identiteti për njerëzit pa pasaporta, që ata të mund të votonin. Për zgjedhjet e qershorit 2009, u përdorën masa të posaçme me synimin për të lehtësuar shpërndarjen e kartave të identitetit për grupet e njerëzve në nevojë. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të garantuar integritetin dhe sigurinë e gjeneraliteteve si dhe procedurat e shpërndarjes të pasaportave biometrike.

Duhet të sigurohet lidhje e përshtatshme ndërmjet Sistemit të Regjistrimit Civil dhe Sistemit të Administrimit të Informacionit Total (TIMS). Në qershor u ndërpre lëshimi i pasaportave të vjetra, jobiometrike. Nga mesi i shtatorit 2009, u shpërndanë 118 772 pasaporta biometrike. Programet trajnuese për zyrtarët që merren me pasaportat dhe vizat janë të pamjaftueshme, përfshi dhe ato antikorrupsion.

Ligji për të Huajt hyri në fuqi në dhjetor 2008 dhe qeveria miratoi legjislacionin zbatues në maj 2009, por kërkohet harmonizim i mëtejshëm. Ligji i ri kufizon lëshimin e vizave në kufi me përjashtim vetëm të rasteve shumë specifike. Shqipëria ka një regjim pa viza për të gjitha vendet

anëtare të BE-së. Për momentin, listat pozitive dhe negative nuk janë të harmonizuara plotësisht me listën e vizave të BE-së. Në mars 2009, u nënshkrua një marrëveshje me Bosnje-Hercegovinën për liberalizimin e vizave. Elementet e sigurisë duhet të jenë të përcaktuar qartë për të lejuar zhvillimin e një sistemi të vizave *online* në përputhje me standardet e BE-së. Gjithashtu, kërkohet infrastrukturë e nevojshme dhe burime financiare e njerëzore për ngritjen e një qendre të lëshimit të vizave në mënyrë elektronike.

*Në përgjithësi*, është arritur progres në fushën e administrimit të vizave. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për harmonizimin me standardet evropiane. Shqipëria ka filluar t'i adresojë prioritetet e saj në këtë fushë, por kërkohet punë e mëtejshme.

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e **kontrollit të kufijve**. Sistemi i Administrimit të Informacionit Total (TIMS) është në përdorim elektronik në 18 nga 26 pikat e kalimit kufitar, në të 8 drejtoritë rajonale të policisë kufitare dhe migracionit dhe në 2 stacione vëzhguese. Megjithatë, përdorimi dhe analiza e të dhënave të mbledhura nëpërmjet TIMS-it është e pamjaftueshme, kështu që nevojiten përpjekje të mëtejshme për të instaluar sistemin në të gjitha pikat e kalimit kufitar (PKK) si dhe stacionet e policisë kufitare dhe migrimit. Mungon akses i drejtpërdrejt në sistemin e informacionit MEMEX mbi të dhënat e zbulimit të policisë në pikat e kalimit kufitar. Veç kësaj, zyrat e policisë dhe pikat e kalimit kufitar ende nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave të Interpolit për pasaportat e humbura ose të vjedhura.

Përpjekje të mëtejshme kërkohen për zbatimin me efikasitet të Ligjit për Kufirin Shtetëror bashkë me strategjinë kombëtare për administrimin e integruar të kufijve si dhe planin e veprimit të përditësuar që lidhet me të. Nivelet e plotësimit të stafit të policisë kufitare mbeten të pamjaftueshëm dhe shpërndarja e burimeve njerëzore gjatë kufijve nuk synon mjaftueshëm zonat me risk të lartë. Janë bërë përpjekje për përmirësimin e trajnimeve të oficerëve të policisë kufitare, por tashmë duhet të zhvillohet një politikë për trajnime afatgjata që siguron trajnime të vazhdueshme dhe të specializuara, fokusuar në aftësitë e menaxhimit të kufijve.

Investime të konsiderueshme janë bërë në infrastrukturën dhe pajisjet e kufirit këto vitet e fundit dhe që vazhdojnë aktualisht. Megjithatë, në këto fusha nevojitet investim i mëtejshëm. Administrimi i burimeve ekzistuese kërkon përmirësim. Është ngritur një Komitet Ndërmintor për Administrimin e Integruar të Kufijve, i asistuar nga një sekretariat teknik.

Duhet të sigurohet një ndarje e qartë e kompetencave ndërmjet Policisë Kufitare e të Migrimit (PKM) dhe Rojës Bregdetare në lidhje me zbatimin e ligjit në det dhe patrullimin e kufijve detarë. PKM-ja ka rolin drejtues në menaxhimin e kufijve detarë. Ngritja e Qendrës Ndërinstitucionale për Bashkërendimin e Operacioneve Detare, e cila duhet të sigurojë parimin e komandës civile dhe kontrollin e menaxhimit të kufijve detarë në linjë me angazhimet e Ohrit, është ende në pritje. Duhet të përmirësohet më tej bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të përfshira në mbikëqyrjen e kufijve, ndërmjet policisë kufitare dhe autoriteteve doganore.

Përpjekje të mëtejshme kërkohen për forcimin e analizës së riskut dhe informimit të gjendjes së policisë kufitare. Njësia e Analizës së Riskut e PKM-së mbledh të dhëna statistikore relevante por nuk nxjerr konkluzione për zbatimin në nivel rajonal dhe lokal. Administrimi i të dhënave që vjen nga niveli qendror për në nivelet lokale duhet të përmirësohet.

Ndërtimi i pikës së përbashkët të kalimit kufitar me Malin e Zi në Murriqan – Sukobine ka përfunduar dhe u inaugurua në qershor 2009. Ndërtimi i pikës së përbashkët të kalimit kufitar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në Xhepishit Trebishtit është aktualisht duke vazhduar. Kanë përfunduar marrëveshjet për bashkëpunimin ndërkufitar në fushën e menaxhimit të kufijve

me të gjitha vendet fqinje dhe ekziston një bazë ligjore e mjaftueshme për aktivitetet e bashkëpunimit ndërkufitar.

*Në përgjithësi*, Shqipëria vazhdon të përmbushë pjesërisht objektivat e saj në fushën e kontrollit të kufijve. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të siguruar koordinimin e përmirësuar ndërmjet agjencive si dhe trajnime të përshtatshme, burime njerëzore dhe pajisje në postat kufitare.

Progres i mirë mund të raportohet për çështjet e **azilit**. Ligji për Azilin u rishikua në janar 2009 për të përfshirë standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Megjithatë, një rang masash zbatuese duhet të miratohet për të plotësuar kuadrin ligjor, në veçanti lidhur me aksesin e azil kërkuesve në kujdesin shëndetësor, ribashkimin familjar, mbrojtjen sociale, arsim dhe strehim.

Ligji i ri siguron se apelimet e vendimeve të Departamentit për Qytetarët dhe Refugjatët (DQR) mund të paraqiten direkt para një gjykate. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për shkurtimin e procedurave të apelimit dhe për të siguruar trajnime për stafin dhe gjyqtarët e DQR-ve për azilin dhe mbrojtjen ndërkombëtare, përfshi dispozitat e ligjit të ri.

DQR-ja është përgjegjëse për administrimin e procedurës së azilit dhe ka të drejtën të marrë vendime të shkallës së parë për kërkesat e azilit. Staf i saj është trajnuar gjerësisht nga ekspertë ndërkombëtarë. Megjithatë, nevojitet trajnim i vazhdueshëm i policisë kufitare dhe koordinim me Drejtorinë për Shtetësi dhe Refugjatët (DSHR) për të garantuar efikasitet të procedurës paraekzaminuese. Gjatë vitit 2008, 12 persona aplikuan për azil, nga të cilët tetë morën status refugjati. Në gusht 2009, në Shqipëri kishte 99 refugjatë. Mjediset e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azil-kërkuesit në Babrru janë përmirësuar dhe janë në kushte të mira.

*Në përgjithësi*, Shqipëria vazhdon të përmbushë pjesërisht objektivat në fushën e azilit. Ligji i ri për Azilin nuk zbatohet plotësisht. Mbetet për t'u zgjidhur integrimi i familjeve apo personave që gëzojnë status të mbrojtjes ndërkombëtare.

Progres është arritur në fushën e **migracionit**. Shqipëria po vazhdon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planin e veprimt. Është krijuar një mekanizëm ndërministror koordinues që monitoron zbatimin. Ligji i ri për Të Huajt hyri në fuqi në dhjetor 2008. Ky ligj bën dallimet mes lejeve të qëndrimit në varësi të kohës së qëndrimit dhe përmban dispozita për detyrimet e transportuesve. Megjithatë, nevojitet buxheti i duhur për të ruajtur progresin në këtë fushë.

Progres është bërë në monitorimin e flukseve migratore, pasi statistikave të migracionit tashmë regjistrohen në TIMS. Megjithatë, nuk ka të dhëna sipas kategorive të personave të kthyer. Supozohet që me sistemin duhet të punojnë të gjitha ministritë e linjës relevante dhe pikat e kalimit kufitar, ndërkohë që në praktikë kjo gjë nuk ndodh, për shkak të mungesës së aksesit të TIMS. Duhet të fillojë zbatimi i nënmoduleve për vizat dhe lejet e qëndrimit, me qëllim që të përmirësohet monitorimi dhe analiza e riskut. Emigracioni i paligjshëm nga Shqipëria vazhdon të jetë problem i konsiderueshëm, veçanërisht në kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Forca zbuluese e policisë kufitare në lidhje me emigrantët e paligjshëm është përmirësuar gjatë vitit 2008, konkretisht 14,362 persona janë kapur në kufi. Megjithatë, numri i punonjësve në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit është i pamjaftueshëm që të përballojë emigracionin e paligjshëm. Duhet të forcohet mbikëqyrja kufitare dhe përpjekjet për zbulimin e dokumenteve të udhëtimit të falsifikuara. Duhet të forcohet më tej bashkëpunimi me vendet fqinje. Në nëntor 2008, Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, ish-Republika

Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia, nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për shkëmbimin e të dhënave për emigracionin e paligjshëm dhe për sistemin rajonal të njoftimit paraprak.

Dëbimi i personave nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm sanksionohet nga Ligji për Të Huajt, i cili është përgjithësisht në linjë me standardet evropiane. Personat kanë mundësinë të ankimojnë kundër urdhrave për largim. Numri i refuzimit të hyrjeve ishte relativisht i ulët në vitin 2008. Po ndërtohet një qendër strehimi për shtetasit nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm në Shqipëri.

Për sa i përket politikës integruese, kërkohet qasje më proaktive si kundrejt emigrantëve me qëndrim të paligjshëm, ashtu edhe ndaj të kthyerve. Emigrantët nuk përfitojnë nga ndonjë sistem i integruar ndihme financiare dhe sociale, dhe nuk janë praktikuar masa specifike për integrimin e të huajve.

Ka vazhduar zbatimin e marrëveshjes së ripranimit ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë. Në tetor 2008, u nënshkrua me Italinë një protokoll zbatimi i marrëveshjes së ripranimit. Në lidhje me vendet joanëtare të BE-së, një protokoll zbatimi i marrëveshjes së ripranimit u nënshkrua me Kroacinë në shkurt 2009 dhe në mars 2009 u nënshkrua me Bosnje-Hercegovinën një marrëveshje ripranimi dhe protokollin e zbatimit.

Në përgjithësi, progresi në fushën e migracionit ka vazhduar. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin e legjislacionit dhe rritjen e kapaciteteve administrative dhe bashkëpunimit institucional. Përpjekjet në luftën kundër emigracionit të paligjshëm duhet të intensifikohen.

#### 4.3.2 Pastrimi i parave

Progres mesatar është arritur në luftën kundër pastrimit të parave, që vazhdon të jetë problem i madh.

Në shtator 2008 hyri në fuqi Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe u miratuan aktet nënligjore. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për transpozimin e standardeve ndërkombëtare (rekomandimet e Task Forcës mbi Aktivitetin Financiar, Konventave të OKB-së dhe të Këshillit të Evropës) në legjislacionin shqiptar. Nuk është miratuar një strategji dhe plan veprimi për parandalimin e pastrimit të parave.

Kapacitetet administrative dhe teknike të DP e Parandalimit të Pastrimit të Parave (Njësia e Inteligjencës Financiare – FIU) janë përmirësuar me shtimin e stafit, trajnimeve dhe pajisjeve IT. Numri i transaksioneve të dyshimta që i japë raportuar FIU-t, është luhatur shumë nga viti në vit, por nuk ka pasur trend rritës. Megjithatë, numri ende mbetet i ulët. Raportimi është jo i njëtrajtshëm, sepse përveç bankave tregtare, thuhet asnjë institucion tjetër financiar ose jofinanciar nuk raporton te FIU për transaksione të dyshimta.

Një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet FIU-t dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave hyri në fuqi në korrik 2009. Është rritur numri dhe cilësia e inspektimeve të FIU-t. Megjithatë, kapacitetet e përgjithshme të FIU-t mbeten të kufizuara, sidomos në lidhje me grupet e mëdha kriminale dhe transaksionet e dyshimta me shumën të mëdha. Efiçenca e FIU-t pengohet nga zëvendësimi i shpeshtë i punonjësve dhe koordinimi me Prokurorinë e Përgjithshme mbetet problematik, megjithëse është bërë progres me rritjen e numrit të rasteve të dorëzuara nga FIU në prokurori, sidomos që nga ulja e pragut për raportimin e transaksioneve në *cash*. Megjithatë, ka

vend për më tepër përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese për detyrimin e raportimit.

Bashkëpunimi ndërmjet agjencive të sundimit të ligjit është përmirësuar. Në qershor 2009 u krijua një seksion që merret me krimin kibernetik. Njësia e Përbashkët Hetimore për luftën kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit pranë Prokurorisë së Tiranës, ka përmirësuar kapacitetet hetuese në këtë fushë dhe përpjekjet po vazhdojnë për të ngritur njësi të tilla edhe në 6 gjykata rrethi. Megjithatë, duhet të forcohen kapacitetet administrative të Njesisë së Përbashkët Hetimore dhe të qartësohet roli i saj si strukturë hetimore permanente. Mungesa e koordinimit të duhur ndërmjet gjyqësorit, policisë dhe autoriteteve të tjera të sigurisë, vazhdon të rezultojë në mospërpunimin e informacionit sekret të zbulimit. Niveli i rrogave që kanë punonjësit e agjencive të sundimit të ligjit vazhdon të jetë i ulët. Duhet të vazhdohet me trajnim të specializuar të stafit të institucioneve relevante.

Një memorandum bashkëpunimi u nënshkrua në mars 2009 ndërmjet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Auditimit të Pasurive dhe FIU-t.

Në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, fusha e veprimit e legjislacionit në këtë fushë mjaftohet me një vendim të Gjykatës së Lartë në vitin 2007. Kapacitetet e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara duhet të forcohen më tej. Duhet të forcohet efënca e strukturave kombëtare përgjegjëse për konfiskimin e pasurive dhe duhet të krijohet një vijimësi solide në lidhje me konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurive kriminale. Procedurat për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive nga krimi duhet të qartësohen më shumë.

Progres i qenësishëm është arritur në uljen e rasteve të këmbimit valutor të paligjshëm, për shkak të rritjes së operacioneve policore dhe masave parandaluese në këtë fushë dhe rritjes së numrit të operatorëve të licencuar.

*Në përgjithësi*, Shqipëria është në fazën fillestare për sa i përket përmbushjes së objektivave në këtë fushë. Është bërë progres i pakët në fushën kundër pastrimit të parave. Kuadri ligjor duhet të plotësohet me akte nënligjore dhe bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe gjyqësorit duhet të forcohet.

#### 4.3.2. *Drogat*

Progres i kufizuar është arritur në luftën kundër drogës. *Cannabis* vazhdon të prodhohet në vend për tregjet në Evropë dhe Shqipëria mbetet vend tranzit për trafikantët e lëndëve narkotike, që e sjellin nga Azia qendrore me destinacion Evropën perëndimore.

Shqipëria po bën përpjekje më efikase për uljen e prodhimit të drogës. Në prill 2009 u miratua një plan veprimi për të parandaluar kultivimin e *cannabis*-it që po zbatohet aktualisht në bashkëpunim me pushtetin vendor. Megjithatë, disa zona kultivuese siç është fshati i Lazaratit mbeten të paaksesueshme për policinë.

Policia po merr rol gjithnjë e më aktiv në operacionet kundër drogës. Gjatë periudhës raportuese u realizuan nëntë operacione ndërkombëtare. Progresi ka vazhduar në përdorimin e mjeteve të veçanta të hetimit si dhe metodat e infiltrimit për mbledhje informatash. Është rritur sasia e drogës së kapur. Megjithatë, zbatimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Drogës që mbulon periudhën 2004-2010, po ecën ngadalë për shkak se nuk mjaftojnë burimet financiare të akorduara dhe sepse ka mungesë stafi të kualifikuar.

Shkëmbimi i informacionit në hetimet kundër drogës ndërmjet njësive policore qendrore dhe rajonale dhe me agjencitë e tjera të sundimit të ligjit, po pengohet ngaqë policitë e qarqeve dhe autoritetet e tjera të sundimit të ligjit nuk kanë akses direkt në sistemin MEMEX. Duhet të përmirësohet koordinimi ndërmjet agjencive, si edhe bashkëpunimi me autoritetet e huaja të sundimit të ligjit.

Vazhdon të ketë mangësi në eliminimin e drogave, për shkak të pengesave ligjore dhe praktike. Për rrjedhojë, akumulohet një sasi e madhe drogë në magazinat policore që duhet të eliminohet. Strategjitë për uljen e kërkesës për drogë zbatohen në kuadër të Strategjisë Kombëtare kundër Drogës. Megjithatë, shërbimet për personat nën varësinë e drogës ofrohen kryesisht në Tiranë nëpërmjet programeve që zbatohen nga OJQ-të.

*Në përgjithësi*, Shqipëria po fillon të adresojë prioritetet e saj në luftën kundër drogës. Trafiku i drogës mbetet një çështje shqetësuese që kërkon përpjekje të mëtejshme.

#### 4.3.3. *Policia*

Progres i pjesshëm është arritur në reformën në polici.

Zbatimi i Ligjit për Policinë e Shtetit ka dhënë efekte pozitive në sundimin e ligjit. Rregullat e brendshme të policisë së shtetit u miratuan në dhjetor 2008. Megjithatë, transferimit dhe shkarkimit e stafit vazhdojnë të ndodhin në shkelje me Ligjin për Policinë e Shtetit. Duhet të forcohet procesi i ankimimit dhe disiplinës, si dhe duhet integrim më i mirë me punën e zyrës së kontrollit të brendshëm. Sanksionet disiplinore nuk aplikohen në mënyrë konsistente. Ka pasur përmirësim në organizimin e policisë dhe pajisjen me staf, megjithatë, administrimi i burimeve njerëzore mbetet i pakënaqshëm. Një plan veprimi operues për zbatimin e Strategjisë për Policimin në Komunitet u miratua në nëntor 2008 që mbulon periudhën 2008-2010.

Duhet përpjekje të mëtejshme në rekrutimin, mbajtjen dhe trajnimin e oficerëve policore. Lëvizjet e shumta të stafit të mëparshëm, të trajnuar dhe kompetent, kanë vazhduar. Pavarësisht numrit të trajnimeve, duhen trajnime të vazhdueshme sidomos për nivelin bazë të policisë së shtetit dhe për oficerët e policisë që merren me përdorimin e masave të veçanta të hetimit.

Kapacitetet hetimore të policisë mbeten të dobëta. Ekziston ndërgjegjësim i kufizuar si për bazimin e punës te informacioni sekret në shkallë kombëtare, ashtu edhe për përdorimin e instrumenteve sekrete të zbulimit. Oficerët policorë në qarqe tashmë kanë akses elektronik në sistemin e informacionit MEMEX. Statistikat mbi krimin vazhdojnë të jenë të paplota.

Bashkëpunimi ndërmjet policisë së shtetit dhe agjencitë e tjera të sundimit të ligjit me prokuroritë dhe gjyqësorin, mbetet i pamjaftueshëm dhe joefiçent. Vazhdojnë problemet në bashkëpunimin në nivel operativ midis policisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe doganave. Ligji për Policinë Gjyqësore ende nuk zbatohet plotësisht. Zbatimi i Konventës për Bashkëpunimin Policor në Evropën juglindore ka vazhduar. Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së bashkëpunimit strategjik me Europolin, pritjet nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit operativ.

Pas shpërthimit në Gërdec në vitin 2008, qeveria filloi adresimin e çështjes së stotope të municioneve të vjetra. Megjithatë, administrimi dhe çaktivizimi i armëve të lehta, lëndëve plasëse dhe mbetjeve të luftës, vazhdon të jetë problem serioz në Shqipëri. Legjislacioni ekzistues për kontrollin dhe pajisjen me armë zjarri dhe lëndë plasëse, nuk është në përputhje me standardet



evropiane. Nevojitet rishikim dhe përafrim i plotë, sidomos duke vendosur përkufizime të qartë për armët, shenjat, gjurmueshmërinë dhe çaktivizimin.

*Në përgjithësi*, Shqipëria sapo ka filluar të adresojë disa nga prioritetet e saj në këtë fushë. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për rritjen e kapaciteteve hetuese, të rritet bashkëpunimi me prokurorinë dhe gjyqësorin në veçanti dhe të përmirësohet administrimi i burimeve njerëzore.

#### 4.3.5 *Lufta kundër krimit të organizuar*

Progres i kufizuar është arritur në fushën kundër krimit të organizuar. Mbetet një prioritet kyç i Partneritetit Evropian që duhet adresuar. Mbetet për t'u finalizuar një plan veprimi specifik për zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Terrorizmit. Krimi i organizuar mbetet një çështje shqetësuese në Shqipëri.

Lufta kundër krimit të organizuar vazhdon të pengohet nga mungesa e bashkëpunimit eficient në nivel operativ midis organeve të sundimit të ligjit, gjyqësorit dhe prokurorisë. Raportimi i çështjeve dhe koordinimi i hetimeve ndërmjet prokurorisë dhe policisë, vazhdojnë të jenë shqetësuese. Kapacitetet hetimore të policisë dhe prokurorisë mbeten të dobëta. Ngritja e njësive të përbashkëta hetimore që merren me grupet e krimit të organizuar dhe pasuritë e tyre, mund të ndihmojë në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente.

Në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit për Automjetet e Vjedhura, numri i lartë i regjistrimit në Shqipëri të automjeteve të vjedhura në shtete të tjera dhe regjistrimi i automjeteve pa u zhdoganuar me vlerën reale, mbeten çështje shqetësuese.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar ka vazhduar si në nivel dypalësh ashtu edhe nëpërmjet Interpolit. Pritet të miratohet Ligji i ri për Ndihmën e Ndërsjellë Ligjore. Është rritur numri i personave në kërkim që janë kapur dhe kthyer në shtëpi. Në vitin 2008 u realizuan 87 ekstradime në Shqipëri.

Janë bërë përpjekje për kapjen e qytetarëve shqiptarë jashtë shtetit. Në periudhën tetor 2008 – qershor 2009, 37 persona janë kthyer në Shtëpi dhe gjashtë janë ekstraduar nga Shqipëria. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi kundër krimit të organizuar me Bosnjë-Hercegovinën, Francën, Kosovën, Danimarkën, Norvegjinë dhe Islandën. Bashkëpunimi me Europolin vazhdon të jetë informal pasi ende nuk ka marrëveshje bashkëpunimi.

Progres i pjesshëm është arritur për garantimin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Po vazhdon puna me një projektligj për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Megjithatë, mungesa e mbrojtjes adekuate për dëshmitarët mbetet problematike dhe pengon hetimet.

*Në përgjithësi*, Shqipëria vazhdon të jetë në fazat fillestare në luftën kundër krimit të organizuar. Vazhdon të ketë një numër të konsiderueshëm dobësish, veçanërisht mbrojtja e pamjaftueshme për dëshmitarët dhe bashkëpunimi me agjencitë relevante. Nevojiten përpjekje konstante, përfshi rritjen e rezistencës së zyrtarëve të zbatimit të ligjit ndaj korrupsionit dhe ndaj formave të tjera të presionit nga organizatat kriminale në luftën kundër krimit të organizuar, që mbetet një çështje shqetësuese dhe që cenon shtetin e së drejtës dhe klimën e biznesit.

Progres i pjesshëm është arritur në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Shqipëria ka vazhduar zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 dhe të Strategjisë për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

viktima të trafikimit. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Antitrafikimin ka kryer punë voluminoze në parandalimin dhe ndërgjegjësimin për luftën kundër trafikimit. Institucionet kompetente qendrore dhe vendore kanë marrë trajnim të specializuar. Kapacitetet administrative të kësaj zyre janë përmirësuar. Megjithatë, duke pasur parasysh sfidat e mëdha me të cilat përballlet, zbatimi efikas i të dy strategjive kërkon burime shtesë njerëzore dhe financiare.

Shqipëria mbetet një vend origjine për trafikimin e femrave dhe fëmijëve për qëllime shfrytëzimi seksual dhe pune të detyruar, përfshi lypjen e detyruar, megjithëse ka pasur rënie të numrit të personave të trafikuar. Shqipëria nuk konsiderohet më vend kryesor tranzit. Trafikimi për prostitucion përfshin kryesisht gratë dhe vajzat, ndërsa lypja e detyruar prek sidomos fëmijët romë.

Përpjekje të konsiderueshme janë bërë për të përmirësuar identifikimin e viktimave të trafikimit si dhe funksionimin e mekanizimit referuar kombëtar. Baza e të dhënave e viktimave të trafikut funksionon që në shtator 2008. Ajo mundëson shumë agjencive akses *online* në një bazë të përbashkët të dhënash dhe është hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të mbështetjes për viktimat. Si rezultat, numri i viktimave të identifikuara u rrit me pesëfish në vitin 2008, konkretisht 108 persona. Numri i dënimeve për veprën e trafikimit të qenieve njerëzore u rrit nga 7 në vitin 2007 në 26 në vitin 2008.

Janë rritur fondet shtetërore për strehimin dhe ndihma të tjera. Është përmirësuar koordinimi ndërmjet niveleve qendrore, rajonale dhe vendore dhe me OJF-të, por kërkohej përpjekje të mëtejshme. Megjithatë, ndarja e detyrave dhe përgjegjësisve të organeve relevante nuk janë të përcaktuara qartë. Duhet trajnim i mëtejshëm i të gjitha niveleve të policisë dhe të shërbimeve sociale për të identifikuar siç duhet viktimat e trafikut.

Protokolle bashkëpunimi në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore janë nënshkruar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Trafikimi i brendshëm është në rritje. Nevojiten burime shtesë teknike dhe njerëzore në kufi, përfshi punonjëse sociale femra dhe roja kufitare. Burimet njerëzore dhe financiare mbeten të pamjaftueshme për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit.

*Në përgjithësi*, Shqipëria ka avancuar pjesërisht në përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në lidhje me **luftën kundër terrorizmit**, nuk është raportuar progres. Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit, ende nuk është miratuar.

*Në përgjithësi*, përpjekjet e kundërterrorizmit vazhdojnë të jenë në fazë fillestare.

#### 4.3.4. *Mbrojtja e të dhënave personale*

Progres i pjesshëm është arritur në mbrojtjen e të dhënave personale. Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ngritur Zyra e Komisionerit për të Dhënat Personale dhe është emëruar komisioneri. Në shkurt 2009, qeveria miratoi një vendim që i siguronte kësaj zyre ambientet dhe pajisjet e punës. Është miratuar rregullorja e brendshme dhe kodi i etikës i zyrës së komisionerit dhe ka filluar shqyrtimi i ankimeve për të dhënat personale.

Megjithatë, zbatimi i Ligjit për të Dhënat Personale po ecën ngadalë. Masat zbatuese për procedurat e njoftimit dhe përjashtimet nga dispozitat, ende nuk janë finalizuar. Zyrës së

komisionerit duhet t'i sigurohen burimet e mjaftueshme, përshi trajnimin, me qëllim që të punojë me efikasitet. Pritet një strategji komunikimi në lidhje me dispozitat e ligjit.

Në përgjithësi, Shqipëria përmbush vetëm pjesërisht objektivat e saj në lidhje me mbrojtjen e të dhënave.

**SHTOJCA STATISTIKORE**

**TË DHËNAT BAZË (më 14 shtator 2009)**

Shqipëria

| <b>Të dhëna bazë</b>                   | Shënim | 1999   | 2000   | 2001   | 2002   | 2003   | 2004   | 2005   | 2006   | 2007   | 2008   |
|----------------------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Popullsia (në mijë)                    |        | 3 373  | 3 058b | 3 063  | 3 084  | 3 103  | 3 120  | 3 135  | 3 149  | 3 153  | 3 170  |
| Sipërfaqja totale (në m <sup>2</sup> ) |        | 28 750 | 28 750 | 28 750 | 28 750 | 28 750 | 28 750 | 28 750 | 28 750 | 28 750 | 28 750 |

| <b>Llogaritë kombëtare</b>                                                                            | Shënim | 1999    | 2000    | 2001    | 2002    | 2003    | 2004    | 2005    | 2006    | 2007    | 2008 |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|------|
| PBB (milion ALL)                                                                                      |        | 471 578 | 523 043 | 583 369 | 622 711 | 694 098 | 750 785 | 814 797 | 882 209 | 971 222 | :    |
| PBB (milionë euro)                                                                                    |        | 3 209   | 3 945   | 4 541   | 4 705   | 5 048   | 5 881   | 6 561   | 7 168   | 7 858   | :    |
| PBB (euro për frymë)                                                                                  |        | 1 051   | 1 289   | 1 477   | 1 521   | 1 622   | 1 881   | 2 088   | 2 275   | 2 491   | :    |
| PBB (sipas Fuqisë Blerëse për Frymë)                                                                  |        | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :    |
| TS: PBB (në Fuqi Blerëse për Frymë, BE-27=100)                                                        |        | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :    |
| TS: Norma e rritjes e PBB-së (leku, me çmime konstante, % ndryshim nga viti paraardhës)               |        | 13.5    | 6.7     | 7.9     | 4.2     | 5.8     | 5.7     | 5.7     | 5.4     | 6.0     | :    |
| TS: Rritja e Punësimit (llogaritë kombëtare, % ndryshim nga viti paraardhës)                          |        | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :    |
| Rritja e prodhueshmërisë së punës: rritja PBB për person të punësuar (% ndryshim nga viti paraardhës) |        | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :    |
| TS: Rritja e kostos për njësi punë (llogaritë kombëtare, % ndryshim nga viti paraardhës)              |        | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :    |
| TS: Prodhueshmëria e punës (PBB në Fuqi Blerëse për person të punësuar, BE-27=100)                    |        | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :    |
| Vlera bruto e shtuar nga sektorët kryesorë (%)                                                        |        |         |         |         |         |         |         |         |         |         |      |
| Bujqësia                                                                                              |        | 25.8    | 25.5    | 23.6    | 23.4    | 23.5    | 22.3    | 20.6    | 19.4    | 18.9    | :    |
| Industria                                                                                             |        | 7.3     | 7.8     | 7.3     | 6.9     | 8.7     | 10.0    | 10.6    | 11.1    | 9.3     | :    |
| Ndërtimi                                                                                              |        | 6.0     | 8.3     | 10.4    | 12.0    | 13.7    | 13.9    | 13.8    | 14.3    | 14.6    | :    |
| Shërbimet                                                                                             |        | 60.9    | 58.5    | 58.6    | 57.6    | 54/0    | 53.8    | 55.0    | 55.2    | 57.2    | :    |
| Shpenzimet e konsumit final, si përqindje e PBB-së (%)                                                |        | 92.7    | 86.0    | 80.9    | 86.0    | 86.1    | 89.0    | 88.9    | 87.4    | 90.1    | :    |
| Formacioni i kapitalit fiks bruto, si përqindje e PBB-së (%)                                          |        | 23.0    | 31.7    | 38.4    | 37.9    | 40.5    | 37.2    | 37.0    | 39.0    | 38.6    | :    |
| Ndryshime në inventarë, si përqindje e PBB-së (%)                                                     |        | 0.7     | 2.4     | 1.3     | 0.8     | -1.8    | -3.8    | -1.2    | -2.8    | -2.1    | :    |
| Ekспортet e mallrave dhe shërbimeve, kundrejt PBB (%)                                                 |        | 15.8    | 17.9    | 18.4    | 19.6    | 20.4    | 22.0    | 22.8    | 24.9    | 28.0    | :    |
| Importet e mallrave dhe shërbimeve, kundrejt PBB (%)                                                  |        | 32.2    | 38.1    | 39.0    | 44.3    | 45.1    | 44.4    | 47.5    | 48.5    | 54.6    | :    |

| <b>Industria</b>                                      | Shënim | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|-------------------------------------------------------|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2000=100) |        | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    |

| <b>Norma e inflacionit</b>                                                                | Shënim | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| TS: Indeksi i Çmimit të Mallrave të Konsumit (CPI), (total, %ndryshim nga viti paraardhës |        | -1.0 | 4.2  | 3.5  | 1.7  | 3.3  | 2.2  | 2.0  | 2.5  | 3.1  | 2.2  |

| <b>Bilanci i pagesave</b>                                                           | Shënim | 1999 | 2000 | 2001   | 2002   | 2003   | 2004   | 2005   | 2006   | 2007   | 2008 |
|-------------------------------------------------------------------------------------|--------|------|------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|------|
| Bilanci i pagesave: totali i llogarive rrjedhëse (milion euro)                      |        | -129 | -185 | -316   | -444   | -350   | -340   | -589   | -471   | -832   | :    |
| Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (milion euro)            |        | -626 | -897 | -1 149 | -1 218 | -1 177 | -1 277 | -1 477 | -1 658 | -2 104 | :    |
| Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: shërbimet neto (milion euro)             |        | 96   | 12   | 100    | -8     | -72    | -41    | -140   | -32    | 13     | :    |
| Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: të ardhurat neto (milion euro)           |        | 71   | 115  | 150    | 116    | 132    | 138    | 131    | 209    | 217    | :    |
| Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: transferata rrjedhëse neto (milion euro) |        | 330  | 586  | 583    | 667    | 767    | 839    | 897    | 1 011  | 1 043  | :    |
| prej tyre transferata qeveritare (milion euro)                                      |        | 156  | 105  | 31     | 41     | 53     | 61     | 61     | 43     | 60     | :    |
| Investime të Huaja Direkte neto, (milion euro)                                      |        | 39   | 157  | 231    | 141    | 157    | 267    | 209    | 250    | :      | :    |
| Investime të Huaja Direkte (IHD) jashtë shtetit, (milion euro)                      |        | 0    | 0    | 0      | 0      | 0      | 0      | 0      | 0      | 0      | :    |
| nga këto IHD nga ekonomia raportuese e BE-së (mln euro)                             |        | :    | :    | :      | :      | :      | :      | :      | :      | :      | :    |
| IHD në ekonominë raportuese (milion euro)                                           |        | 39   | 157  | 231    | 141    | 157    | 267    | 209    | 250    | 466    | :    |
| nga këto IHD të BE-27 në ekonominë raportuese (mln euro)                            |        | :    | :    | :      | :      | :      | :      | :      | :      | :      | :    |

| <b>Financat publike</b>                      | Shënim | 1999  | 2000  | 2001  | 2002  | 2003  | 2004  | 2005  | 2006  | 2007 | 2008 |
|----------------------------------------------|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|------|------|
| Deficiti qeveritar/teprica, kundrejt PBB (%) |        | - 9.0 | - 7.6 | - 6.9 | - 6.1 | - 4.9 | - 5.1 | - 3.4 | - 3.3 | :    | :    |
| TS: borxhi qeveritar, kundrejt PBB (%)       |        | 53.7  | 60.2  | 58.5  | 63.9  | 61.5  | 58.3  | 55.3  | 59.7  | :    | :    |

| <b>Treguesit financiarë</b>                                                                  | Shënim | 1999  | 2000  | 2001  | 2002  | 2003  | 2004  | 2005  | 2006  | 2007  | 2008 |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|------|
| Borxhi i huaj bruto i ekonomisë, kundrejt PBB (%)                                            |        | 16.1  | 17.0  | 17.2  | 22.1  | 21.1  | 19.0  | 16.6  | 16.9  | :     | :    |
| Borxhi i huaj bruto i ekonomisë, kundrejt eksportit total (%)                                | 1)     | 101.6 | 94.9  | 93.1  | 112.5 | 103.5 | 86.5  | 73.0  | :     | :     | :    |
| Oferta e parasë: M1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat ditore (milion euro)                 |        | 701   | 936   | 1 113 | 1 154 | 1 053 | 1 354 | 1 833 | 2 011 | 1 994 | :    |
| Oferta e parasë: M2 (M 1 plus depozitat me maturim deri në dy vjet (milion euro)             |        | 1 631 | 1 995 | 2 376 | 2 453 | 2 542 | 3 066 | 3 431 | 3 882 | 4 068 | :    |
| Oferta e parasë: M3 (M 2 plus instrumentet e tregtueshme (milion euro)                       |        | 1 993 | 2 475 | 3 069 | 3 148 | 3 261 | 3 973 | 4 654 | 5 478 | 6 157 | :    |
| Kreditimi total i institucioneve financiare monetare për banorët (konsoliduar) (milion euro) |        | 135   | 175   | 217   | 292   | 369   | 548   | 982   | 1 554 | 2 326 | :    |
| Normat e interesit: norma ditore e parasë, bazë vjetore (%)                                  |        | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :    |

|                                                              |    |         |         |         |         |         |         |         |         |         |   |
|--------------------------------------------------------------|----|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---|
| Norma e interesit e huadhënies (një vit), bazë vjetore (%)   | 2) | 25.8    | 24.0    | 11.9    | 16.0    | 10.5    | 13.7    | 12.2    | 11.2    | 13.6    | : |
| Normat e interesit të depozitave (një vit), bazë vjetore (%) | 3) | 9.1     | 8.0     | 7.8     | 9.3     | 7.6     | 6.0     | 5.6     | 5.5     | 6.3     | : |
| Kursi i këmbimit mesatar vjetor – 1 euro = ... lek           |    | 146.960 | 132.580 | 128.470 | 132.360 | 137.510 | 127.670 | 124.190 | 123.080 | 123.630 | : |
| Indeksi efektiv i kursit së shkëmbimit (2000=100)            |    | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | :       | : |
| Vlerat e aktiveve në rezervë (përfshi arin) (milion euro)    |    | 488     | 697     | 853     | 902     | 908     | 1 103   | 1 144   | 1 429   | 1 564   |   |

| <b>Tregtia me jashtë</b>                                               | Shënim | 1999  | 2000  | 2001    | 2002    | 2003    | 2004    | 2005    | 2006  | 2007 | 2008 |
|------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-------|---------|---------|---------|---------|---------|-------|------|------|
| Vlera e importeve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)  |        | 1083  | 1 179 | 1 486   | 1 590   | 1 648   | 1 823   | 2 118   | :     | :    | :    |
| Vlera e eksporteve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro) |        | 329   | 283   | 340     | 331     | 395     | 479     | 906     | :     | :    | :    |
| Bilanci tregtar: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)    |        | - 754 | - 896 | - 1 145 | - 1 259 | - 1 252 | - 1 344 | - 1 212 | :     | :    | :    |
| Termtat tregtarë (indeksi i çmimit të eksporteve/ importeve, 1998=100) |        | 106.8 | 100.2 | 101.5   | 99.9    | 98.2    | 99.0    | 80.3    | 100.6 | 98.1 | 96.0 |
| Përqindja e eksportit me BE-27 si përqindje e eksporteve totale (%)    |        | 95.6  | 93.2  | 91.3    | 92.6    | 93.8    | 90.9    | 93.2    | :     | :    | :    |
| Përqindja e importit nga BE-27 si përqindje e importeve totale (%)     |        | 82.8  | 80.7  | 80.3    | 77.0    | 74.3    | 70.5    | 67.2    | :     | :    | :    |

| <b>Demografia</b>                                                          | Shënim | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|----------------------------------------------------------------------------|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Rritja natyrale: ndryshimi natyral (lindje minus vdekje) (për 100 banorë)  |        | 12.8 | 11.4 | 12.5 | 9.5  | 9.3  | 8.1  | 7.2  | 5.5  | 5.9  | :    |
| Vdekshmëria foshnjore: vdekjet e fëmijëve nën 1 vjeç në 1000 lindje gjallë |        | 12.2 | 11.9 | 10.8 | 10.2 | 8.4  | 7.8  | 7.6  | 7.4  | 5.6  | :    |
| Jetëgjatësia: meshkuj (vite)                                               |        | 71.7 | 72.1 | 72.1 | 72.1 | 72.1 | 72.1 | 72.1 | 73.9 | :    | :    |
| Jetëgjatësia: femra (vite)                                                 |        | 76.4 | 78.6 | 77.5 | 77.9 | 78.6 | 78.6 | 78.6 | 78.0 | :    | :    |

| <b>Tregu i punës</b>                                                    | Shënim | 1999 | 2000 | 2001  | 2002 | 2003 | 2004  | 2005 | 2006 | 2007  | 2008 |
|-------------------------------------------------------------------------|--------|------|------|-------|------|------|-------|------|------|-------|------|
| Aktiviteti ekonomik (15-64): % e pop. 15-64 vjeç ekonomikisht aktive(%) |        | 68.3 | 66.2 | 62.3  | 61.8 | 60.1 | 58.8b | 57.8 | 53.7 | 67.4b | :    |
| TS: Norma e punësimit (15-64): %a e pop. 15-64 vjeç e punësuar (%)      |        | 55.7 | 55.0 | 52.1  | 52.1 | 51.1 | 50.3b | 49.7 | 48.7 | 56.4b | :    |
| Meshkuj të moshës 15-64 vjeç të punësuar (%)                            |        | 69.0 | 66.0 | 64.0  | 63.9 | 62.6 | 61.2b | 60.0 | 58.8 | 63.6b | :    |
| Femra të moshës 15-64 vjeç të punësuar (%)                              |        | 42.3 | 44.1 | 39.6  | 39.7 | 39.1 | 38.9b | 38.8 | 38.1 | 49.3  | :    |
| TS: Përqindja e popullsisë me moshë 55-64 që është e punësuar (%)       |        | :    | :    | :     | :    | :    | :     | :    | :    | 46.6  | :    |
| <u>Punësimi sipas sektorëve kryesorë (%)</u>                            |        |      |      |       |      |      |       |      |      |       |      |
| Bujqësia                                                                |        | 72.1 | 71.8 | 58.7b | 57.7 | 58.2 | 58.5  | 58.5 | 58.0 | 51.0  | :    |
| Industria                                                               |        | 7.7  | 5.4  | 6.1b  | 7.6  | 7.2  | 8.1   | 7.9  | 8.0  | 9.7   | :    |
| Ndërtimi                                                                |        | 1.0  | 1.2  | 6.2b  | 6.1  | 6.0  | 5.5   | 5.5  | 5.7  | 8.6   | :    |
| Shërbimet                                                               |        | 19.2 | 21.5 | 29.0b | 28.6 | 28.5 | 27.9  | 28.1 | 28.3 | 30.6  | :    |
| TS: Papunësia: krahut i punës i papunë (%)                              | 4)     | 18.4 | 16.8 | 16.4  | 15.8 | 15.0 | 14.4  | 14.1 | 13.8 | 13.4  | :    |
| Meshkuj të papunë të krahut të punës (%)                                | 4)     | 16.4 | 14.9 | 14.2  | 13.6 | 12.9 | 12.4  | 12.1 | 11.8 | 14.3  | :    |
| Femra të papuna të krahut të punës (%)                                  | 4)     | 21.4 | 19.3 | 19.9  | 19.1 | 18.2 | 17.5  | 17.2 | 16.8 | 12.2  | :    |
| Papunësia e personave < 25 vjeç: krahut i punës < 25 i papunë (%)       |        | :    | :    | :     | 26.8 | :    | :     | :    | :    | 20.1  | :    |
| TS: Papunësia afatgjatë: % e krahut të punës në papunësi afatgjatë (%)  |        | :    | :    | :     | :    | :    | :     | :    | :    | 9.4   | :    |

| <b>Kohezioni social</b>                                                                                                                                                 | Shënim | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Rrogat mesatare mujore nominale (lek)                                                                                                                                   |        | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    |
| Indeksi i rrogave reale: indeksi i rrogave nominale pjesëtuar me CPI (2000=100)                                                                                         |        | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    |
| TS:Braktisja e hershme e shkollës: përqindja e popullsisë 18-24 vjeç që nuk ka përfunduar arsimin e mesëm dhe që aktualisht nuk merr arsimim ose formim profesional (%) |        | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    |

| <b>Standardi i jetesës</b>                             | Shënim | 1999 | 2000 | 2001  | 2002  | 2003  | 2004  | 2005  | 2006  | 2007 | 2008 |
|--------------------------------------------------------|--------|------|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|------|------|
| Numri i automjeteve për 1000 banorë                    |        | 27.3 | 37.4 | 43.6  | 48.2  | 56.4  | 60.9  | 62.2  | 71.4  | 89.1 | 91.4 |
| Numri i abonimeve në shërbimin celular për 1000 banorë |        | :    | :    | 120.8 | 259.4 | 370.6 | 403.5 | 488.0 | 561.7 | :    | :    |

| <b>Infrastruktura</b>                                                          | Shënim | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|--------------------------------------------------------------------------------|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksionim, për 1000 km <sup>2</sup> ) |        | :    | 13.9 | 14.3 | 15.0 | 15.0 | 15.1 | 15.0 | 13.9 | 13.9 | 13.9 |
| Gjatësia e autostradave (mijëra km)                                            |        | :    | :    | :    | :    | 0.0  | 0.0  | 0.0  | 0.0  | 0.0  | 0.0  |

| <b>Novacioni dhe kërkimi shkencor</b>                                                       | Shënim | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| TS: Shpenzimet për burime njerëzore (shpenzimet publike për arsimin (në raport me PBB (%))  |        | 3.3  | 3.1  | 3.3  | 3.0  | 3.1  | 3.2  | 3.2  | 3.1  | 3.2  | :    |
| TS: Shpenzimet e brendshme bruto për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, në raport me PBB (%) |        | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    |
| TS: Përqindja e familjeve që kanë akses interneti në shtëpi (%)                             |        | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    | :    |

| <b>Mjedisi</b>                                                                         | Shënim | 1999  | 2000  | 2001  | 2002  | 2003  | 2004  | 2005  | 2006  | 2007  | 2008 |
|----------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|------|
| TS: Totali i shkarkimeve të gazrave serë, CO2 ekuivalent (tonë, 1990=100)              |        | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :    |
| TS: Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg i ekuivalentit të naftës për 1000 euro Pbb0 |        | 435.9 | 400.5 | 386.5 | 356.3 | 370.6 | 384.0 | 366.5 | 328.9 | 306.6 | :    |
| TS: Përqindja e energjisë së rinovueshme në konsumin e energjisë elektrike (%)         |        | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :    |
| TS: Transport rrugor mallrash si përqindje e transportit total tokësor të mallrave (%) |        | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :     | :    |

| <b>Energjia</b>                                                 | Shënim | 1999  | 2000  | 2001  | 2002  | 2003  | 2004  | 2005  | 2006  | 2007  | 2008 |
|-----------------------------------------------------------------|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|------|
| Prodhimi parësor i të gjithë produkteve të energjisë (mijë TOE) |        | 1 113 | 987   | 933   | 896   | 1 012 | 1 178 | 1 149 | 1 237 | 1 080 | :    |
| Prodhimi parësor i naftës së papërpunuar (mijë TOE)             |        | 323   | 314   | 335   | 308   | 359   | 443   | 418   | 500   | 564   | :    |
| Prodhimi parësor i antracitit dhe linjitit (mijë TOE)           |        | 33    | 20    | 15    | 5     | 19    | 19    | 15    | 15    | 15    |      |
| Prodhimi parësor i gazit natyror (mijë TOE)                     |        | 14    | 12    | 8     | 8     | 12    | 9     | 10    | 10    | 16    | :    |
| Importet neto të të gjitha produkteve të energjisë (mijë TOE)   |        | 761   | 858   | 1 001 | 965   | 1 043 | 1 080 | 1 130 | 826   | 1 020 | :    |
| Konsumi i brendshëm bruto i energjisë (mijë TOE)                |        | 1 874 | 1 845 | 1 934 | 1 861 | 2 055 | 2 258 | 2 279 | 2 156 | 2 130 | :    |
| Prodhimi/gjenerimi i energjisë (mijë GWH)                       |        | 5.4   | 4.7   | 3.7   | 3.2   | 4.9   | 5.5   | 5.5   | 5.6   | 3.0   | 3.9  |

| <b>Bujqësia</b>                                                                                                 | Shënim | 1999  | 2000  | 2001  | 2002  | 2003  | 2004  | 2005  | 2006  | 2007  | 2008  |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor për mallrat dhe shërbimet (çmimet e prodhuesit, viti pararendës = 100) |        | :     | :     | :     | :     | 102.9 | 105.1 | 101.2 | :     | :     | :     |
| Sipërfaqja totale bujqësore e përdorur (mijëra hektarë)                                                         |        | 1 144 | 1 144 | 1 139 | 1 140 | 1 121 | 1 122 | 1 077 | 1 120 | 1 121 | 1 122 |
| Blegtori: gjedh (mijëra kokë, fundi i periudhës)                                                                |        | 720   | 728   | 708   | 690   | 684   | 654   | 655   | 634   | 577   | 541   |
| Blegtori: derra (mijëra kokë, fundi i periudhës)                                                                |        | 99    | 103   | 106   | 114   | 132   | 143   | 147   | 152   | 147   | 161   |
| Blegtori: bagëti të imta (mijëra kokë, fundi i periudhës)                                                       |        | 3 061 | 3 045 | 2 933 | 2 773 | 2 919 | 2 739 | 2 701 | 2 770 | 2 729 | 2 620 |
| Prodhimi dhe përdorimi i qumështit në fermë (qumështi total, mijëra ton)                                        |        | 907   | 948   | 984   | 1 010 | 1 060 | 1 064 | 1 076 | 1 102 | 1 016 | 1 040 |
| Prodhimi i të mbjellave: drithëra (përfshi orizin) (mijëra ton, prodhim i korrur)                               |        | 498   | 566   | 503   | 519   | 489   | 499   | 511   | 508   | 494   | 609   |
| Prodhimi i të mbjellave: panxhar sheqeri (mijëra ton, prodhim i korrur)                                         |        | 40    | 42    | 39    | 39    | 50    | 40    | 40    | :     | :     | :     |
| Prodhimi i të mbjellave: perime (mijëra ton, prodhim i korrur)                                                  |        | 610   | 620   | 677   | 669   | 675   | 678   | 685   | 688   | 672   | 715   |

ST: Treguesi Strukturor

: s'ka të dhëna

p: e përkohshme

e: vlerë e llogaritur

b: thyerje në seri

- 1) Borxh i mbartur i disbursuar (DOD) stoku kumulativ që mbulon borxhin publik të jashtëm si dhe borxhi i jashtëm i garantuar publikisht; por duke përjashtuar kreditimin nga FMN. Eksportet totale llogariten në bazë të koncepteve vendase të kontabilitetit
- 2) Norma mesatare e ponderuar e aplikuar në huat e reja 12-mujore gjatë muajit përkatës, me maturim 12-mujsh.
- 3) Norma e interesit të depozitave tregon normën mesatare të ponderuar për depozitat e pranuar në muajin respektiv, me maturim 12-mujor.
- 4) Statistika administrative; të dhënat e papunësisë i referohen papunësisë së regjistruar.